

BIBLIOTEKA

85H-32

A37

# DRITËRO A GOLLI

NJERËZ

TË

KRISUR



*Novela-tregim.*

881.583-32



8JH-32  
A37

DRITERO AGOLLI

NJERËZ  
TË KRISUR

- Tregime dhe novela -

BIBLIOTEKA E  
BASHKIS GJIROKASTËR  
NR INV - 54/86

Apollonia 1995

Redaktor: LILI BARE

Piktore: MIMOZA AHMETI

Korrektore: ELONA AGOLLI



# Njeriu me veladon

## 1

— Zef Uçi, ju po abuzoni në durimin tim. Ju kini harruar një tabelë pa mbushur — tha nëndrejtori për anën ekonomike, duke e kërcënuar me gisht Zef Ucin. Ai u mat të dilte nga dera, po pastaj diçka iu kujtua dhe i foli përsëri po me atë ton: — Financier Zef Uci, ju kohët e fundit ia kini varur punës së shtetit, ju po vini interesin personal mbi atë të kolektivit!

Zef Uci ngriti sytë nën syzet e holla dhe tha i qetë:

— Unë nuk jam më financier Zef Uci, që ka të bëjë me financat, po At Zef Uci, funksionar i kishës që kryen shërbime fetare!

— ?...mbeti në këmbë si pikëpyetje nëndrejtori për anën ekonomike.

— Po, po! Jam njeri i veshur me veladon, domethënë me petk të gjatë të zi me mëngë, që më arrijnë gjer në fund të këmbëve — tha Zef Uci me seriozitet dhe gjithnjë i qetë, megjithëse ende nuk e kishte veshur këtë petk.

— Zef Uci, ju vuani nga nervat! — tha nëndrejtori, duke kujtuar se financieri u zemërua dhe nuk diti ç'të flasë. Ai doli dhe mbylli derën me forcë. Zef Uci u ngrit dhe filloi të ecë nëpër dhomë i menduar dhe i verdhë «He, ai kujton se unë jam me nerva, he! Ka një muaj që kam kërkuar të largohem nga kjo punë që meriton mallkime,



e drejta e largimit më erdhi, dhe nesër i them lamtumirë armë të punës, lapsa, vizore, formularë, shifra!»!

Puna qëndronte kështu: Shtëpia e Zef Ucit kishte nxjerrë tre breza priftërinjsh dhe ky do të ishte i katërti. Gjithnjë, në atë dhomën e madhe, me ca libra me koptina të vjetra e me shandanë të lashtë, tregoheshin historira të kohrave të shkuara e më shumë historira priftërinjsh. I ati i tij, një prift plak me një sy, me një fytyrë të zbehtë, admirues i Torkuato Tasos, Lope de Vegës dhe të madhit Dante, njeri që gjithë jetën kishte lexuar dhe bile shkruar vjersha, i thoshte shpesh të birit se vetëm ata poetë që kanë qenë priftërinj, kanë arritur «kulmet poetike».

— Të marrim, thosh ai, — Lope de Vegën. Ka qenë prift. Të marrim Fishten. Ka qenë prift. Të vijmë më afër e të hidhemi tek Mjeda. Ka qenë prift.

Zefi i vogël dëgjonte të atin e tij, për të cilin kishte një respekt të madh, dhe mendohej. Ai, edhe vetë kishte dëshirë të merrej me poezi, të përkthente Torkuato Tason e kolosë të tjerë si Tasua. Dëgjonte dhe heshte. Nga që ishte i qetë dhe i urtë, i ati dhe e ëma atij i thoshin «Zefi i shenjtë».

Po babai vdiq dhe Zefi u bë akoma më i qetë, akoma më i heshtur. Pas vdekjes së babait, në shtëpinë e tyre filloi të vijë shpesh At Ndoci, një prift i zgjuar i qytetit, që edhe ai ishte njeri me kulturë të gjerë. Ai e njihte mirë Zefin, njihte edhe dëshirat dhe prirjet e tij.

— Shumë shkrimtarë të shquar kanë qenë figura kishtare, — i pat thënë një ditë ai Zef Ucit, ashtu siç i kish thënë edhe i ati, kur ishte gjallë.

— Me të vërtetë — i ishte përgjegjur Zef Uci.

— Ata e njihnin mirë jetën e popullit, ata jetonin me popullin — i kishte thënë prifti.

Prifti kishte njohuri të thella letrare dhe gjithçka e lidhte me figurat kishtare, të cilat ishin të njohura dhe në fushën e letrave.

— Do të bësh mrekullira! Do të kesh edhe kohë të predikosh, edhe kohë të merresh me letërsi! Punë pa këçarje, pa telashe! — i tha prifti Zef Ucit.

Zef Uci pastaj mori pëlqimin nga kisha e qytetit, me një fjalë u bë kuadër i saj, dhe u caktua si prift në fshatrat e Dukagjinit.



O. sa mendime, sa plane kishte Zef Uci! E para: ai do predikonte dhe nëpërmjet këtij predikimi do të njihte më thellë jetën (kështu mendonte ai); e dyta: nga ana materiale nuk do të ishte keq (kjo ishte një nga çështjet që deri diku e preokuponte); e treta: do të kishte kohë të lirë dhe do të përkthente Torquato Tason, shkrimtarin e tij më të dashur; e katërta: do shkruante një libër me soneta origjinale mbi malësinë, blegtorinë dhe zanat...

...Ashtu ndodhi; Zef Uci nuk u paraqit në punë. Pënda e tij nuk gërvishte më në zyrën në fund të korridorit dhe daktilografistja nuk vinte më të merrte formularet për t'i daktilografuar me maqinën e saj me germa gjysëm të thyera.

Pas dy-tre ditëve Zef Ucin, shërbyesja e zyrave, e pa në MAPO-n e qytetit, duke blerë një krevat portativ me këmbë alumini, kurse në mbrëmje të po asaj dite, nëndrejtori Zyrap Çamçakizi, në rrugën «Qerim Qerozi» takoi një njeri të veshur me petk të gjatë të zi me mëngë që arrinin gjer në fund të këmbëve. Zyrap Çamçakizi fërkoji sytë. Përpara tij qëndronte Zef Uci, financieri i ndërmarrjes së tij.

— Zef Uci, nuk është koha për karnavale. Ju po vini interesin personal mbi atë kolektiv. Ju jini i sëmurë nga nervat dhe duhet të shkoni të bëni remontin e përgjithshëm në spitalin psikiatrik të Vlorës plakë — tha nëndrejtori.

— Zoti Zyrap Çamçakizi, ju gabuat adresën. Unë nuk jam vartësi juaj, po jam funksionar i kishës që kryen shërbime fetare. Largohuni nga unë sa nuk më ka shkuar në mend të lus zotin për një mallkim të merituar — foli Zef Uci dhe shkoi në hijen e avllive të larta.

— Tifu! Galë mesjetare! — pështyu Zyrap Çamçakizi në kalldrëmin e rrugës «Qerim Qerozi»

## 2

Zyrap Çamçakizi akoma nuk ju kishte treguar kolegëve të tij për takimin e papritur në rrugën «Qerim Qerozi» kur, sipas tij, «gala mesjetare» u nis për udhë të



largët me një torbë plaçkash e me një krevat portativ me këmbë alumini.

Zhdukja e financierit ngjalli diskutime në zyrat e ndërmarjes. Një thoshte se ai do të kishte shkuar në malësitë e Dukagjinit, tjetri thoshte në Nikaj-Mertur të Tropojës. Shefi i llogarisë, me kompetencën më të madhe dhe me një të vërtetë si shifër, mendonte, — dhe këte mendim e kishte shfaqur disa herë — se financieri nuk ishte njeri që besonte as në zotin, as në djallin, ai besonte vetëm në Torkuato Tason, prandaj vendosi të bëhet prift në mënyrë që të ketë kohë të përkthejë «Jerusalemën e çli-ruar» të këtij autori të famshëm.

— Nuk është e mundur, — tha nëndrejtori, — financieri nuk merrej me poezi. Atij nuk i shkante kjo lloj pune. Ai ish besimtar që vinte interesin personal mbi atë kolektiv. Po unë këte do ta verifikoj vetë. Jam caktuar në një ekip të komitetit ekzekutiv për të shkuar në krahinën e Koplikut.

— Ai ka shkuar në Dukagjin, — u hodh daktilografistja. — Shefi e shikoi me inat:

— Mos më pre me gërshërë fillin e mendimeve. Jam caktuar me ekip në Kopluk, por do të bëj çmos ta ndërroj për të shkuar në Dukagjin. Atje do të ndjek nga afër veprimet djallëzore të Zef Ucit. Zyrap Çamçakizi ngriti gishtin lart, për t'i dhënë rëndësi misionit të tij dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve. Mbretëroi një minutë qetësi. Në këtë kohë, hyri në korridor daktilografistja me një zarf në dorë.

— Shoku Zyrap, kini një letër nga Zef Uci.

Të gjithë shfaqën interes. Nëndrejtori e hapi. Aty për aty i hodhi një vështrim të shpejtë, pastaj e lexoi me zë. «I nderuari Zyrap Çamçakizi. Ju lutem shumë të më mbaroni një punë. Në sirtarin e tavolinës, në zyrën ku punoja unë, kam harruar një këmishë, furçën e këpucëve, gjyslykët e diellit dhe dy libra italisht me tituj:

«I discorsi dell'arte poetica» dhe «Poesie», e para botuar në Torino më 1901 dhe e dyta në Milano më 1934...»

— E shihni? A nuk thashë unë se ai i beson vetëm Torkuato Tason? — u hodh shefi i llogarisë me një ton triumfatori.

— More, ç'njerëz! Pritni një minutë të mbarojmë — u nevrikos Zyrap Çamçakizi dhe vazhdoi letrën: «Unë



gjithmonë e kam çmuar zemërbardhësinë dhe korrekte-  
sën tuaj. M'i dërgoni sendet e lartepërmendura me adre-  
së: Dukagjin, fshati Zanushe. Të fala, Zef Uci, funksio-  
nar që kryen shërbime fetare».

— E patë? — tha Zyrap Çamçakizi — kjo është fy-  
tyra misterioze e financierit tonë.

### 3

Dy-tre muaj pas letrës me plot porosi të Zef Ucit, Zyrap Çamçakizi u nis me ekipet e komitetit ekzekutiv në Dukagjin. Këto ishin ekiye për të studjuar mundësitë e shpërnguljes së disa fshatrave nga mali në fushë. Duhet një punë e madhe për t'ua mbushur mendjen malësorëve të zbrisnin në fushë. Nëndrejtori për anën ekonomike, me gjithë telashet që kishte si nënkryetar i ekipit, kish qef të vërente edhe Zef Ucin. Atij nuk i durohej gjersa ta takonte këte njeri të veshur me veladon, të cilin nuk e kishte parë qysh atë mbrëmje në kalldrëm të rrugës «Qerim Qerozi». Por ekipi i kishte zënë fshatrat me radhë dhe nuk ishte e mundur të shkonte menjëherë në katundin Zanushe, pa vajtur në Mriz të Berrave dhe në Kron të Zanave.

— Ta fillojmë më mirë nga fshati Zanushe — i tha kryetarit.

— Jo — tha kryetari — se na prishet itinerari dhe na ngatërrohen çështjet që kemi për të shtruar. Kupton?

— Fshati Zanushe është më i madhi në Dukagjin. Unë çuditem me nënvleftësimin tuaj. Nga ky fshat mund të shpërngulen lehtë. Malësorët këtu janë të urtë dhe ju janë mërzhitur malet më shumë se të tjerëve. Ata mund të shfaqin dëshirën për të shkuar të gjithë siç janë në ndonjë fermë në fushë.

— E vendosëm njëherë. Kupton? — ia priti shkurt kryetari. — Më parë do shkojmë në «Mriz të Berrave».

Vetëm pas një jave, ekipi shkoi në Zanushe. Pyetja e parë që bëri Zyrap Çamçakizi ishte:

— At Zef Uci mos shërben në kishën tuaj?

— Ka pasë shërbye. Tash e la kishën tonë e ka shkue



në katundin prapa kodrës, në Lajthi — i tha një malësor me një festë të bardhë e me tirçe shumë të ngushtë.

— Po pse iku?

— Nuk mund me e djtë. Asht hapë fjala se paska kenë zanë me i besimtar për çështje të druve. Ai besimtari nuk ka dashtë me i çue dru për me u ngrohë. E atbotë at Zef Uci paska thanë: «Nuk ka ma rob qi ndigjojnë zotin. Edhe ai besimtar i zellshëm që kam pat, dashka me ba qi unë të cof nga të ftohtit». Mblodhi librat, e hipi magjarin, — se ka pasë mbajtë një magjar, — dhe u largue. Thonë se ashtë në Lajthi.

— Atë pak kohë që ndenji tek ju çfarë bënte? — pyeti Zyrap Çamçakizi.

— E nga me e dijte! Ai, thonë, se për ditë lexonte do libra e shkruante bejte.

Biseda me malësorin e hutoi Zyrap Çamçakizin. Me të vërtetë ka qenë njeri misterioz. Ai njeri as me financat nuk u muar plotësisht, as me funksion fetar. Nuk e sheh si thonë? Këto libra që lexon, duhet të jenë të Torkuato Tasos! Hëmm! Sikur nuk mund ta lexonte këte Torkuato Tason apo Torkuato shejtanin pa qenë prift. Jo, jo, atë do ta ketë shtyrë edhe diçka tjetër për t'u bërë at Zef Uci. Tfu! — grindej me vete Zyrap Çamçakizi.

— Shoku Zyrap, — i thirri atij kryetari i ekipit me një zë plot nervozizëm. — Shoku Zyrap, ne kemi ardhur të bëjmë punë dhe jo të merremi me historira të një prifti të lojtur mënç! Shoku Zyrap, mos më detyroni t'ju tërheq vërejtjen. Ju nuk jini ndonjë djalosh mendjehetë. Ç'na duhet prifti, kur kemi hallet se si t'i shpërngulim këta njerëz nga këta shkropa të egër.

— Shoku kryetar, një njeri që merr rrugë të shtrembër duhet ndihmuar të vijë në binarë. Është detyra e shoqërisë ta sjellë në vete. Ja ne mundohemi t'i shpërngulim malësorët në fushë për t'i shpëtuar nga patriarkaliteti dhe për t'i shpënë afër dritës, në tokën e pasur. Ky është një akt njerëzor, apo jo? Pse atëhere mos kujdesohemi edhe për Zef Ucin, për financierin tim?

— Aq më bën mua se të qënka çmendur ty financieri — tha kryetari.

— S'jam dakord. I çmenduri duhet shëruar. Ne kemi spitale të psihiatrisë — u hodh Zyrap Çamçakizi.

— Mjaft!... I kushtuam më shumë vëmendje se sa



duhet këtij sharllatani. A nuk do të ishte më mirë të kërkonim këshillin e fshatit? — tha kryetari i ekipit.

— Asht me dhi në pyll — tha malësori.

— Ne donim ta takonim.

— Po shkoj me e thirrë — tha malësori.

E ndërsa malësori u nis të kërkojë kryetarin e këshillit, anëtarët e ekipit u ulën në ca shkëmbinj të hanin bukë. Kryetari i tyre përsëri u inatos me Zyrap Çamçakizin, i cili filloi të tregojë prap për Zef Ucin. Ekipi qëndroi mjaft kohë në gurët gjer sa erdhi kryetari i këshillit, një malësor me mustaqe të mëdha e të zeza. Zyrap Çamçakizij u bë gati ta pyeste për priftin, po u tremb nga vështrimi i kryetarit të ekipit.

— Në kemi ardhur... — filloi kryetari i ekipit.

— Nuk kam me ju ndigjue këtu. Pritni, bre burra, të shkojmë në shtëpi, të pimë një kafe, — e ndërpreu kryetari i këshillit.

Zyrap Çamçakizit nuk i durohej. Ai donte ta pyeste për priftin, po kishte frikë nga kryetari. Prandaj vendosi t'i bjerë për qark.

— Sa mësues kini? — e pyeti ai kryetarin e këshillit.

— Kemi dy — u përgjigj ai.

— Në të kaluarën — tha Zyrapi — nuk kishte shkollë në fshatin tuaj?

— Vetëm një kishë kena pat. Kena pat edhe dy priftna.

— Dy! — ia bëri Zyrapi. Kryetari i ekipit i ra me bërryl:

— Mos na hap muhabetin e Zef Ucit, se na tërheq vëmendjen nga problemi kryesor.

— Dy! — tha përsëri Zyrapi! — Tani e ka fjalën shkolla, priftit pak i shkojnë.

— Pak vallahi! Kena pasë aty parit një prift dhe na iku e na e la mbyllë kishen. Ai pat kenë njeri i çuditshëm. Mblidheshin ata pak malësorë për me u fale, po prifti nuk vinte: «Kam pas harrue» — u thoshte të nese-rejt. E ai harronte shpesh se lexonte librat e një farit Tosun Tasja.

— Torkuato Taso — e ndreqi me inat Zyrap Çamçakizi.

— Ah, i prapë ka kenë ai At Zef Uci! Jo, jo ka pak besimtarë tani. S'kanë kohë me u marrë me kësisoj pu-



nësh. Pastaj kanë ikë mjaft prej katundit tonë. Me gjithë familje kanë ikë. Kanë me ikë edhe plot të tjerë, sikur shteti me i sigurue punën dhe jetën. Të parët tanë kanë vuejtë në këta gurë e pyje.

— Do t'ua sigurojë! — u hodh kryetari i ekipit. Dhe këtu filloi puna e të dërguarve të komitetit ekzekutiv, duke e harruar për një kohë priftin.

## 4

Fshati tjetër për ku do të shkonte ekipi, ishte Lajthia. Në vatrën e kulturës, nëndrejtori u takua me një mësues të njohur, që e kishin transferuar këtyre gjyqave e gropave të Dukagjinit si të dënuar.

Si ndezen nga një cigare e si bënë pyetjet e zakonshme «Ç'kemi andej, e ç'kemi këtej», Zyrap Çamçakizi filloi të pyesë për priftin:

— More, kisha unë në ndërmarrje një financier. Iu tek të bëhej prift. Më thanë se ka ardhur në fshatin tuaj.

— Mos është At Zef Uci?

— Ai është!

— Nuk është më në fshatin tonë. Iku në drejtim të panjohur. Është njeri i çuditshëm.

Po nëndrejtori për anën ekonomike akoma nuk e dinte ç'i kishte ndodhur ish-vartësit të tij, financierit Zef Uci. Në vatrën e kulturës atij i treguan edhe diçka tjetër për këte njeri enigmatik.

Ndodhi kështu.

Mësuesja e fshatit shkoi në kishë se donte të takonte një grua, t'ëmën e një nxënësi, që kishte munguar një ditë më parë në mësim. Ajo shkoi më parë në shtëpi të saj, po nja dy fqinja i patën thënë se mund ta gjente në kishë. Mësuesja hapi derën. Në sallën e madhe të freskët dhe të errët kishte disa besimtarë, por edhe këta ishin të shkuar, me përjashtim të ndonjë gruaje të re. At Zef Uci predikonte. Mësuesja qëndronte në këmbë. Në mes të fjalëve pa kuptim që thoshte ai, asaj i zunë veshët edhe disa vargje të tillë:

E nj'at shtiz' mizore parzme ia nguli, ra palmuç  
E atbot...



Pastaj vinin vargje të tjerë mbi kalorës, dona dhe Jerusalemin...

Besimtarët mbanin vesh të heshtur. Mësuesja qeshi, se kish dëgjuar se At Zef Uci ishte rrëmbyer nga përkthimi i «Jerusalemit të çliruar» të Torkuato Tasos. Dy plakë që ishin më afër mësueses, e ndjenë të qeshurën e papëlqyer të vajzës mëkatare dhe diçka i thanë në vesh njëra-tjetrës. Po dihej se ato ishin fjalë zemërimi. Në këtë kohë, At Zef Uci e vuri re mësuesen dhe bëri një pauzë të vogël. «Do ta kenë dërguar organizatat e masave të kontrollojë punën time. Mundet që të ketë ardhur edhe për kuriozitet» — mendoi ai dhe hodhi një frazë latinisht. Pastaj prapë e ngatërroi me Torkuato Tason. «Tfu! — tha me vete — përsëri e ngatërrova!»

Kur ceremonia mbaroi, At Zef Uci doli në oborr. Mësuesja iu afrua.

— Më falni — tha ajo — po ju e ngatërruat Evangjelin me «Jerusalemin e çliruar».

— Hëmm — bëri prifti që do të thosh se nuk donte të jepte shpjegime.

— Ju përktheni vjersha? — tha mësuesja me naivitet. — Edhe unë shkruaj ndonjëherë, kur nuk kam telashe me nxënësit. Kam një fletore të tërë. Thonë, se ju jini një njohës i mirë i poezisë. Kam dëshirë t'ju lexoj.

Prifti i hodhi një vështrim, i cili më tepër ishte një studim i psikologjisë së kësaj vajze (sipas mendimit të tij). Ajo kish një fytyrë të hequr, qafën të gjatë e supet të rrumbullaktë e të bukur. At Zef Uci, duke shikuar fytyrën e saj, nuk mendonte keq, siç mund të mendojë ndonjë mashkull, që për një kohë të gjatë s'ka patur të bëjë me femra. Ai ishte njeri që pak përshtypje i bënin fustanet e grave dhe jo vetëm fustanet, por edhe gjinjatë e ngritur. Megjithatë, ndonjëherë fillonte t'i trokiste zemra fort, se edhe ai ishte një mashkull, dhe mashkullit veladoni nuk mund t'ia ndalojë trokitjen e zemrës, kur ndodhet pranë ndonjë gruaje.

— Pse mos m'i lexoni? Ata që shkruajnë vjersha — tha ai — kanë një nevojë shpirtërore për t'ua lexuar të tjerëve.

Ai donte t'i thoshte se ky ishte edhe shkaku që e ngatërroi sot predikimin në meshë me Torkuato Tason,



por u përmbajt se nuk kishte dëshirë të hapej e të binte në familjaritet me një femër kaq shpejt.

— Kolegëve të mi ua kam lexuar, po ata nuk shkruajnë vetë vjersha dhe nuk kanë njohuri kaq të thella sa mund të kini ju. Unë ju shoh ju si poet, jo si prift. Shumë poetë kanë qenë priftërinj.

At Zef Uci u prek nga këto fjalë. Fytyra e tij e zbeh-të filloi bile të marrë një ngjyrë trendafili.

— Thonë se ju ishit financier në një ndërmarrje. Pastaj për çudi të të tjerëve, u bëte prift. Edhe këte akt nuk e kuptoj — tha mesuesja. — Më mirë të mos kishit marrë një rrugë të tillë, më falni që jam kaq e paturpshme. Ju nuk jini edhe i shkuar nga mosha. Mua më duket se sot të jesh prift, është...

— T'i lemë këto! — e preu At Zef Uci.

— Unë ju thashë se jam e paturpshme — tha mesuesja.

— T'i lemë këto, t'i lemë këto! — tha prifti.

Pastaj biseda u ftoh dhe prifti u nda me mësuesen. Kryetari i këshillit të fshatit atëhere sapo kaloi me një shatë në krahë. At Zef Uci ktheu koken «Më mirë mos më shohin me këte femër, e sidomos kryesia — tha me vete ai. — Do ta kenë vëne kastile të më ndjekë! Ah është informatore!»! Si kaloi pak më tutje, e ktheu koken pas. Mësuesja dhe kryetari i këshillit ishin zhdukur. «Mundet edhe të mos jetë ashtu, siç them unë. Kjo është një diletante që merret me vjersha, dhe diletantet gjithnjë janë pak anormale. Por edhe nuk ka faj se këtu nuk ka ndonjë mësues — poet që t'ia çmoje vargjet dhe t'i japë këshilla. I vetmi poet jam unë. Si? Poet?» — u tremb prifti, kur e pëshpëriti me vete këtë fjalë.

Kishin kaluar katër-pesë ditë pas takimit me mësuesen. Prifti mori në dorë Torquato Tason dhe një fletore dhe doli kodrinave pranë shkollës. Ai u ul nën një lis mbi një grumbull gurësh, që fshatarët e quanin «varri i cubit» dhe filloi të lexojë oktavat e «Jerusalemmit të çliruar» të përkthyer nga ai vetë. Asgjë nuk pipetinte mbi varrin e cubit, përveç zërit të ngjirur të At Zef Ucit. Dy plaka kaluan dhe bënë kryq. Dy të vegjël i thanë njëri-tjetrit, megjithëse prifti nuk kishte mjekër.

— Ta lashë!

— Jo, ta lashë unë më parë.



— Jo, unë.

Prifti lexonte pa parë kryqin e plakave dhe pa dëgjuar «ta lashë» të fëmijeve. Po në këto e sipër ai ndjeu:

— Mirëdita!

Ishte mësuesja, që kthehej në shtëpi. Ajo iu afrua. Prifti u ngrit.

— Rrini, rrini! — i tha ajo dhe u ul pranë tij. Ai hapi fletoren me perkthimin e «Jerusalemmit të çliruar» dhe filloi të lexojë. Ishte i pari njeri në këto gryka që dëgjonte vargjet e perkthyerat nga ai. Ato rridhnin bashkë me apostrofat e shumta dhe fjalët e rralla, ato fluturonin mbi varrin e cubit, i cili ndofta kurrë nuk e pat dëgjuar emrin e këtij poeti kolosal. Mësuesja e ndërpreu:

— Ju lexuaki bukur. Sikur të visheshit me rroba të zakonshme, pa veladon, dhe të organizonim një mbrëmje letrare me fshataret. Të lexoja unë, ju, të tjeret, ndonjë nxenes...

— Hëm! — tha prifti i hutuar nga fjalë të tilla dhe ngriti mbi ballë gjyslykët, duke i hedhur një vështrim pa kuptim mësueses.

— Më falni. Unë ju thashë se jam e paturpshme — u justifikua mësuesja. Prifti pa fjalë uli kokën në fletore dhe vazhdoi. Rrugës kaloi kryetari i këshillit me shatë në dorë. Ai u kollit. Prifti bëri një pauze. E pa. Tha me vete: «Kjo grua po më përgatit ndonjë kurth. Ky po më ndjek. Mos mendojnë keq për mua? Mos e ngatërrojnë poezinë me çështje të moralit? Hëm». Kryetari vazhdoi rrugën. «S'janë gjëra për t'u menduar këto! — ngushëlloi veten prifti dhe vazhdoi:

— Mjaft! Si ju duket perkthimi? — pyeti ai.

— Kini shumë apostrofa dhe fjalë të rralla lokale; p.sh. ç'do të thotë «pagrat», «pakare», «kunjas», «hulumtim», «ryzoj», «terhuzun», «zuç», «zymnej», «zyqani», «djegqerres», «poftë», — tha mësuesja.

— Ah, të gjitha mund të mos i kuptosh po «djegqerres» dhe «poftë» duhet t'i dish. «Djegqerres» i thone janarit, kurse «poftë» modës. Sa për vërejtjen tjetër, mund të them se Tasua i madh pa apostrofa nuk mund të perkthehet.

Vajza rrinte më poshtë priftit dhe ai, pa dashur, i hodhi një vështrim nga lart. Vështrimi ra në mes të gji-



njve te saj. At Zef Uci u drodh. «Mëkatë!» — mendoj ai dhe u ngrit.

— Doja t'u lexoja edhe unë disa vjersha nga të miat, po u bë vonë. Një herë tjetër — tha mësuesja.

At Zef Uci hyri në kishë, mësuesja shkoi në dhomën e saj. Gjinkalla këndonte.

Kështu u takuan rastesisht edhe herë të tjera, dhe At Zef Ucit, vjershat e saj nuk i lanë ndonjë përshtypje serioze. Ato ishin mjaft agjitative për partinë e qeverinë. Por, për këtë, ai nuk i tha gjë.

Një nate At Zef Uci ishte i merzitur, i lodhur, i hutuar.

Ai nuk kishte njerëz për t'ua lexuar vargjet e perkthyer nga «Jeruzalemi i çliruar» i kolosit Taso. Në kishën e errët e të ftohtë, në një dhomë në kat të dytë, naten dëgjohej era e fortë e bjeshkeye. Qiriri ndriste në tavoline, ndriste e lëshonte lot të verdhe, që pastaj ngrinin duke zbritur tatepjete. At Zef Uci perkthente dhe lexonte me zë të lartë e të ngjirur. Vargjet e gjata aleksandrine pa pauze në mes (se kur ka pauze, merr një çike fryme) e lodhnin dhe e linte fletoren mbi trapezen me njolla të kalterta e të zeza boje. Gjuha e hollë e qiririt e perqeshte At Zef Ucin dhe kjo e deshperonte më shumë. I dukej sikur ky qiri qeshte me vargjet plot apostrofa.

— Tete apostrofa kam vënë në këte varg! Duhet ndryshuar! — dhe merrte lapsin për ta filluar nga e para vargun. Si e mbaronte, e lexonte një here me zë, e linte prapë dhe i thoshte qiririt:

— E perktheva, e perpunova, po s'kam q'e dua, ti asgjë nuk mund të më thuash.

E pastaj ai mendonte për ate mesuesen me fustan të bardhe. Me njerën dorë shterngonte njerën anë të fytyres së tij të verdhe, trokiste mbi tavoline me bishtin e penës. Ai medoemos neser duhet t'i lexoje mesueses një oktave të re nga kenga e peste e «Jeruzalemit të çliruar»! Ate oktave që fillon:

E nj'at shtiz, mizore n'parzm ia rراسي,  
ra palmuç  
E atbot' ç'ka nis me gj'mue, si nj'aj  
drague mali...



Kjo është një nga oktavat më të forta të kaloresit të famshëm dhe, pa tjetër, duhet t'i pëlqejë mësueses. He, bota nuk pjell më gjeni si Torquato Tason. Por ajo me të vërtetë më dëgjon, me vëmendje, kur lexoj. Edhe vjershat e saj, jo të gjitha, nuk janë të keqia. Fjalorin, ç'është e verteta, e kane të kufizuar. Fjale të rralla të tilla si humltime, dromca, palmuç, parzme, atbote duhen përdorur në poezi. Ka fytyrë shumë intelegjente, edhe sytë i ka intelegjente — mendonte At Zef Uci për mesuesen.

Ai u lodh së shkruari dhe së menduari dhe u shtri në krevatin e tij, duke e shuar qiririn. Dhomën e vogël e shtypi errësira. At Zef Ucin errësira e ngjeshi në krevat duke ia vene panxhen e saj të gjere mbi trupin thatim e kockeforte. Po mendimet ajo nuk mund t'ia shtypte. Ato e bënë që të vertitej sa nga një krah në tjetrin. «He, mesuesja megjithese mundohet të më thotë diçka, nuk ka guxim. He, ç'ishin ato fjale që më tha dje. «Unë vij të degjoj vjershat tuaja se ju më duki si vjershetarë me te cilin mund të kembehën dy fjalë mbi poezine, se po të ishit vetëm një prift i thate, atehere nuk do të doja as t'u degjoja dhe as të këmbeja ndonjë fjale. Ju jini i pakuptueshem. Pse iket nga zyra dhe erdhet në kishë?» Zef Uci u kthye në krahun tjetër. Para tij doli gruaja me të bardha, mesuesja në mes të fytyrave të shenjtorëve të kishës. Ai u mendua ta shkëputë atë nga shenjtoret, po ajo u largua pak nga Shen Pjetri dhe shkoi pranë Krishtit. At Zef Uci u kthye në kurriz dhe shtrëngoi fort sytë. Gruaja me të bardha i tha: «Ju m'u merzitet me llotitjet tuaja për «Jerusalem e çliruar», më lexoni një sonate dashurie nga Françesko Petrarka». At Zef Uci u kthye në bark, e futi hunden në jastek për të mos menduar për sonatat e Françesko Petrarkes kushtuar Laures, po kjo ishte një perpjekje e kote se ai kujton sonetin Nr. 10 nga libri «Në jeten e madona Laures». Ai e shtrëngoi hunden akoma më shumë në jastek, në mënyrë që të mos e deklamonte përmendesh këte sonete, po nuk u përmbajt. Katër vargjet e parë i erdhen menjëherë në mend:

Un'hjedh një hap e kryet i kthej pa u druejt,  
Kah ju vrapoj me trupin lodhe e ngri,  
Kur zemra nis me marre serish gjallni  
Me vedit flas: «S'kam forca ma me vuejt»!



Pas deklamimit me mend të këtyre vargjeve të lirikut të madh italian, At Zef Uci e hodhi jorganin me këmbë në dysheme dhe u ngrit.

— Mjaft! — i tha vetes — Mjaft! Ti po bën mëkate, ti po dashurohesh... — E ndezi qiririn. Flaka e tij ra mbi kembet e verdha mbuluar me qime te gjata. Për të flakur si jorganin edhe mendimet mbi Lauren e Petrarkes, ai mori «Jerusalem e çliruar». Por Laura ia thyente shpatat dhe shigjetat kalorësve dragoj të «Jeruzalemit të çliruar». Prifti atëhere thirri:

— Ajo po fiton! Mjaft!

U vesh shpejt e shpejt dhe doli nga kisha, duke harruar qiririn e ndezur mbi tavolinë. Ai nuk kishte më gjumë. Doli tatepjete rrugëve malore. Era e rrihte në fytyrë. Po atje, më të kthyer të perroit, në një shtëpi rrëzë kodres, ndriste një dritare. Pranë llampes, mesuesja shkruante në fletore. Fytyrën e saj e shikoi prifti dhe zuri ballin me dorë. Dy vargje të Petrarkes e ngacmuan:

Un'hjedh një hap e kryet i kthej pa u druejt,  
Kah ju vrapoj me trupin lodhe e ngri...

At Zef Uci deshi të largohej nga ai bërryl rruge, po fytyra e gruas me të bardhë, nën driten e llampes, ishte e bukur. Po në kete kohe, qiriri i ndezur, i harruar në tavoline, po e hante nga zemerimi dërrasen bashke me «Jerusalem e çliruar». Qiriri i dha flake trapezes, dyshemese dhe çatise së kishes. Shenjtoret filluan ta braktisin folene e paprekshme të tyre. Mali ndriti nga një gjuhe e madhe flake. Nga shtëpitë e pergjumura, u turren njerëzit, mesuesja la korrigjimin e fletoreve të nxenësve dhe doli me vrap. Në bërryl të rruges, ajo u poq balle për balle me Zef Ucin.

— Po digjesh! Ke marre flakë — i tha ajo atij.

— Unë jam funksionar i kishës dhe është mëkate e madhe të... si thatë ju, të digjem... — tha prifti duke e kuptuar gabim fjalen e mesueses. Po ai se mos vetëm këte radhe i ka kuptuar gabim gjerat!

— Kisha jote po digjet! — i thirri mesuesja, duke e shkundur për krahu. Vetëm atëhere At Zef Uci e kuptoi se ç'po ndodhte. Ai vuri duart në kokë e bertiti, duke vrapuar drejt flakes:



— Torkuato Tasua im! Perkhimet e mia, «Jeruzalemi im»!

Prifti kërkoi i frikësuar xhepat dhe për fat të mirë, gjeti vetëm ate botimin e Tasos me flete të holla, të cilin e mbante gjithnjë pas.

Pas pak diteve, duke lënë muret e djegur dhe këmbanën të përzier me hirin e fletores së përkthimeve të Tasos, krevatin dhe këmishët, At Zef Uci u nis për rrugë. Ku vinte? As ai vetë nuk e dinte! Hej, dreq!

## 5

Kisha e djegur dhe e djegur jo nga heretiket, po nga një prift, i ra menjëherë në sy ekipit.

— Këtu do ta kemi më lehtë për t'ua mbushur mendjen malësorëve për të zbritur në fushë — tha kryetari i ekipit, duke i hedhur një veshtrim kishes së djegur.

— Këta as kishë nuk paskan — u hodh njeri.

— E dogji ish-financieri im — tha Zyrap Çamçakizi, i cili e dinte ngjarjen.

— Përsëri me priftin! — u nxeh kryetari i ekipit.

Po ata nuk i kishin vënë re dy malësorë pleq, njeri i krrusur e tjetri me një sy të lidhur me një leckë të zezë. Malësorët kishin marrë vesh që në fshat ndodhej një ekip dhe erdhën për t'u ankuar.

— Kush asht i pari juaj? — pyeti ai me një sy të lidhur.

— Më len mue me folë me të — e ndërpreu shokun ai i krrusuri.

— Hesht ti, o Preng, pasha zotin, — u inatos ai me sy.

— Ti nuk din me fole — tha i krrusuri i dëshperuar.

— Unë? — pyeti me habi i verbëri.

Pasi u hëngrën një cope here, e mori fjalën ai me një sy.

— Ndigjoni, ori burra, asht turp nga zoti që katundi ynë të mbetet pa kishë. Nji ku asht, kqyrnie dhe ai tregoi me gisht muret e nxirë të kishës

— E ç'të bëjmë ne? — pyeti kryetari.

— Ndërhyni me e ndërtue!



— A, ajo është në dorë të fshatit — u hodh Zyrap Çamçakizi, — kisha është e ndarë nga shteti.

— Po nuk duen, more burra, nuk duen! Vetëm unë e Prenga e do gra të shkueme nga mosha jena shqetësue. Krejt janë ba haina! «Falniu mureve të djegun na thone».

— Faji juaj, që e dogjte — tha kryetari i ekipit.

— Ah, more burra, nuk asht faji yne, po i atij hainit At Zef Ucit, priftit tone. Ai nuk ishte prift, po hain! — u hodh e tha malësori i krrusur, që kishte heshtur.

— Dëgjoni këtu, or burra, — tha kryetari i ekipit, i cili vendosi t'u flasë haptazi — ne kemi ardhur në fshatin tuaj, që t'ju shpërngulim nga këta shkrepë e t'ju shpitem në fushë, në toka të pasura, të bëni jetë si njerëz të socializmit e jo si njerëz të përrallave. Për këtë kemi ardhur dhe jo t'u ndërtojmë kisha...

— Me ike prej Malcie? A? — tha ai i krrusuri akoma më i habitur.

— Po, po — u përgjegj kryetari me një ton të vendosur.

— Kurre! — tha ai me një sy.

— Kurre! — tha ai i krrusuri.

Të dy malësorët ikën të dëshperuar.

— Vetëm një punë të pastër ka bërë ai ish-financieri yt — i tha kryetari Zyrap Çamçakizit.

— Edhe unë ashtu mendoj. Bëri mirë që e dogji — tha Zyrapi.

Të dy pleqtë u fshehën prapa shkëmbinjve. Anëtarët e ekipit po shpejtonin në mbledhje të fshatit.

## 6

Ekipi po mbaronte punën e tij. Ai arriti në përfundimin se malësorët, në përgjithësi, mund të largohen nga këta shkëmbinj dhe të zbresin në fushë për të filluar një jetë tjetër. Natyrisht, ka edhe plot të tjerë konservatorë, që duan të jetojnë e të vdesin në këta male të egër, atje ku kanë vdekur të parët e tyre. I këtij mendimi ishte edhe Zyrap Çamçakizi, po ai nuk mund të largohej nga këta male pa arritur edhe në një përfundim tjetër: të takon-



te ish-financierin e ndërmarrjes së tij. Drejt kësaj e shtynte, veç të tjerave, edhe kurioziteti.

— Zef Uci! E gjeta më në fund! — thirri nëndrejtori si Arkimedi. Ai po përkthen Torkuaton maje gomarit.

At Zef Uci ktheu kokën ftohtë nga bishti i gomarit dhe përsëri filloi të lexoje e të shkruaje. Gishtat e gjatë me thonj të zinj, si thonj gale, po pak më të gjerë, shtrëngonin librin. Veladoni me njolla të mëdha, i varej gjer përdhe, aq sa ndonjëhere gomari pengohej. Mjekren e kish të parruar dhe të ndyre.

— Tfu! — tha nëndrejtori.

Gomari ecte dhe qafa e Zef Ucit shtërngohej për të frenuar lëvizjet e tepërta të kokës.

— Zef Uci, ju po luani një skenë të një komedie mesjetare — tha nëndrejtori për anën ekonomike në qafen e malit.

At Zef Uci ktheu kokën përsëri nga bishti i gomarit dhe, pa folur, mori pozicionin e mëparshëm.

— Zef Uci, ju po fshihni fytyrën tuaj djallëzore pas faqeve plot me vjersha të Torkuato Tasos! Dëgjoni? — tha prapë nëndrejtori. Pa pritur, At Zef Uci u hodh nga gomari dhe e përqafoi Zyrap Çamçakizin.

— Ç'dreqi të solli këtej! Na ka marrë malli! Faleminderit për furçen, këmishen, gjyslyket dhe librat që më dergove. Ah, more shoku Zyrap, ah, more shoku Zyrap — thoshte prifti i prekur. Nëndrejtori nuk e priste një takim të tillë dhe u hutua.

— Erdhe të pasurohesh, Zef Uci, dhe vure interesin personal mbi ate kolektiv.

— Të pasurohem? He, po mua sikur të më mbulojnë në me mesha e me qirinj, nuk kam gjë në thes. He — tha prifti.

— Po ç'bën atëhere?

— Jam munduar të jetoj me malësorët, të predikoj, të lexoj ndonjë libër, të thith ajër të pastër, se vuaj nga mushkëritë... — tha ai.

— Zef Uci, shteti ka hapur biblioteka e senatoriume. Nuk ishte nevoja të beheshe prift që të lexoje këtë djall Torkuato dhe të shëroje mushkëritë. Zef Uci, ke mbetu-

rina me okë, ke mbeturina të trashëguara nga regjimi i satrapit Zog!

— Jo more, për nder! Ku i gjeta mbeturinat? — u betua Zef Uci.

— Ke zgjedhur rrugën më të lehtë në jetë.

— Jo more, për nder!

Pastaj ata heshtën. Rruga zgjatej nëpër gryka, gomari lëvizte veshët. At Zef Uci psherëtiu. Veladoni i vjetëruar tundej. Një mësues me libra nën sqetull kaloi përpara, katër çunakë të vegjël, me trasta shkollore në qafë, ecnin e ngacmonin njëri-tjetrin, një zog qëndronte në fillin e elektrikut. Prifti ecte i menduar përpara Zyrap Çamçakizit.

— More, ate vendin tim e zuri ndonjë tjetër? — e pyeti ai Zyrapin.

— Pse, ç'kujton ti se ishe i pazëvendësueshëm? — tha shefi.

— Hmm! — ia bëri prifti.

— Do ta kesh vështirë këtej — e ngacmoi Zyrapin këtë radhë me një farë keqardhje.

— Vështirë e kam. Besimtarë ka pak. Pastaj kam djegur edhe një kishë — tha ai.

Në rrugicë kaluan dy djem. Zyrapin i njohu se ishin gjeologë dhe i pershendeti.

— Hem! — tha Zyrapin.

— Po kush erdhë në vendin tim? — pyeti Zef Uci.

— Një djalë që vjet mbaroi teknikumin financiar.

— Pak besimtarë ka — përsëriti At Zef Uci. Më vjen keq që m'u dogj fletorja me përkthime. Hem.

— Nga po shkon kështu? — pyeti nendrejtori.

— Dua të zbres në Shkodër. Ka kohë që s'kam qenë nga familja. «Quam primum, quam primum», murmuriste në gjuhën latinisht, duke goditur në bark me këmbë gomarin e tij.

— E? — pyeti Zyrap Çamçakezi, që nuk e kuptonte latinishten.

— Dua të them: «sa më shpejt, sa më shpejt!» ia perktheu Zef Uci.



Pas ekipit të veriut, Zyrap Çamçakizi u kthye në ndërmarrje me plot lajmë të reja mbi peripecitë e ish-financierit. Shefi i llogarisë, kur dëgjoji se Zef Uci lexonte

Daktilografistja e ca vajza të tjera qeshnin kur Zyrapit.

— Nuk thashë unë? Doli fjala ime.

Daktilografistja e ca vajza të tjera, qeshnin kur Zyrap Çamçakizi tregonte për kishën e djegur, thonjtë dhe për meshën e At Zef Ucit.

Po nendrejtori për anën ekonomike e priste Zef Ucin të kthehej në qytet. Takimi dhe biseda në qafë të malit me Zef Ucin, Zyrap Çamçakizin e kishin prekur mjaft.

— Pse pyeti për vendin e financierit? — mendonte Zyrap Çamçakizi.

# Ndëshkimi

Lufta ishte e rreptë,  
Tragjeditë kishin shumë ngjyra...

ANË

Anonimi

1.

1<

Batalioni kishte kohë që vërvitej cak më cak nëpër atë krahinë dhe partizanet ishin bërë si të shtëpisë me një rëzit e fshatrave. Fshataret i njihnin me emër pothuajse të gjithë partizanët që nga i madhi e gjer tek i vogli, se ishin shpërndarë nëpër shtëpira dhe jetonin bashkë. Edhe në shtëpinë e madhe të Qerim Shagut rrinin tre partizanë. Njeri prej tyre, Sefer Nezha, ishte më i moshuar, rreth tridhjetë vjetësh, kurse dy të tjerët, Sadiku dhe Aleksandri ishin fare të rinj sa ende nuk kishin filluar të pinin as duhan. Prandaj Sefer Nezha atyre iu dukej burrë i madh dhe i thoshin xhaxha. Dhe vërtet, për ta Seferi ishte si xhaxha, i donte dhe në përpjekje me gjermanët i këshillonte të mos hidheshin si të marrë, të mos ngriheshin në këmbë, por të ruheshin prapa shkëmbenjve dhe hendekëve, kur të qëllonin me pushkë. Trim është ai që di të ruhet dhe di ta vërvitë armikun për ta mundur, iu thoshte shpesh para ndonjë luftimi.

Por Sefer Nezha çuditej me Qerim Shagun, të zotin



e shtëpisë. Ai shpesh i rrinte ftohtë dhe herë-herë e vështronte me vëmendje të përqëndruar, sikur donte diçka të zbulonte në fytyrën e Sefer Nezhës. U kishte thënë edhe Sadikut dhe Aleksandrit për këtë qëndrim të habitshëm të Qerim Shagut ndaj tij. Ata kishin qeshur dhe i ishin përgjigjur, se i zoti i shtëpisë vërtet e ka vështrimin të rreptë.

— Mbase i jemi mërztur! — kishte thënë Sefer Neza.

— S'ma merr mendja! Ai është fisnik dhe mikpritës! — ia kishte prerë Aleksandri.

— Nuk duhen gjykuar njerëzit nga pamja e jashtme! — e kishte përforcuar mendimin Sadiku.

Një ditë në shtëpinë e Qerim Shagut, ku rrinin të tre partizanët, erdhi një mik i largët, një burrë mbi të dyzetat, i thinjur dhe i ligur në fytyrë dhe me një kapele të vjetër me strehë. Që në pamjen e parë ai të jepte përshtypjen e një njeriu të vuajtur, e një njeriu që kishte bërë një jetë plot mundime. Këtë nuk e tregonte vetëm fytyra e ligur me kocka të dala në të dy anët e hundës aq sa dukeshin si të bardha përmes lëkurës së tendosur; e tregonte edhe trupi i tij i dobësuar, kërcinjtë e hollë të këmbëve dhe kupat e gjunjëve që ia ngrinin pantallonat si gunga. Duke e parë këtë njeri çuditëshe se si mund të ecte dhe se si mund t'i shtynte këto kocka të mbështjella me lëkurë.

Qerim Shagu, i kuq në fytyrë, me një hundë në fund si çomagë dhe me vetulla me qime të gjata, kur e takoi në oborr në fillim nuk e njohu dhe fërkoi sytë me dorë. As kur ai buzëqeshi dhe i dolën dhëmbët e bardhë, duke e treguar akoma më të dobësuar, nuk e njohu. Vetëm kur ia dëgjoi zërin e trashë, që nuk i shkante fare pamjes kockë e lëkurë, Qerim Shagu iu hodh në qafë dhe e futi të tërin në gjoksin e tij të gjerë:

— Sa ditë e sa net duhej të rridhnin! Ku je, more Islam Bylykbashi! — thirri Qerim Shagu pa e lëshuar nga gjoksi.

— Më kujtoje të vdekur, Qerim! Po ja, që jam i gjallë! — qeshi Islami, kur doli nga gjoksi i madh i Qerimit.

Duke e mbajtur për krahu nëpër oborr, Qerimi e shpuri mikun në odë pranë zjarit, se ishte fund vjeshte dhe bënte ftohtë. Frynte dhe një erë me lagështirë që



paralajmëronte një dimër të egër. Dimri i ashpër ndihej edhe nga patat e egra që kishin filluar të fluturonin varg njera-tjetrës në dy degë që bashkoheshin dhe formonin një gërshërë.

E shoqja e Qerim Shagut si u përshëndosh me të ardhurin solli një krah dru të trasha dhe i vuri në oxhak. Flaka që i ndriste fytyrën Islamit e tregonte akoma më të dobët dhe më të rraskapitur. Qerimi e vështronte fshehurazi dhe mendonte për vuajtjet që do të kishte hequr ky njeri i ngjallur përsëri dhe i sjellë në këtë botë të trazuar.

— E shoh që ke hequr shumë! — tha Qerimi.

Islam Bylykbashi zbuloi dhëmbët, që flaka u jepte një ngjyrë të trëndafiltë.

— Vajta në atë botë dhe u ktheva përsëri! — tha ai me vështrim në flakën që lëpinte faqet e zeza të oxhakut.

— Të liruan, apo ike? — pyeti Qerimi.

— Para se të më merrnin e të më pushkatonin, ika nga burgu me një shok tjetër nga Vlora.

— Breh! — bëri Qerim Shagu.

Islam Bylykbashi kishte qenë mësues në këtë fshat të Llëngës dhe bashkë me mësimin në shkollë përhapte idetë e patriotizmit, i lidhur ngushtë me ilegalët dhe partizanët. Madje kishte marrë pjesë në njësitet partizane për të prerë shtyllat e telefonëve dhe për të çarmatosur postat e xhandarmërisë në gjithë krahinën. Ai kishte njohur edhe një xhandar me emrin Lefter Nezha, që i kishte ndihmuar njësitet partizane edhe në hapjen e depove me misër dhe grurë të pasanikëve për t'ua shpërndarë fshatarëve të varfër. Por ky xhandari, me sa duket, ishte i lidhur me italianët dhe e kishte kallzuar Islam Bylykbashin. Dhe një ditë erdhën italianët bashkë me Lefter Nezhen, e gjetën Islamin të papërgatitur dhe të pambrojtur, dhe e morën me vete. Që atëhere ai nuk e harroi fytyrën e këtij xhandari me një hundë si të shqiponjës që i zbriste nga fundi i ballit të gjerë dhe binte mbi buzët e holla dhe të zbehta. Këtë xhandar, sa ishin italianët, ai e pa edhe në burg tek hynte nëpër qelitë për të njohur ndonjerin nga të burgosurit dhe për t'u dhënë fashistëve fakte të tjera. Pastaj, pas kapitullimit të Italisë, në kohën e gjermanëve, ai nuk e pa më.

Islam Bylykbashi, provoi edhe të rrahurat e gjermana-



nëve. duke kaluar përmes një skëterre të vërtetë. Dhe tani ai kishte dalë kockë e lëkurë dhe kishte ardhur në zonën e lirë për t'u lidhur përsëri me partizanët, pasi të rrinte disa ditë në shtëpinë e Qerim Shagut për të marrë pak shëndet dhe për ta harruar disi skëterrën.

Ngrohtësia që përhapej nga oxhaku dhe që djersinte xhamat e odës filloi të nanuriste Islam Bylykbashin dhe t'ia rëndonte kapakët e syve të futur në zgavrat e mëdha. Ai mezi e mbante kokën, që tanimë ishte bërë si një kafkë e vërtetë. Prandaj Qerim Shagu urdhëroi të shoqen t'i shtronte dyshekun në odën e sipërme pranë asaj të tre partizanëve. Këtë donte edhe Islam Bylykbashi.

— Të hash pak bukë! — i tha Qerimi.

Por ai tundi kokën në shenjë mohimi, e tundi me mundim, sikur nuk kishte fuqi të fliste, dhe u ngrit me vështirësi, duke u mbështetur me duar në truall për t'u dhënë forcë gjunjëve.

## 2

Islam Bylykbashi u zgjua vonë, kur ishte errësuar gjithçka. U zgjua se dëgjoji këngë. I shtrirë në kurriz ai mbante vesh këngën i përmalluar. Në skëterrën ku kishte qenë, kishte dëgjuar vetëm sharje dhe zëra të egër. Kënga atje i dukej si një ëndërr e largët. Tani dëshironte që ajo të mos mbaronte kurrë. Po cilët këndojnë, vallë? — mendonte ai i shtrirë, i mbështjellë nga errësira. Dhe përtonte të ngrihej e ta linte këtë shtrat të ngrohtë që i dukej si parajsë e harruar prej kohësh dhe e ardhur papritur. Megjithatë, ai u ngrit ngadalë, u vesh dhe zbriti me kujdes shkallët e drunjta...

Kur hapi derën e odës së zjarrit, atje ku kishte qenë para disa orëve, pa sofrën e madhe sa një lëmë me shtatë a tetë burra dhe mes tyre të tre partizanët. Qëndroi për një çast i mbështetur në anët e derës, sikur të kishte frikë të ndërpriste këngën, dhe mbajti vesh me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë. Burrat kthyen kokën nga ai dhe kur panë fytyrën me faqe të futura brenda në gropat e kockave, e ndërprejnë përnjëherësh këngën. Ky njeri atyre iu duk si mehit i sapo dalë nga varri dhe i frikshëm.



— Këndoni, këndoni! — tha ai me zërin e trashë, duke qëndruar në këmbë i mbështetur pas derës.

Burrat u ngritën të gjithë nga sofra, e zunë për dorë dhe ai u ul pranë Qerim Shagut përballë tre partizanëve. Drita e llambës prej vajguri e varur mbi oxhak binte drejtëpërdrejt në fytyrat e tre partizanëve të ulur rreth sofrës. Qerim Shagu iu kthye atyre dhe iu tha se ky ishte Islam Bylykbashi, i handakosuri nëpër burgje. Mësuesi me famë i këtyre anëve, që u kishte folur gjerë e gjatë. Dhe partizanët e vështronin me një nderim të madh, duke mos ia vënë re fytyrën e ligur tërë gropa kockash. Për atë mbushën gotat dhe ngritën shëndetet njeri pas tjetrit.

— Hajde, o mësues, hajde! — tundi kokën njeri nga burrat me emrin Malo.

— Ja, kështu, o Malkë, u takuam prapë! — qeshi mësuesi dhe ngriti gotën.

Ai i ndali sytë në të tre partizanët. Në fillim i vështroi dy të rinjtë, Sadikun dhe Aleksandrin, me fytyra të njoma, si nxënës shkolle, me push nëpër faqe dhe në vendin e mustaqeve mbi buzë. Ata buzëqeshnin nga ky vështrim, sikur të guduliseshin lehtë-lehtë. Sadiku kishte flokë të verdhë të dendur, të ngritur përpjetë dhe të pashtuar, ndërsa Aleksandri të zez dhe të drejtë, të ngjitur për dërrasën e kokës nga që e ngjishte shumë kapelën.

— Nga ç'anë jeni? — i pyeti Islami ata të dy.

— Unë jam nga Sinica e Devollit! — tha Aleksandri.

— Hëm! Të jesh shëndoshë!

— Unë jam nga Gora! — tha Sadiku.

— Hëm! Kam pasur në burg dy nga Gora! — tha Islami i menduar.

Pastaj ai i ndali sytë në fytyrën e Sefer Nezhës. I ndali dhe u vrenjt i tëri. Vetullat i ranë poshtë dhe balli iu rruadh, siç rrudhet një pellg me ujë të pastër kur fryn një erë e lehtë. Ai vështronte hundën e Sefer Nezhës si të shqiponjës, që zbriste nga fundi i ballit, vështroi fytyrën trekëndëshe me mjekër të mprehtë dhe buzë të holla e të zbehta dhe psherëtiu thellë. Pas psherëtimës e shtrëngoi me dorë ballin, pasi filloi t'i therë nga një dhembje e papritur. Sefer Nezha e vuri re ndryshimin e fytyrës së mësuesit dhe priti që ta pyeste siç pyeti dy shokët e tjerë. Por mësuesi aty për aty nuk pyeti. Ktheu kokën nga



Qerim Shagu dhe i tha të këndonte, se kishte dëshirë të dëgjonte dhe të nxirrte mallin. Qerim Shagu i bëri shenjë Malkës dhe ia mori këngës:

Ke dy-tre vjet në komitet,  
Bir Gani, medet, medet!  
Atje mbi Zërvackë  
Na ndeze dyfek

Bir Gani, medet-medet!  
Hasmi bamb me topa,  
Ti bamb me dyfek,  
Bir Gani, medet-medet!...

E gjithë oda zjente nga zërat e shtruar të atyre që bënin iso dhe të Malkës që ia merrte bashkë me të Qerimit që ia kthente. Edhe gjuha e ndritur e llambës së vajgurit nga këta tinguj lëkundej në të dy anët e qelqit, sikur merte pjesë në këngën e përmallshme. Islam Bylykbashi e ndjeu thellë këtë këngë dhe dalngadalë, në fillim u përlot pakëz dhe pastaj filloi të qajë, duke i mbledhur lotët në shami. Nuk ishte vetëm shkakku që e ndjente këngën, po edhe dobësia e madhe fizike ishte një arsye që e bënte të qante. Atij tani të gjitha fijet e nervave i ishin dobësuar.

— Ka hequr, i gjori! — i tha Malkës ngadalë Qerim Shagu.

— Hajde, o mësues, hajde! — bëri Malka.

Sadiku dhe Aleksandri e vështronin dhe iu vinte zor që ai qante. Kurse Sefer Nezha e kishte mbështetur faqen në dorën e mbledhur në grusht dhe rrinte i ngrysur. Ç'pati ky me mua? Pse s'më pyeti nga jam e si e kam emrin? Ç'mendon për mua? — tha me vete Sefer Nezha në sofër përballë Islam Bylykbashit që qante.

Heshtjen e rëndë e theu vetë Islam Bylykbashi. Ai u kërkoi ndjesë burrave rreth sofrës dhe iu tha se kënga gjithmonë e ka prekur thellë, por sonte e kishte përmalluar më shumë se herë tjetër nga që kishte kohë pa dëgjuar të këndohej në një odë si kjo mes shokësh e miqsh. Pastaj ai e vështrroi përsëri me vëmendje të madhe Sefer Nezhen, duke u vrenjtur edhe këtë herë. Nga gjendja shpirtërore e përmalluar, ai kaloi në një zymtësi të ha-



pur, që nuk mund ta fshihte. Ai lëkundej ta tregonte shkakun e kësaj zymtësie se nuk donte të prishte atmosferën e gëzuar të këngës. Këtë shkak edhe mund t'ia tregonte mënjanë Qerim Shagut, kur të m'haronte darka. Por ai nuk mund ta përmbante veten. Ndonjëherë të përmbash veten duhet të kesh edhe shëndet të mirë dhe të jesh i fortë fizikisht.

Papritur i ngriti vetullat me vështrim nga Sefer Nezha dhe pyeti:

— Po ti nga je?

Sefer Nezha e hoqi dorën nga faqja dhe e vështroi i vrenjtur:

— Nga Labëria!

— Po emrin?

— Sefer Nezha — u përgjigj ftohtë Seferi.

Islam Bylykbashi qeshi hidhur. Tjetri e vuri re këtë hidhëtirë.

— Pse qesh? — pyeti.

— Nuk ka në Labëri mbiemra Nezha! — tha Islam Bylykbashi me pakënaqësi.

— Ja që ka! — tha Sefer Nezha. duke lëvizur buzët e holla me përbuzje.

Burrat rreth sofrës dhe dy partizanët vështruan njeri-tjetrin pa kuptuar se ç'ishin këto pyetje dhe përgjigje në formën e një gjyqi.

— Ke qenë xhandar para se të dilje partizan? — pyeti Islam Bylykbashki drejtpërsëdrejti.

Sefer Nezha u vonua të japë përgjigje. U skuq dhe lëvizi supin e djathtë. Nxori kutinë dhe filloi të dredhë një cigare. Të gjithë vështronin gishtrinjtë e tij në letrën e hollë që dridhej. Si e drodhi, i ngriti sytë drejt në fytyrën e Islam Bylykbashit:

— Kam qenë!

Të dy partizanët e rinj prenë frymën, se e vërteta që vinte nga kjo përgjigje ishte për ta e papritur. Ata nuk e kishin ditur që xhaxhai, siç i thoshin, të kishte qenë xhandar. Ndërsa burrave të tjerë kjo nuk u bëri përshtypje, pasi plot njerëz që kishin qenë xhandarë, kishin dalë mallet partizanë dhe janë bërë bile edhe komandantë. Atyre më shumë u bëri përshtypje këmbëngulja e Islam Bylykbashit për ta pyetur me hollësi Sefer Nezhën dhe duke dyshuar në këtë njeri.



— Pse më pyet? — tha pas heshtjes Sefer Nezha.

— Hem! Kam njohur një xhandar Nezha. Po ai e kishte emrin Lefter Nezha. Ju shëmbëlleni me të si dy pika uji. Ai më pati ardhur edhe në burg, pastaj u zhduk dhe s'e pashë më. Papritur në këtë sofër më doli përpara. Ju këtej nga kjo anë e keni kryer shërbimin e xhandarmërisë? — pyei ai përnjëherësh.

— Nuk e kam kryer këtej! — u përgjigj Sefer Nezha.

— Çudi, çudi! — bëri Islam Bylykbashi.

Burrat filluan ta vështronin me vërejtje të madhe Sefer Nezhen. Në kokën e tij tani përfytyronin kapelën e xhandarit. Qerim Shagu bile u përkul mbi sofër për ta parë më mirë dhe duke e vështruar, s'u besoi syve të yet. Vërtet qënka ai, ai xhandar Nezha që bëri sikur u hodh nga ana jonë dhe u shërbente italianëve! Ai i tëri, ai që mori bashkë me italianët mësuesin, Islam Bylykbashin! mendoj me vete i zoti i shtëpisë. Edhe Malka me habi të njëjtën gjë mendonte.

Sefer Nezha rrinte si në gjëmba. Kishte mbetur i vetmuar mes vështrimeve të çuditshme të njerëzve. E ndjente veten të huaj në këtë sofër, të huaj ndaj fshatarëve dhe të huaj ndaj dy partizanëve të rinj me shpirt të pablagosur kurrë në jetën e tyre. Nga u shfaq ky njeri, që vetëm me fytyrën e tij të fut frikën? Nga erdhi ky njeri i harruar prej kohësh këtu mes maleve ku ka qëndruar ky batalion i përzhitur mes zjarrit të armëve dhe mes ftohtësisë së dëborërave dhe akujve? — mendon Sefer Nezha tek gjuha e hollë e llambës lëkundej mbi oxhakun e Qerim Shagut, duke ndjellë çaste dhe ditë të këqia...

#### 4

Pas dy-tre ditëve të tre partizanët, Sefer Nezha, Sadiku dhe Aleksandri nuk e panë më Islam Bylykbashin. Nuk ia dëgjuan kollën e thatë në odën përkrah derës së tyre. Qerim Shagu iu tha se ai iku të kërkojë shtabin e brigadës në Panarit i përcjellë nga Malka, hipur në kalin e të zotit të shtëpisë.

— Atë e kanë egërsuar vuajtjet! — tha Qerim Sha-



gu me vështrim nga dy partizanët e rinj pa ia hedhur sytë Sefer Nezhës.

Sefer Nezha e kuptonte tani ftohtësinë e Qerim Shagut ndaj tij. Edhe drojtjen e Sadikut dhe Aleksandrit e kuptonte. Ata nuk i thoshin më «xhaxha». madje në kuvendim e sipër Sefer Nezhës i bënë veshët sikur njeri prej tyre i tha «xhand...» dhe aty për aty e ndërpreu fjalën. Prandaj ai kthehej vonë në shtëpinë e Qerim Shagut, kur të gjithë kishin ngrënë dhe bëheshin gati të flinin.

Madje i mërzhitur i kishte thënë komandantit që ta lejonte të shkonte në një batalion tjetër të një brigade tjetër. Dhe këtu kishte bërë gabimin më të madh që do t'i kushtonte shumë shtrenjtë. Komandanti e kishte pritur ftohtë dhe nuk e kishte lejuar. Por ai ishte njeri i fortë dhe dinte ta gëlltiste hidhërimin. Vetëm se i vinte inat me keqkuptimin që kishte ndodhur nga fjala e një njeriu të ardhur fare rastësisht në këto anë. Mbase ai vërtet i shëmbëllente një Nezhës tjetër që edhe ky na qënkesh xhandar. Mbase edhe i ardhuri kishte pasur të drejtë se ashtu i ishte dukur. Megjithatë ky i ardhur duhej të priste dhe duhej të kishte durim që ta qartësonte figurën e Sefer Nezhës... A nuk ishte Sefer Nezha, i veshur xhandar, që i bëri atentat në mes të Korçës spiunit me nam Kurtali Hasit? Këtë të gjithë e dinë. Atëhere ishte ditë pazari. Shumë fshatarë kishin zbritur në Korçë të shisnin fasule dhe misër dhe të blinin ato që u duheshin. Kurtali Hasi me republikë dhe mustaqe të holla ecte nëpër pazar për të nuhatur ndonjë ilegal a ndonjë të dyshimtë të përzjerë me fshatarët. Sefer Nezha xhandar e ndiqte pas. Dhe në një kafene më të dalë të pazarit ata u takuan ballë për ballë. I qetë dhe gjakftohtë, Sefer Nezha bëri sikur nuk e njohu dhe i kërkoi Kurtali Hasit pashaportën. Ai u nxeh dhe aty për aty futi dorën në xhep dhe nxori librezën e spiunit. Sefer Nezha e mori në dorë, e lexoi dhe ia ktheu.

— «E more vesh?» — pyeti Kurtali Hasi.

— «Merre edhe ti vesh!» — i tha Sefer Nezha dhe e qëllloi tri herë me revolver.

Kurtali Hasi ra në pragun e derës së kafenesë i përgjakur, ndërsa Sefer Nezha humbi me vrap nëpër pazarin e fshatarëve i veshur si xhandar. Që prej asaj dite ai nuk



mund të rrinte në qytet si xhandar dhe doli malit me partizanët.

Ka njerëz që këtë ngjarje e dinë shumë mirë! — mendoj ai. Ne vërtet jemi larg Korçës, por për këto gjëra mund të pyetet. Si u hedhkan fjalët në erë? Fjalën po e hodhe në erë ecë e pa nxirre pastaj! — mendonte Sefer Nezha kur binte të flinte dhe kur ecte i vetmuar mes kopshteve të shkretuar të fshatit të rrahur nga era e vjeshtës së ftohtë.

Dhe një ditë e thirrën në shtabin e batalionit. Me ta thirrur, ai e ndjeu se kjo punë do të kishte lidhje me fjalët e Islam Bylykbashit. Në batalion kishte ardhur urdhër me shkrim nga shtabi i brigadës se në bazë të të dhënave të sakta dhe të pakundërshtueshme të Islam Bylykbashit, të Qerim Shagut, të Malko Agos dhe dëshmitarëve të tjerë, Sefer Nezha është spiun në fillim i futur nga italianët dhe tani nga gjermanët. Prandaj t'i bëhej gjyqi dhe të pushkatohej. Këto nuk ia thanë Sefer Nezhës. Dihej vetëm një gjë që komandanti i batalionit, megjithëse e thirri Sefer Nezhën dhe e çarmatosi, vendosi me mendjen e tij që të mos e pushkatonin tani për tani. Ai i dërgoi letër shtabit të brigadës, që të niste njerëz të Riza Kodheli për ta pyetur për Sefer Nezhën, pasi vetëm Riza Kodheli shkruante komandanti në letër e dinte dhe prandaj duhej gjetur dhe duhej pritur përgjigja e tij. Është e vërtetë se ai nuk dyshonte në ndershmërinë e Islam Bylykbashit që kishte hequr mbi kurrizin e tij gjithë ato mundime, nuk dyshonte as në çiltërsinë e Qerim Shagut, kryetarit të Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit dhe njeriut me ndikim të madh në gjithë krahinën, por sidoqoftë duhej marrë edhe mendimi i Riza Kodhelit. Në letrën e komandantit ishin edhe këto fjalë: «Unë nuk e pushkatoj Sefer Nezhën pa një urdhër të dytë».

*Shprehje*  
Sefer Nezhën e çarmatosur e mbajtën në arrest, duke e lënë të shoqëruar me dy partizanë, me Sadikun dhe Aleksandrin, në odën e Qerim Shagut. Dhe ai rrinte i mbyllur brenda katër mureve me dy roje, që para pak kohëve i kishte si dy djemt e tij më të dashur. Dera e odës hapej dhe mbyllej, kur ai kishte nevoja vetiake dhe kur e shoqja e Qerim Shagut me dhembje dhe duke pshe-rëtitur i shpinte të hante.

Për disa ditë e disa net tek priste i mbyllur të dilte



para gjyqit partizan, Sefer Nezha u thinj i tëri. Faqet i hynë në gropat e kockave dhe hunda prej shqiponje duke sikur i ishte zmadhuar pa masë. Ai i shikonte të dy djemtë e rinj partizanë në heshtje, duke psherëtirë plot pikëllim. Kishte dëshirë të ndjente prej tyre fjalën «xhaxha», por ky emër nuk do të dëgjohej kurrë. Të dy djemtë, Sadiku dhe Aleksandri qëndronin kokëulur dhe nuk guxonin ta vështronin në sy. Që në fytyrat e tyre ndjehej hija e mosbesimit. Nuk ishte e mundur që Sefer Nezha, njeriu i urtë, që i ruante këta të dy, si dy sytë e ballit, nga plumbi, që i mësonte se si duhej luftuar, të ishte një spiun. Kjo punë duhet të jetë ngatërruar! mendonin ata, duke shikuar këpucët e tyre në dyshtemenë e korridorit para odës, ku mbyllej Sefer Nezha.

Ata, që nga koha e çarmatosjes së Sefer Nezhës, edhe të zotin e shtëpisë, Qerim Shagun, mezi e takonin. Iu dukej i ftohtë dhe i largët. Këtë e ndjente edhe Qerim Shagu, që ecte me sy përdhe i zymtë. Edhe atij tani i ishte rënduar shtëpia, se kishte marrë një hije tjetër. Brenda saj rrinte një i burgosur, siç rri brenda gjoksit një brenjë dhe një ankth. Por ai kishte bindje të plotë që Sefer Nezha ishte spiun, se e kishte parë me sytë e tij, kur me italianët e mori Islam Bylykbashin dhe e kalbi nëpër burgje. Për këtë nuk kishte asnjë dyshim dhe mund ta thoshte kudo dhe kurdoherë që t'i vinte radha. Megjithatë, ai nuk do ta dëshironte që ngjarja e Sefer Nezhës të ndodhte në shtëpinë e tij, se e kuptonte që kjo nuk ishte një gjë e thjeshtë. Ishte një gjë e dhimbshme...

#### 4

Më në fund u kthye nga shtabi i brigadës Islam Bylykbashi, tani i veshur partizan me kapele me yll dhe me rrip të trashë mesit, ku varej një revolver i vogël. Fytyra e tij, megjithse e dobët, kishte marrë pakëz ngjyrën e kuqërremtë dhe balli nuk i dukej si një kafkë. Me ardhjen e tij shtabi i batalionit ia bëri gjyqin Sefer Nezhës, duke e dënuar me pushkatim. Në gjyq përveç tij morën pjesë edhe Qerim Shagu me Malkë Agon. Sefer Nezha e mohoi që kishte qenë spiun dhe tha se Islam Bylykbashin as e kishte njohur kurrë. Ai më në fund kërkoi që para se të



merrej vendimi, të dërgohej një njeri te Riza Kodheli andej nga Gora dhe Opari për ta pyetur se si qëndronte puna e Sefer Nezhës. Riza Kordheli nuk do ta kishte harruar. Por në gjyq iu tha se kishin kërkuar të dhëna nga Riza Kodheli dhe nuk kishin marrë ndonjë përgjigje. Me sa duket punën e Sefer Nezhës Riza Kodheli nuk e dinte. Partizanit që kishte dërguar brigada tek ai, i kishin thënë: «E ku e ka mendjen Riza Kordheli tek një njeri që paska qenë xhandar. Riza Kordheli çdo ditë është sa nëpër prita me gjermanët, sa duke pirë raki, sa me shoqërimin e Shtabit të Përgjithshëm. Ehu! Këtëj bëhet kërdua, ju na u merrkeni me ca xhandarë! Ama llaf!» Dhe në brigadë e kishin humbur shpresën. Pastaj ishte e palogjikshme të mos i besoje Islam Bylykbashit që ishte ndeshur sy ndër sy me këtë Nezhën dhe që kishte provuar mbi kurrizin e tij drurin dhe kamxhikun, çizmen me gozhdë dhe spicat në thonjtë e duarve dhe këmbëve.

Atëhere u caktuan shtatë partizanë nën komandën e Islam Bylykbashit për ta shpënë për pushkatim të gjykuarin Sefer Nezha. Në këta të shtatë bënë pjesë edhe Sadiku me Aleksandrin. Tre shkronin përpara me Islam Bylykbashin në krye dhe katër vinin pas. Sefer Nezha ecte mes tyre. Frynte një erë e ftohtë dhe e lagsht dhe vërshëllenin degët e kumbullave të zhveshura. Retë ngjyrë plumbi vraponin ulët nëpër qiell, herë duke u mbledhur pranë njëra-tjetrës dhe herë duke u larguar. Pas mezhdës së arës me bar të lagur ecnin të shtatë dhe Sefer Nezha tetë, ecnin shoku pas shokut të kërrusur, me fytyra të futura në jakat e palltove të vjetra. Tre të fundit përveç pushkëve kishin edhe dy lopata dhe një kazmë. Sefer Nezha nuk e fuste fytyrën në jakën e palltos dhe nuk mbrohej nga era. Ai ecte dhe shikontë herë retë që vraponin mbi kokën e tij dhe herë barin e lagësht që gërvishte këpucët dhe i spërkaste me ujë të ftohtë.

Mezhda e arës të shpinte në bregun e përroit, ku ngriheshin tri gorica të vogla me degë plot gjemba të murrmë, që vërshëllenin nga era. Sefer Nezha, tek vështronte të tri goricat buzë përroit, iu kujtua pa dashur, aty për aty, një këngë që e këndonin nga ana e Korçës:

Te gorica plakë  
Po ta bëjnë varrë,



Pleqtë po punojnë,  
Beqarët po qajnë...

Dhe ai psherëtiu. Këtë psherëtimë e mori era dhe e shpuri larg në grykën e përroit të thellë, duke e shtyrë nëpër gjembat e goricave.

— Këtu! — tha Islam Bylykbashi dhe të shtatë partizanët me Sefer Nezhën tetë qëndruan në mes të tri goricave.

Ata e vunë Sefer Nezhën të qëndrojnë katër hapa larg goricave dhe të shtatë i dolën përballë. I dënuari e mban të kokën lart dhe qëndronte me jakë të zberthyer pa asnjë shenjë urrejtje në fytyrë, bile me një buzëqeshje të lehtë që sa mezi i dukej.

— Ç'ke për të thënë, Sefer Nezha? — pyeti Islam Bylykbashi që komandonte të shtatë partizanët.

Sefer Nezha i vështroi të shtatë njerin pas tjetrit tek ua merrte cepat e kapotave era dhe u përgjigj:

— Më lejoni t'ju përqafoj të gjithëve para se të vdes!

Për një çast asnjë s'u përgjigj. Islam Bylykbashi u vrenjt dhe duke i rënë me pëllëmbë revolverit që kishte në brez tha:

— Do të përqafohesh me këtë...

Sadiku me Aleksandrin thanë me vete për Islam Bylykbashin: «sa i poshtë!» Pastaj thirrën njëzëri:

— Le të na përqafojë!

Islam Bylykbashi u lëkund, por nuk tha asnjë fjalë. Sefer Nezha u çapit me hapa të gjata me pallto gjer në fund të këmbëve, me jakë të zberthyer, dhe filloi t'i përqafojë me radhë të shtatë partizanët. Kur shkoi tek Aleksandri dhe Sadiku ai u përlot dhe tha nëpër buzë diçka të pakuptueshme. Edhe ata të dy filluan të qajnë me ngashërimë.

Pastaj ai iu afrua Islam Bylykbashit, që qëndronte i zbehët dhe i hollë, i futur në pallton e gjerë si një kërthi.

— Edhe ty do të përqafoj, megjithëse nuk të kam njohur! — tha ai dhe shtriu krahët.

Islam Bylykbashi i thatë dhe i rreptë u zbraps dhe Sefer Nezha e kuptoi që ai nuk donte të përqafohej. E vështroi për një çast drejt në sy, u kthye dhe shkoi në mes të tri goricave në vendin e pushkatimit.



— Gati! — urdhëroi partizanët Islam Bylykbashi me revolver në dorë.

Të gjashtë ngritën pushkët drejt Sefer Nezhës.

— Zjarr! — komandoi Islam Bylykbashi.

Dhe asnjëri nuk e zbrazì. Islam Bylykbashi-i vësh-troi me rreptësi.

— Ç'janë këto? Nuk dëgjoni? — thirri ai.

Nga radha e partizanëve u hodh Sadiku:

— Unë do ta mbaj për krahu Seferin, që kur ta marrë plumbi të mos bjerë menjëherë për tokë. Do ta mbaj dhe pastaj do ta lëshoj ngadalë që të mos i dhëmbë!... — tha ai me një zë dhe me një vështrim si prej fëmije.

Pa pritur që ta lejonin, ai shkoi dhe ia vuri dorën nën krahu Sefer Nezhës duke e larguar pakëz trupin. Islam Bylykbashi nuk e kundërshtoi, vetëm e vështrroi me habi.

— Zjarr! — thirri ai dhe pesë plumba ranë në gjoksin e Sefer Nezhës.

Atij iu morën këmbët, por Sadiku e shtrëngoi për krahu dhe e shtriu ngadalë për tokë në mes të tri goricave që vërshëllenin nga kamxhiku i erës së vjeshtës.

## 5

Batalioni përgatitej të nisej dhe ta linte krahinë, i rënduar nga pesha e vrasjes së një njeriu, të mbetur atje ku era i bie fyellit të tri goricave. Partizanëve kjo i dukej si një ëndërr në mesin e natës, që do të kalonte dhe përsëri gjendja do të ishte si më parë, përsëri Sefer Nezhë do t'u delte përpara i gjatë me hundën e një shqiponje. Por kur batalioni ishte gati për t'u nisur erdhën dy partizanë nga larg me një burrë të gjatë me pallto të murrme, me një fytyrë në formën e trikëndëshit dhe me një hundë si të shqiponjës. Burri vështronte herë djath-tas dhe herë majtas, duke i lëvizur sytë horizontalisht. Ai ndjehej i shqetësuar dhe i trembur. Partizanët u mblodhën rreth tij. E vështronin dhe nuk iu besonin syve të tyre. Ky burrë i shëmbëllente një për një Sefer Nezhës. Dukej sikur Seferi ishte nisur për rrugë të largët dhe tani ishte kthyer. Vetëm se ky i kthyer ishte më i dobët në trup dhe në fytyrë.



— Ç'bëhet kështu?! Ç'bëhet kështu, ju them! — thirri komandanti kur e pa këtë Sefer të dytë.

Këto fjalë nuk i drejtoheshin askujt. Ato vetëm oshëtinin nëpër batalion. Por ato gjëmuan në veshët e Islam Bylykbashit se ai i pranoi, se atij i takonin më shumë se çdo njeriu. E largoi turmën e partizanëve dhe shkoi e qëndroi ballë për ballë me burrin ashtu si në tri goricat ballë për ballë me Sefer Nezhën. Ia hodhi sytë të ardhurit, i qëndroi në fytyrën e tij dhe pyeti me zërin e tij të trashë, por të dridhur:

— Lefter Nezha?

— Unë jam Lefter Nezha! — tha ai pa u dridhur, ashtu si Sefer Nezha.

Islam Bylykbashi pështyu. Komandanti nuk u përmbajt:

— Pështy edhe veten tënde! — dhe ktheu krahët i egër dhe i ftohtë si era e dimrit.

Dy partizanët e ardhur i dhanë komandantit një letër që e dërgonte shtabi i brigadës. Në letër thuhej që të hiqej dorë nga pushkatimi i Sefer Nezhës, se kishte ndodhur një gabim i rëndë. Shtabi i brigadës i kishte kërkuar Riza Kordhelit, komandantit të famshëm të batalionit «Tomorri» që të dërgonte të dhëna për Sefer Nezhën dhe të thoshte mendimin e tij nëse e njihte. Riza Kordheli ishte shumë larg me batalionin e tij dhe përgjigja ishte vonuar. Vonesa kishte ndodhur edhe për arsye se komandant Kordheli kishte dërguar njerëz për ta kërkuar dhe për t'ia sjellë Nezhën e vërtetë, spiunin me dabënte kërkesën bashkë me një letër, ku shpjegonte për Sefer Nezhën që e njihte mirë. Aty nga fundi i letrës Riza Kordheli shkruante se «nuk ka më trim se Sefer Nezhë, që ia hodhi zorrët përpjetë mu në kafenenë e pazarit të Korçës spiunit surrat pekmez Kurtali Hasit». Shtabi i brigadës e mori Lefter Nezhën që dërgoi Riza Kordheli, dhe e përçolli në batalionin, ku ishte Islam Bylykbashi, për ta pushkatuar në vend Sefer Nezhës. Por ishte vonë. Komandanti shfryu mbi letrën e shtabit të brigadës, e mblodhi shuk dhe e futi në xhep i mërziur. Pastaj ai dha urdhër që të hiqet nga të tri goricat trupit i Sefer Nezhës dhe para atij varri të varet në njerën prej goricave spiuni Lefter Nezha. Trupi i Sefer Nezhës të shpi-



het në varrezat e fshatit me nderim të madh dhe me të shtëna pushkësh dhe mortajash. Kjo do të bëhej të nesërmen.

Islam Bylykbashi ishte krejt i humbur. Fytyra i ishte bërë si dhé e murrme. Ishte mbështetur në një kumbull dhe i binte kokës me të dy grushtat. Torturat që kishte hequr në burgje nuk ishin asgjë përpara këtyre të fundit. Ai mallkonte veten që u arratis nga burgu. Të kishte vdekur atje!

Qerim Shagu dhe Malkë Agua nuk guxonin të vështronin në sy partizanët. Kur iu dolën përpara Sadiku dhe Aleksandri, djemtë e rinj që rrinin me Sefer Nezhën, ulën kokat dhe një drithmë iu kaloi nëpër trup. Të dy partizanët, që provuan të parën tragjedi në jetën e tyre, u ndalën para Qerim Shagut dhe Malkë Agos, iu hodhën një vështrim nga koka gjer në këmbë dhe thanë:

— Për herën e parë ju na i dërmuat shpirtin! — dhe ikën të pikëlluar dhe të mbushur plot zemërim.

Të nesërmen, para se të bëhej varrimi me nderim i Sefer Nezhës, komandanti i batalionit me tre partizanët dhe me Qerim Shagun, kryetarin e Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit, shkuan në tri goricat. Ata çapiteshin nëpër erën e vjeshtës, duke mbajtur në gjokse brengën e fajësisë së madhe. Kur arritën në tri goricat buzë përroitë ndalën përnjëherësh të shtangur dhe bënë sikur të kishin të pesë një gojë të vetme: «Breh!».. Krah varrit të lagur të Sefer Nezhës e gjetën të shtrirë Islam Bylykbashin, mësuesin e dërmuar nëpër burgje. Ai shtrihej me sy të hapur drejt qiellit me re me gjurmët e dhembjes në fytyrën e dobësuar. Kishte vrarë veten...

Mbi varrin e Sefer Nezhës kishte vënë një tufë me degë pishë dhe me fije bari. Ishte vjeshtë dhe nuk kishite lule.

Komandanti i batalionit dhe Qerim Shagu hoqën kapulet dhe qëndruan në heshtje.



# Tronditja e madhe

## 1. 6asta

Ai mori grepat dhe u nis të peshkojë si zakonisht në mbrëmje në të perënduar të diellit. Ishte ngrohtë, se dielli ërë ditën kishte përvëluar si saç. Këtë radhë shkoi për peshk fill i vetëm dhe nuk e ftoi as edhe Mitin, shokun e tij të ngushtë, hetuesin e njohur të qytetit dhe njeriun më të ndershëm në radhët e peshkatarëve. Jo vetëm që nuk e ftoi, por nuk kishte dëshirë të gjente as kërkënd në vendin ku peshkonte, në gjirin e ngushtë të liqenit mes shelgjishtave dhe drizave. Atë mbrëmje bashkë me grepat mori edhe koburen që t'i ndodhej me vete për çdo rast në kohën e peshkimit.

Gjersa arriti në gjirin e liqenit, në qiell filloi mugë-tira dhe kodrat nisën të humbisnin qartësinë e formave të trre. Zuri një vend të fshehtë mes dy shelgjeve, nguli pesë hunj të vegjël dhe në secilin lidhi fijet e hollë të pesë grepave të tij. Në çdo hu vari nga një zilkë me tinguill që ndryshonte nga njëri-tjetri. Këtyre zilkave ai uanjihte zërat dhe sa herë i dëgjonte të tingëllonin, e merrte me mend se cilin fill tërhiqte peshku i zënë në grep. Atëherë me vrap, me një gëzim të përmbajtur, shkonte dhe tërhiqte peshkun, duke murmuritur: «të zura, të zura, s'ke ku të futesh!» Prandaj edhe shokët i thoshin: «të zura, të zura».

Në peshkim ai nuk kishte fat. Zinte shumë pak. Kjo



ishte arsyeja që gëzohej si fëmijët, kur peshku kafshonte grepin e tij. Por kjo ishte edhe arsyeja që shokët e tallnin dhe i kurdisnin lloj-lloj lodrash dhe gënjeshttrash. Shumë herë atë e merrnin me vete për t'u tallur dhe për të kaluar natën e gjatë pranë fijeve të grepave. Ndërsa zilkat e të tjerëve tingëllonin për herë, të tijat rrallë. Edhe kur tingëllonin dhe ai shkonte të tërhiqte fillin, në grep gjente një peshk të vogël. Kurrë ndonjëherë nuk kishte zënë peshk më të madh se gjysmë kile. Dhe çuditej me të tjerët që zinin edhe nga ata peshq që i kalonin të shtatë kilet!

Megjithse ishte në moshë të pjekur, mbi pesëdhjetë vjet, ëndërronte që të zinte një peshk të madh, një peshk që t'ua kalonte nëntë kilogramëve. Me një peshk të tillë do t'ua mbyllte gojën të gjithëve atyre që talleshin. Do ta merrte në sup dhe do të delte në rrugën kryesore të qytetit, që ta shikonin të vegjël dhe të mëdhenj. E mban, vallë, grepi një peshk kaq të madh? Duhet të jetë vështirë për ta tërhequr. Filli i grepit një herë duhet lëshuar dhe një herë duhet mbledhur, që peshkun, duke e gënjer duhet ta tërheqësh drejt bregut. Kur peshku është i madh që të mos shpëtojë nga grepi, mund ta qëllosh edhe me kobure. Po, po! Edhe mund të ndodhë — mendonte ai.

Kështu, i kredhur në mendime priste Servet Bleta i shtrirë në bar pranë hunjëve të vegjël me zilka. Ishte një qetësi e thellë me një hënë të verdhë në anë të qiellit dhe me një erë fare të lehtë dhe të ngrohtë. Gjiri i liqenit dikur ka qenë gryka ku derdhej Përroi i Kaçakut, që zbrit nga faqja perëndimore e malit. Kur u ndërtua hidrocentrali dhe u formua liqeni, gryka e përroit dalëngadalë e humbi emrin e saj të vjetër dhe u quajt Gjiu i Shelgjeve. Eh, mendoi Servet Bleta, koha është si uji! Në moshën njëzet vjeçare ai punoi në digën e hidrocentralit. Në atë kohë nuk e merrte me mend se do të vinte një ditë që të peshkonte dhe ta kalonte natën në breg të liqenit, duke ndjekur lundrimin e hënës nëpër ujë. Unë, mbase gabohen, or kam të drejtë të peshkoj në këtë liqen, se e kam krijuar vetë. Edhe peshqit pa mua këtu nuk do të tundnin bishtin. Edhe Dine Çartallozi pa këtë liqen nuk do të shpikte lloj-lloj lodrash dhe nuk do të tallej me mua dhe me ata që peshkojnë, — mendoi ai dhe iu kujtua se



si ky Dinia një herë i futi në grep një breshkë. Servet Bleta e dinte se ishte peshk, por, kur pa breshkën, u nxehe dhe nuk i foli Dines një muaj të tërë. Por këto gjëra që mendonte ishin jashtë natyrës së tij. Ai kurrë nuk delte jashtë natyrës. Këtu papritur doli! Nuk mburrej ai për këto gjëra, por sonte se ç'i kishte shkrepur as ai vetë nuk e merrte me mend. «Më duket se do të ndodhë ndonjë gjë e hatashme», — thoshte me vete. Vinte duart përpara gojës si përpara një burimi me ujë dhe murmuriste: «të më shohin!» Pastaj qeshte, duke vështruar sa më të djathtë e sa më të majtë me pëllëmbën para gojës: «hi-hi! Do të më shohin!».

Në të njëjtën kohë vinte në vete, puthiste buzët e holla, psherëtinte i penduar për ato që kishte menduar: «Çudi! Më duket se po ndryshoj natyrën time!»

Ndërkohë tingëlloi zilka. Servet Bletës i rrahu zemra. Tingëllimi vinte nga grepi më i madh. Ai u hodh dhe kapi fillin. E tërhoqi për një çast lehtë. Pastaj e ndjeu përsëri tërheqjen. Do të jetë i madh, — mendoi ai. Filli ia shtrëngoi gishtërinjtë. E liroi pak. Prapë filli u shtrëngua. Larg nën dritën e hënës që mezi vinte përmes shelgjishteve, në mes të ujit ai ndjeu se diçka e madhe dhe me kurriz të zi u hodh dhe u fundos përsëri. E po, ky fill s'besoj që ta mbajë, tha ai me vete dhe nxori koburen dhe qëlloi në vendin ku kishte hedhur grepin. Dhe në çast nuk u besoi veshëve të tij. U dëgjua një rënkim njeriu! Vetëm një rënkim dhe sagjë tjetër! Në këtë kohë u ndie edhe një krismë tjetër larg tij nga cepi i përtejme i gjirit të liqenit. Po kjo krismë nuk kishte të bënte fare me rënkimin që dëgjoi ai. Kushedi ndonjë peshkatar si ai kishte qëlluar në ndonjë peshk apo kot në ndonjë zog nate.

Rënkimi u dëgjua përsëri dhe diçka e zezë në pikën ku ai kishte hedhur grepin u ngrit përpjetë, pastaj u zhyt me zhurmë dhe gjiri u qetësua. Vetëm valët e vogla erdhën gjer pranë këmbëve të tij.

I hutuar dhe i tmerruar e tërhoqi grepin. Grepin ishte fare i lehtë. Në të nuk kishte asgjë. Me fill në dorë qëndroi i tronditur dhe i dërmuar me sy në mes të gjirit të liqenit. Asgjë nuk lëvizte. Nxinte vetëm uji. Mbi të vetëm fekste herë pas here drita e hënës. Zhveshi shpejt xhatetën, zbathi këpucët, i hoqi të gjitha ç'kishte dhe u hodh



në liqen. Notoi gjer në vendin ku kishte hedhur grepin, u vërvit nja dy-tri herë, u zhyt në thellësi të ujit, por asgjë nuk dalloi. Ndofta më bënë veshët, mendoi ai për të ngushëlluar veten dhe doli nga liqeni. Në breg e pushtuan drithmat.

U vesh, mblodhi të pesë grepat, mori gëzhhojën e fishekut të revolverit, e fryu një herë padashka dhe e hodhi në liqen. Uji u bë më i zi, se hëna ishte fshehur prapa malit. Edhe qielli mezi fekste. Servet Bleta, i vrarë, hodhi në krah torbën dhe u nis i vetmuar për në shtëpi. Ç'qe kjo gjëmë? Ç'fatzi paskam qenë? — tha me vete, duke ecur ngadalë me një brengë të rëndë në shpirt.

Ecte dhe i dukej sikur qëndronte në vend, sikur rruga nuk ishte e përbërë prej dheu, gurësh, uji dhe bari, po prej ere dhe resh. Njëpër këtë rrugë e ndjente veten të larguar nga kjo botë si njëpër një ëndërr të pambaruar. Dëgjonte nga një çast në tjetrin jehonën e atij rënkimit në gjirin e fshehur të liqenit pas krismës së kobures së mallkuar. Mes asaj që i dukej si ëndërr ai nuk e përfytyronte veten të arrinte në shtëpinë e tij, por diku në ndonjë ndërtesë pa formë dhe të papërcaktuar. Në jetën e tij nuk kishte ndjerë asnjë tronditje shpirtërore apo fizike. Çdo gjë i kishte kaluar e qetë dhe e lehtë, pa të përpjeta dhe të tatëpjeta. Ishte një nëpunës i heshtur i komitetit ekzekutiv të rrethit, një njeri që priste ta kalonte jetën akoma më të qetë sa t'i vinte koha e pensionit. Kurrrë nuk i kishte nxjerrë njeriu ndonjë telash, se të tjerëve iu mënjanohesh dhe nuk dëshironte të hynte në diskutime të mprehta dhe as në pasione të rrëmbyera. Edhe në mbledhjet e punonjësve zinte vend nga fundi i sallës dhe kur ulej në karrige i frynte, që të mos i ndoteshin pantallonat. I donte të gjitha të pastra, të gjitha të rregullta, të gjitha simetrike. Asimetria ishte e huaj për të. Mendonte, i shkreti, që të jetonte gjithmonë mes simetrisë. E kështu, atje në fund të sallës së mbledhjeve mbështeste faqen e lëmuar dhe të bardhë në pëllëmbë dhe rrinte e dëgjonte, duke i mbajtur sytë e vegjël dhe jash-tëzakonisht të zez vetëm në një pikë.

Këtëj njeriu nuk i vinte fare përshtat koburja, prandaj askush nuk e merrte me mend që ky të kishte një armë të tillë. Shumë-shumë Serveti mund të mbante një thikë të vockël për të prerë një mollë dhe për ta ngrënë



aty nga ora dhjetë e mëngjesit në përshtatje me rregullat e simetrisë së jetës së tij, të punëve dhe veprimeve të tij. Por koburja i kishte mbetur që nga koha e rinisë, kur kishte një farë gjallërie dhe kur nuk i përmbahej simetrisë. Që atëhere e kishte mbajtur të mbyllur në sirtar, por jo të harruar, pasi duke qenë një njeri që respektonte rregullin, e nxirrte për ta pastruar dhe e fuste fshehurazi përsëri brenda si me frikë, megjithse e kishte lejen e armës.

Por ndonjerit mund të mos i duket e përshtatshme që ky njeri të kishte dëshirë të shkonte edhe për peshk, pasi nuk ishte një natyrë peshkatari. Një mendim i tillë nuk është i drejtë. Peshkimi për Servetin ishte brenda rregullave të jetesës së tij dhe bënte pjesë në simetrinë, së cilës i përmbahej. Një njeri që do shëndetin e tij, kur pranë vendit ku jeton ka një lumë, një liqen apo një det, është e këshillueshme të shkojë për peshk. Kjo nuk është fare e jashtëzakonshme. E jashtëzakonshmmja dhe e papritura qëndron te koburja. Ç'iu desh Servetit ta nxirrte koburen pikërisht atë ditë nga sirtari? Megjithatë edhe kjo ka një arsye. Duke dëgjuar pranë peshkatarëve ku vendimet se peshku i madh mund të qëllohet edhe me kobure, ai me navitet mendoi ta merrte me vete këtë armë. Dhe që këtu e nisi fillin ajo që do të bëhej një tragjedi e madhe në jetën e tij dhe që do t'ia humbte një herë dhe përgjithmonë qetësinë.

## 2

Kur hyri në qytet ishte mesnatë dhe rrugët ishin të zbrazura. Ndrisnin vetëm dritat e trotuarëve dhe të vitrinave dhe nën dritën e tyre kalonte i qetë ndonjë polic apo ndonjë udhëtar i vonuar. Apartamenti i tij ishte pranë sheshit qendror, në krahun e djathtë të rrugës që hap pamjen e malit. Ai ngriti kokën të shikonte nëse ndriste ndonjë nga dritaret e dhomave, por asnjë dritë nuk i ra në sy. Të gjithë flenë, psherëtiu ai dhe ngjiti shkallët e apartamentit në majë të këpucëve, sikur të kishte frikë se mos zgjonte njeri. Para se të vinte te dera e tij, u fsheh në berrylin e shkallës dhe mbajti vesh, duke ndërprerë



për një çast frymëmarrjen. Këtë gjest e bëri vetvetiu pa e patur në mendje më parë. Qëndroi ashtu i tulitur, sikur të donte të mos dukej, dhe harroi për disa minuta se po kthehej në shtëpinë e tij. Papritur shtrëngoi të dy buzët e holla me dorë, e shtyu trupin me bërrylin që ishte mbështetur në betonin që lidhte parmacët e shkallëve dhe u kthye. Ashtu në majrat e këpucëve filloi të zbresë shkallët.

Rruga përsëri ishte e zbrazët. Trotuarit ecte vetëm polici. I heshtur dhe i drujtur, me torbën e peshkimit në sup, i kaloi në krah policit, qëndroi pakëz dhe u kthye. Në veshë i kumbonin këpucët e policit dhe me vete numëronte hapat e tij: një, dy, tri, katër, pesë... Polici bëri një hark të vogël dhe Serveti u ndodh përballë tij.

— Shoku Servet, sonte s'passe gjumë! — tha polici.

Serveti u hutua dhe i fluturuan nga mendja të gjitha fjalët që nevojiteshin për përgjigje:

— Si të të them!.. Hëm!.. Isha për peshk... Pô edhe gjumi!.. — belbëzoi ai duke përdredhur me dorë fundin e torbës.

— Zure gjë? — tha polici.

Serveti erdhi në vete dhe e mori vesh se polici e pyeste për peshkimin. Me dorë në fundin e torbës, duke u munduar të buzëqeshë, ai tha:

— Nuk zura, po edhe mund të zija! Khe-khe! — dhe u kollit.

— U kthyen të gjithë nga liqeni? — pyeti polici pa të keq.

Servetit i shpëtoi dora nga fundi i torbës dhe krahu iu var si një pendul i një ore të madhe të vjetër. Iu pre në këmbët dhe ndjeu peshën e revolverit që varej në rrypin e pantallonave e mbuluar me xhaketën bojë hiri. Pse më pyet ky nëse u kthyen të gjithë? mendoi ai dhe aty për aty u përgjigj:

— Unë isha vetëm. Mbase ishte edhe ndonjë tjetër, por nuk e pashë! Khe-khe! Mbase! — tha ai dhe u largua nga polici.

Duke u larguar fshiu me mëngë ballin e djersitur dhe ndaloi. Po sikur t'i them policit se qëllova me revolver në liqen? T'i them se e kujtova për peshk dhe qëllova. T'i tregoj edhe se ndjeva një rënkim... Jo, jo! Mund të më kenë bërë veshët..., mendoi ai në shesh para komi-



tetit ekzekutiv, ku ndriste dritarja e nëpunësit të shërbimit të natës.

Këmbët e shtynë drejt zyrës së nëpunësit të shërbimit të natës në komitetin ekzekutiv. Pse drejtohej andej? Ç'do të bënte te nëpunësi pas mesnate? As vetë nuk e dinte pse shkonte. Ai vetëm shkonte me torbën e mjeteve të peshkimit në krah, me sy të papërqëndruar dhe me mendje të paqartë. Dukej sikur tani sa ishte ngritur nga gjumi pas një dite të zgjatur e të madhe.

Përballë dritares së zyrës së nëpunësit të shërbimit të natës qëndroi dhe vështroi i përhumbur. Të vete a të mos vete?, — mendoi ai. Edhe të vete, ç't'i them? Edhe t'i them, a mund të marrë vesh gjë?, — pyeti veten dhe u kthye për të shkuar përfundimisht në shtëpi.

Në shtëpi hapi derën e kuzhinës, zhveshi xhaketën, e hoqi revolverin nga brezi dhe në majë të gishtrinjve të lagur nga djersa shkoi në dhomën e pritjes dhe e futi në sirtar, duke e mbyllur me kyç. Po ashtu në majë të gishtrinjve u kthye prapë në kuzhinë dhe u zhvesh i tëri në errësirë. U ul në kanape, pështeti të dy bërrylat në të dy gjunjët dhe mori kokën në duar. Ç'ke bërë, o derëzi, ç'ke bërë! — tha me vete dhe filloi të qajë me dënësë sikur ta kishte zënë lemëza, të qajë me një vajtim valë-valë, të pikëlluar dhe të hidhur. Lotët i rridhnin nëpër gishtrinj-të, kalonin në krahë dhe vinin gjer në majën e bërrylave të mbështetur në gjunjët. Kishte harruar me kohë të qante dhe nuk e dinte se sa lot mund të fshihte njeriu në *sytë e tij!* U kujtua për këta lot, kur iu lagën të dy *gjunjtë, ku rëndonin të dy bërrylat e thatë. Atëherë psherëtiu thellë, aq sa dërrasa e kraharorit u puthit me kurrizin,* dhe u ngrit. Vështroi nga dritarja sheshin përpara komitetit ekzekutiv, ku punonte, u përkul për të vënë re policin, por, si nuk mundi ta dallojë, u largua dhe mbeti më këmbë në mes të kuzhinës.

Donte të shtrihej në kanape dhe atje të mundohej të flinte dhe t'i kalonte ato tri-katër orë të natës, por u mendua dhe vendosi të shkojë në dhomën e gjumit në shtrat pranë së shoqes. Ata jetonin të dy në apartament. Një vajzë që kishin, ishte martuar dhe banonte me të shoqin më të dalë të qytetit.

E shoqja flinte. Ai e ngriti lehtë-lehtë cepin e çarçafit dhe u shtri pranë saj, duke mbajtur frymëmarrjen nga



frika që të mos e zgjonte. U shtri në kurriz me çarçaf gjer në qafë, megjithse nata ishte e ngrohtë. Me sy drejtuar nga tavani filloi të sjellë nëpër mend të gjitha ngjarjet e asaj dite, duke i mbledhur dhe i lidhur si ai montazhieri i filmit në laboratorin e tij të errët, ku i ndrit përpara vetëm një llambë e vogël për të dalluar figurat dhe peisazhet. Dhe tek i lidhte këto ngjarje në vetëdijën e tij ai dëgjoji një rënkim, që vinte nga thellësia e gjirit të liqenit. Nga ky rënkim ai u hodh përpjetë, siç bëjmë kur trembemi ndonjëherë në gjumë pas ndonjë ëndërre të llahtarshme. E shoqja në çast u zgjua dhe u kthye nga burri:

— Qenke vonuar, Servet! Si s'të ndjeva? — tha ajo e përgjumur.

Serveti u shtriq sikur flinte, se s'donte t'i jepte përgjigje. Po t'i jepte përgjigje zëri do t'i dridhej dhe ajo do të fillonte ta pyeste se ç'i kishte ndodhur dhe pse ishte i mërzitur. Më mirë të mos e marrë vesh tani natën, mendoj ai. Nata vetvetiu është e rëndë dhe lajmet e hidhura e bëjnë të padurueshme. Prandaj edhe të vdekurit nuk i qajnë me ligjërime natën. Të vdekurit i qajnë ditën. Kujet dhe gjëmat gjithmonë bëhen ditën. Njerëzit duhet të hyjnë të qetë në portat e natës. Në të vërtetë, kur i ze nata, fillojnë dhe trishtohen më shumë, megjithse e largojnë me dëshirën e tyre kujen dhe vajtimin. Ja, kështu mendoj ai dhe përnjëherësh diçka i feksi në vetëdijen e tij të mbuluar me mjegull. Atje në liqen qëlloi edhe dikush tjetër. Vërtet ai ishte larg meje, diku në cepin e përtejme, po qëlloi ama! Ai me siguri që e ka lënë edhe gëzhojën e armës atje në breg. Unë gëzhojën e hodha në, liqen dhe nuk lashë asnjë gjurmë dyshimi. Atij nuk i është kujtuar ta hedhë. Po ta ketë hedhur si unë, duhet ta ketë vrarë ai. Fundja edhe aq larg nga njëri-tjetri nuk kemi qenë. Plumbi i tij mund të fluturonte gjer tek unë! Po, po! bëri a dhe u ngrit përgjysmë në krevat, duke fërkuar duart dhe duke qeshur.

Gruaja u zgjua përsëri, hapi dritën e abazhurit dhe e gjeti të shoqin ndenjor në dyshek tek fërkonte duart e tek qeshte. Në fillim nuk i foli, pastaj e shtyu me dorë, sikur donte ta zgjonte:

— Servet, ç'ke që qesh?

Burri erdhi në vete dhe u gjend vështirë para së



*shoqes.* I erdhi turp se një gjë e tillë nuk i kishte ndodhur kurrë. U skuq dhe murmuriti:

— Ah, po! Ndofta kam parë ëndërr! — dhe u shtri të flerë.

### 3

Pesë ditë e pesë netë Servet Bleta nuk doli nga shtëpia. Nuk i hahej dhe nuk i flihej. I vinte për të vjellë dhe i merreshin mendtë. Ishte bërë i zbehtë si limoni dhe buzët e holla i ishin plasaritur si pas një temperature të madhe. E shoqja e tij u shqetësua dhe thirri në shtëpi mjekët më të mirë; i bëri analizat e verdhëzës, analizat e anemisë dhe të stomakut, por Servetit nuk i dilte gjë. Atëherë nevrologu i qytetit arriti në përfundim se Servet Bleta kishte një ezauriment të theksuar nervor dhe e këshilloi të çlodhej, të mos shkonte disa ditë në punë, të shetiste dhe mundësisht të shkonte për peshk. Sa dëgjoi «për peshk» ai u drodh dhe lëvizti nga karrigia. Por mjeku këtë nuk vuri re.

I mbyllur në shtëpi ai herë rrinte shtrirë dhe herë ngrihej, duke shëtitur në të dy dhomat dhe duke nxjerrë kokën në dritare për të parë njerëzit në rrugë dhe në sheshin e qytetit. Ditën rrinte vetëm, se e shoqja dilte herët në punë dhe kthehej në orën tre. Kthimin e së shoqes mezi e priste. Bile para se të vinte ajo, i mblidhej në gjoks një ankth dhe i dukej sikur do t'ia merrte frymën. Me t'u kthyer e pyeste se ç'të reja kishte nga qyteti dhe nëse kishte takuar ndonjë shokun e tij të punës. Lajmet që sillte ajo ishin të zakonshme. Ai priste diçka tjetër të padëgjuar dhe të tmerrshme. Dhe kur nuk e dëgjonte këtë të tmerrshmen, thoshte me vete: «mbase nuk është e vërtetë; mbase më kanë bërë veshët».

Por një ditë e shoqja, duke treguar për qytetin, i tha:

— Është zhdukur Dine Çartalozzi! Ka pesë ditë që ka humbur. Dyshojnë se ka kapërcyer kufirin dhe është arratisur!..

Servet Bleta u zverdh më shumë se ç'ishte në të vër-



tetë. Si zakonisht, i vuri të dy pëllëmbët në të dy faqet dhe belbëzoi:

— S'është e mundur të jetë arratisur! S'është e mundur!..

— E po ç'u bë? Mos e përpiu toka? Mos u mbyt në liqen?

— Edhe mundet! — tha ai i menduar.

— I ati dhe vëllezërit janë bërë pikë e vrer. Njerëzit flasin se Dine Çartallozi është arratisur dhe iu largohen prindërve dhe vëllezërve të tij. Të gjorët thonë se më mirë të jetë vrarë apo të jetë mbytur në liqen se sa të jetë arratisur. Dhe kanë të drejtë... — tha e shoqja, duke marrë pjesë në fatkeqësinë e prindërve dhe vëllezërve të Dine Çartallozit.

Servet Bleta nuk fliste. Rrinte me faqe të mbështetura në pëllëmbë dhe vështronte të shoqen me pikëllim. Ai gjer tani asgjë nuk i kishte treguar, se donte ta mbannte të fshehtë deri në fund të jetës së tij. Kur e dëgjoi gruan të tregonte për njerëzit e fatkeqit, e pushtoi një dhimbje e thellë. E solli nëpër mend të atin e Dines, atë plakun e kërrusur me shkop, me një kapelë republike të vjetër me anë të zverdhura nga koha, që ulej në një tryezë në qoshen e klubit të qytetit dhe pinte një kafe të hidhur dhe që e përshëndeste sa herë që e takonte. Tani për atë mendojnë se i është arratisur i biri dhe nga turpi ndofta nuk del fare nga shtëpia. Edhe ai është mbyllur brenda si unë! mendoj Serveti.

Dhe ai pasdite, kur ende nuk kishte përfunduar dielli, tek e shoqja thurte një triko me shtiza të gjata pranë dritares, nxori nga goja ngadalë, si një psherëtimë, një lajm të tmerrshëm:

— Dine Çartallozi nuk është arratisur! Atë e vrava unë!..

Të shoqes i shpëtuan trikua dhe shtizat nga duart. Në fillim hapi sytë e hutuar, pastaj thirri:

— Ç'thua! Luajte mëngç?

Servet Bleta uli kokën. Tani e ndjente sikur ishte shkarkuar nga një barrë e rëndë dhe në çast iu duk sikur u lehtësua. Por barra kaloi nga e shoqja.

— E vrava unë! — tha ai. — Kur peshkoja para pesë ditëve, padashur nëpër errësirë qëllova në liqen me revolver dhe e vrava. Ai më tërhiqte grepin. Unë kujtova se



ishte peshk i madh. Qëllova Dëgjova një rënkim. Ky rënkim paska qenë i Dines... — tha ai.

— Ti flet përçart, Servet! Nuk është e vërtetë. Ti s'vret dot një mizë. Ti ke parë ëndërr! — thirri ajo e zbehtë, duke u dridhur.

— Fatkeqësisht unë që s'vras dot një mizë, vrava një njeri!.. — tha ai dhe u ngrit e doli në dritare.

— Servet! I ziu Servet! — bërtiti gruaja, duke për-pjekur duart.

— Ç'është e vërteta, matanë bregut ku peshkoja unë qëlloi edhe një tjetër. Por ai që qëlloi ishte larg. Edhe mund të ketë fluturuar plumbi i tij gjer te Dine Çartallozi... S'ma merr mendja. E vrava unë! I gjori Dine donte të luante me mua, të bënte shaka. Unë padashur e vrava... — tha ai me sy nga dritarja.

Gruas i ndriti një shpresë. E zuri të shoqin për krahu dhe e hoqi nga dritarja:

— Servet, mund ta ketë vrarë ai tjetri. Ti the se dëgjove një të shtënë... Servet, asnjeri nuk e di këtë ngjarje! As ti vetë nuk e di! Pastaj Dinen akoma nuk e kanë gjetur dhe të mos e gjejnë... — tha ajo me lot në sy.

Servet Blea u ul përsëri në karrige përballë të shoqes. E vështronte ashtu të shqetësuar tek i dridheshin buzët dhe i dukej më e plakur. Ia vështronte flokët thinjë-thinjë, qafën me rrudha si pala të vogla. I vinte keq Servetit dhe psherëtinte Serveti. Mendoi si do ta linte fillikate kur të dënohej, përfytyroi pëshpëritjet e të tjerëve. Ja, Servet Blea vrau një njeri! S'e dinim që mund të arrinte gjer këtu!..

— Oh! — bëri ai. — Kjo qerrata jetë!

— Servet, më qafsh, mos e kujto këtë! Zëre se ke parë një ëndërr! — tha ajo.

— E, nuk është ëndërr, moj e shkretë! — psherëtiu ai.

— Ëndërr, Servet, ëndërr! — tundi kokën e thinjur gruaja.

Ai filloi të kërcasë gishtrinjtë e hollë me kokë mënjanë e me sy në truall.

— Unë do të shkoj në hetuesi apo në gjykatë! — tha papritur.

— Mos! — thirri e shoqja.



— Do të shkoj! Unë tani jam një i dënuar. Jam një i burgosur — tha ai dhe u ngrit.

E shoqja ia preu rrugën duke i vënë krahët në të dy anët e derës së hapur:

— Nuk të le, Servet! Më mirë vritmë! — u lut ajo.

Po nuk e mbajti dot. Ai doli dhe ndjeu erën e shka llëve që i fryu në fytyrë. Iu duk sikur iu morën mendtë nga që kishte një kohë të gjatë që nuk dilte nga shtëpia. I verdhë si nga një lëngim i rëndë, doli në rrugë. Duke ecur i dukej sikur e shikonin të gjithë. Ashtu, me drojtje dhe si i huaj për njerëzit e qytetit të tij, ku kishte lindur dhe ku ishte rritur, u drejtua nga ndërtesa e gjykatës. Shpejt u kujtua se ishte mbrëmje dhe në gjykatë në këtë kohë nuk punonte njeri. Bëri një herë me dorë në ajër mekanikisht dhe u kthye. Nesër! mendoi ai.

E kishte marrë malli për një kafe në klubin e qytetit dhe kishte dëshirë të zinte një tryezë dhe të rrinte pranë xhamit si dikur. Eh, dikur! Tjetër kohë ishte dikur! mendoi ai. Në çast ndjeu në sup një dorë. U drodh se i erdhi e papritur dhe ktheu kokën. Ishte Miti me syze të trasha, i hollë dhe i dobët, me fytyrë gjithmonë të qeshur.

— Ah, Miti! — bëri ai.

— S'të kam parë, Servet! As për peshk s'ke dalë! Mos ke qenë i sëmure? — tha Miti, duke qëndruar në trotuar.

— Kam qenë pak! — tha Serveti kokulur para Mitit.

— E, unë kam qenë disa mbrëmje me radhë për peshk dhe të kam kujtuar! — qeshi Miti.

— Po, po! Ty s'të rrihet!

U ulën të dy në një tryezë në klub dhe porositën nga një kafe.

— A, më ka ecur! Para pesë ditëve, sa e hodha gripin ndodhi një gjë e çuditshme! Një të tundur huri, një të tendosur filli! U hodha. E kapa fillin. E tërhoqa. Vingjer afër bregut, hidhej përpjetë dhe gati sa s'më merrte me vete. Dem i vërtetë! Atëhere nxora koburen dhe e qëllova!.. — tregonte Miti me pasion.

— E qëllove? — pyeti papritur Serveti.

— E ç'të qëlluar! Nejse, e tërhoqa ngadalë! Ç'të shoh? Një krap i madh mbi dhjetë kilogram.

— Breh! — bëri Serveti, duke harruar brengën e tij.



Erdhën kafetë dhe ata filluan të pijnë. Ndjehej vetëm rrufitja e filxhanëve.

— Mos e kisha qëlluar me kobure, nuk kisha për ta nxjerrë nga liqeni. Mezi e solla në shtëpi! — tha Miti pa e mbaruar së piri kafën.

Servet Bleta solli në mend natën e llahtarshme. Edhe ai atë natë qëlloi. Të dy qëlluan. Njëra e shtënë nuk harrohet. E shtëna e Mitit harrohet, mendoi Serveti. Dhe nuk mund të rrinte më gjatë në tryezë. U ngrit përnjëherësh dhe tha se i dhimbte koka dhe do të shkonte në shtëpi të shtrihej.

— Vërtet je pak i zbehtë! — tha Miti.

— E ndjej që jam! — bëri Serveti.

Para se të ndaheshin, Miti i tha si me keqardhje:

— E di që Dine Çartallozi ka humbur pa gjurmë?

Servetit i therri në zemër:

— E di! Më tha gruaja!

— Eh, shejtani! Na bënte për të qeshur kur shkonim për peshk! Po atë zakonin që futej nën ujë dhe të kapte grepin, e kishte të keq! Është bërë i ati që... Lere, lere! Pëshpëritin edhe shumë! Gjoja na qenkesh arratisur! S'e besoj! — tha ai.

— As unë! — tha Servet Bleta dhe ia dha dorën Mitit, mikut të tij të vjetër, të vetmit mik që kishte në këtë qytet.

Me kokë mënjanë hyri në shkallën e ndërtesës ku banonte.

## 4

Servet Bleta nuk shkoi as në gjykatë, as në hetuesi, i tërhequr nga të luturat dhe të qarat e së shoqes, se ishte njeri i butë dhe i pavullnetshëm. Pastaj nga arsyetimet e së shoqes për një kohë iu duk sikur vërtet nuk e kishte vrarë ai Dine Çartallozin. Filloi edhe të arsyetojë dhe të bindë vetveten, se dikush tjetër do ta ketë drejtuar plumbin pa dashur në trupin e zhytur në ujë të fatkeqit. Megjithatë ai kthehej në mendimin e fillimit se Dinen e kishte vrarë vetë. Mes këtyre arsyetimesh e gjeti e shoqja,



kur erdhi nga puna atë pasdite vere me re të bardha në qiell.

— Uh, ç'u lodha! — tha ajo duke u ulur me të hyrë.

— I ngjit me shpejtësi shkallët, prandaj! — tha Serveti:

— E gjetën trupin e Dines... — tha ajo e lodhur.

Serveti iu afrova.

— E kishte nxjerrë uji në breg të gjirit të liqenit. E kishin parë peshkatarët dhe kishin lajmëruar. Në qytet thonë se pas ekspertizës ka dalë që e kanë vrarë. Plumbi i ka rënë në ballë. Thonë se po kërkojnë ndonjë gjurmë në të dy brigjet e gjirit të liqenit... — tha e shoqja.

— Pas ditës së shtatë!.. E teta është sot!.. — mendoj me zë Servet Bleta.

— Pse flet marrëzira! — tha e shoqja — Ku e di ti se kur është vrarë! Një, një e të është mbushur mendja se e paske vrarë ti! Ik, ore me gjithë këto marrëzira!

Servet Bleta e vështroi të shoqen dhe qeshi hidhur «Hëm! Flas marrëzira!» përsëriti me vete fjalët e së shoqes dhe i tha se po dilte. Ajo i thirri të kthehej dhe të dilte më vonë, se tani ishte zagushi, por ai nuk donte të dëgjonte.

Në fillim hyri në klub, vështroi sallën rreth e rrotull dhe doli. Pastaj kërkoi në gjithë kafenetë e qytetit, po edhe atje nuk e gjeti. Servet Bleta kërkonte Mitin. Edhe në rrugë nuk dukej asnjë gjurmë e tij. Dhe ai vendosi t'i shkonte në shtëpi.

Qëndroi para derës, ku shkruhej «Miti Suli», mori frymë thellë dhe i ra ziles. Pas pak doli e shoqja, e ftoi të hynte, por ai nuk donte.

— Meqë s'qenka Miti, s'po hyj! — tha ai.

— Miti, sa u kthye nga puna, e thirrën me urgjencë... — tha ajo e qetë, pasi siç dukej kjo ishte një gjë e zakonshme për të.

Për Servet Bletën kjo nuk ishte e zakonshme. E thirrën me urgjencë, përsëriti me vete dhe u nda prej gruas. Me siguri e kanë thirrur për punën e Dines. Diçka duhet të kenë zbuluar. Por Miti është edhe hetues. Doemos edhe si hetues e kanë thirrur për Dinen! Si do t'i vejë filli? Eh, të mbarojë një orë e më parë kjo punë! Hëm! Kjo mbarojë menjëherë sikur të shkoj atje në hetuesi apo në gjykatë. T'u them: unë jam, më merrni! mendoj Servet Bleta



dhe e kuptoi se kishte dalë në rrugë. Në ecje e sipër nga larg vuri re Mitin dhe qëndroi. Miti ecte ngadalë dhe duke sikur nuk donte të kthehej në shtëpi. Syzet i kishin rënë mbi hundë dhe flokët i kishte të ngatërruara. Ecte i shpërqëndruar. Edhe Servetin që e kishte përrballë nuk e vinte re. Që me vështrimin e parë njeriu e ndjente se ai kishte një brengë të madhe.

— Miti! — thirri Serveti.

— E? — bëri Miti dhe ia dha dorën po me atë shpërqëndrim

— Je lodhur, Miti? — pyeti Serveti me një dhembje prej vëllai, dhembje që ndjehej që në zërin e dridhur dhe plot pikëllim.

— Ah, jo mor! Çudi, çudi! — tha Miti pa i lidhur fjalët.

— Shkojmë të pijmë një kafe?

Miti nuk vendosi menjëherë. Vështroi orën, pastaj ngriti kryet dhe ia hodhi sytë ndërtesës ku banonte, pastaj Servetit.

— Shkojmë! — tha më në fund.

Gjersa u ulën në tryezë nuk këmbyen asnjë fjalë. Serveti ia kuptoi brengën. Në thellësitë e vetëdijes ai ndjehej fajtor para Mitit, fajtor para të gjithëve, fajtor para qytetit. Por ky ishte një faj që erdhi pa dashur. Servet Bleta nuk ishte i zoti të bënte faje. Me siguri se po të kishte bërë gabime dhe faje në jetën e vet, po të kishte dalë nga ajo simetria e përpiktë e tij, nuk do ta kishte bërë fajin e parë, fajin e vetëm dhe të madh.

— E tmerrshme! — tha Miti me sy në filxhan, sikur zbrazësia e tij e mbushur me kafe të ishte një vrimë e pa-fundme.

— Çfarë? — pyeti Serveti.

— Një gjë e tmerrshme e papritur! — tha ai dhe e vështroi mes syzeve të trasha Servetin, që mbante filxhanin në dorë.

— Ndonjë keqkuptim?

— Dyshojnë se e kam vrarë unë Dinen.

— E nga dyshojnë?

— Kanë gjetur një gëzhgjë fisheku revolveri... — tha Miti.

— E ç'ë?



— Gëzhoja e fishekut është imja. Është ajo që mbeti kur qëllova atë natë... — psherëtiu Miti.

Servet Bleta kishte ulur kokën dhe vështronte në dorë filxhanin sikur të hidhte fall. Ai donte të pinte një cigare, megjithse kurrë në jetën e tij nuk e kishte ndezur. Kishte nevojë edhe për një helm tjetër, se shtatë ditë me radhë i kishte të mbushura me helm. Për këtë arsye u ngrit, shkoi në banakun e klubit, mori një paqetë cigaresh dhe një shkrepse, u ul në tryezë dhe e ndezi. Me gjithë atë brengë, Miti buzëqeshi, se nuk e kishte parë ndonjëherë të pinte cigare. Edhe ai vetë nuk pinte.

Me ta thithur dy-tri herë cigaren, Servetin e pushtoi një kollë që s'kishte të mbaruar. Ata që ishin në klub filluan të kthejnë kokat. Miti ia dha gotën me ujë, por kolla nuk i pushonte. Nga sytë i rridhnin lot dhe ishte skuqur nga shtrëngimi. Kolla i zgjati shumë gjersa e la dhe pastaj ndjeu një këputje të keqe në gjunjët. Më vonë i erdhi për të vjellë, por u përmbajt nga që ishte në klub. Vetëm nga diçka tjetër nuk u përmbajt. I erdhi një e qarë, i erdhi dalngadalë nga thellësitë e shpirtit të tij të vrrarë. Vuri duart të dyja në kokë dhe i mbështetur me bërryla në tryezë filloi të qajë. Miti e kuptoi që ai po qante. E ndjeu veten vështirë dhe i tha, duke iu lutur:

— Servet, mjaft tani! Mos u bëj fëmijë!..

Por Servet Bleta, nëpunësi i vogël i qytetit vazhdon-te të qante. U qetësua vetëm pas disa minutash. Atëhere ai vështroi nga xhami dhe vuri re të shoqen që kishte dalë ta kërkonte.

— Ngrihemi, Miti! — tha ai? — Nesër në mëngjes takohemi!

Miti buzëqeshi hidhur:

— Nesër në orën nëntë më thërresin në hetuesi!..

Servet Bleta u mpi. Prapa xhamit të klubit e priste e shoqja.

## 5

Të nesërmen në orën shtatë e gjysmë të mëngjesit Servet Bleta u ngrit hapi sirtarin, mori revolverin dhe mblodhi gjithë fishekët. Këputi një fletë letre nga një fle-



torkë e hollë, i shkroi diçka së shoqes, ia la mbi tryezë, duke ia vënë në cep përsipër gotën që të mos e merrte era, dhe doli. Ora tetë e gjeti në rrugë. I qetë, më i qetë se çdo herë tjetër shkoi në klub dhe porositi një kafe të rëndë. Priti në tryezë gjersa akrepat e orës t'i afroheshin nëntës dhe u ngrit.

Përpara hetuesisë pranë portës, Servet Blea u takua me Mitin.

— Po ti? — tha Miti.

— Unë e kam vrrarë Dinen. Unë qëllova atë natë! —  
tha Servet Blea.

Mitit i erdhi rrotull sheshi me gjithë ndërtesat.

— S'është e mundur! — tha ai.

Servet Blea nxori nga xhepi revolverin, ia zgjati përpara pa thënë asnjë fjalë dhe e futi në xhep.

— Në hetuesi! Ktheu, ti Miti! — tha Servet Blea dhe hyri në portë.

Miti qëndronte në heshtje. Sheshi me të gjitha ndërtesat vërvitej si nga dritarja e një treni të shpejtë...



# Nipi plëngprishës

## 1

Fshatin tani e kishin partizanët e shpërndarë nëpër shtëpitë mes të dashurve, grave dhe fëmijëve. Agush Tomorrica, komandanti i batalionit partizan «Shkrepëti-ma», zuri vend në shtëpinë më të dalë të fshatit nja njëqind metra larg korijes me dushk të dendur. Dielli kish-te kohë që të perëndonte dhe gjinkallat ende nuk ishin rralluar. Zhuzhitja e tyre delte nga koria dhe përhapej në gjithë fshatin. Por veçanërisht në shtëpinë ku rrinte Agush Tomorrica kjo zhuzhitje ishte e madhe dhe shurdhuese, sa nuk të linte të dëgjoje asnjë tingull dhe zë tjetër.

Nën këtë zhurmë Agush Tomorrica rrinte i menduar në çardhakun me dritare të mëdha të hapura, që vështro-nin nga koria e dendur me lisa dhe dëllinja. Mendonte për nipin e tij, komandantin e ballistëve, që e kishin zënë fshatin para se të vinte ai me partizanët. Tani, kur balli-stët kishin ikur të shpërndarë pa u marrë vesh me njeri-tjetrin, Agush Tomorrica dyshonte. I nipi duhet të ishte në fshat. Atë mund ta kishte fshehur e motra në bodru-min e ndonjë shtëpie të degdisur dhe të harruar. Kjo gjë nuk e linte të qetë dainë e tij, Agush Tomorricën. Por ai aty për aty dëshironte që ta zbulonte të nipin se ku ishte fshehur dhe aty për aty donte të mos e gjente përpara sy-



ve. I shmangej takimit ballë për ballë me të nipin, se e dinte që pas kësaj do të ndodhte ndonjë gjëmë, që e motra do të ishte e vështirë t'ia harronte. Prandaj edhe nuk shkoi të rrijë në shtëpinë e saj, por në të Kamber Rehovës, pranë korijes me dushk, që t'ia çanin veshët gjin-kallat.

— Si s'pushuan këto të nëmura! — tha me vete dhe doli në dritaren e hapur me vështrim nga korija, që dukej sikur bënte valë, sikur të ishte liqen i madh, pasi një ngastër ishte në hije dhe një ngastër tjetër në diell.

Poshtë nën dritare partizani që rrinte pranë tij Naum Shtika, një djalë i ri njëzetvjeçar me një kapele me yll të madh me cepa gjysmë pëllëmbë, kuvendonte me Kamber Rehovën, të zotin e shtëpisë, që mbante qillota shajaku me kopsa në anë të kërcinjve të këmbëve.

— Naum! — thirri Agush Tomorrica. — Ngjitu pak!

Naumi qëndroi në pragun e derës së odës, i ri me push të hollë mbi buzë, se ende mustaqet nuk i kishin dalë.

— Të shkosh e t'i thuash Sefkës së kompanisë së tretë, jo atij të së parës, të marrë nja dhjetë a pesëmbëdhjetë djem dhe të dalë ta kërkojë atë!..

— Tahir Grebenenë... — e ndërpreu Naumi.

— Tahir Grebenenë, nipin tim dhe komandantin e ballistëve që përzumë. Unë e di që është këtu. Vrimë më vrimë të kërkojë... Ta zerë e të ma sjellë! — urdhëroi Agush Tomorrica dhe u shtri në mimin me minderë, duke vënë duart prapa qafës me vështrim në tavanin prej druri.

Takimit me të nipin këtë herë nuk iu shmang dot. Po të ishte nipi i tij në ndonjë fshat tjetër edhe mund ta linte në heshtje, mund të mos e përfillte dhe të mos e kërkonte. Por këtu në këtë fshat të motrës së tij, kur e dinte me siguri se ishte fshehur, nuk mund të rrinte i qetë gjersa ta gjente. Nuk kishte se ç'të bënte. Partizanët e dinin se Tahir Grebenenë ai e kishte nip nga e motra. Hesh-tja ndaj nipit dhe moskujdesimi për të, do të thoshte që ai t'i jepte shenjë tërthorazi për të shpëtuar. Domethënë, ik, o nip, se unë do të bëj sikur nuk të shikoj! Gjer këtu nuk mund të arrinte Agush Tomorrica, komandanti i batalionit partizan «Shkrepëtima».

Para këtij batalioni ai nuk vinte asgjë, as djalin e vet



dhe as nipin. Me këtë batalion përplasi kokën Tahir Grebeneja, nipi i tij. Bashkë me Agushin ai doli në çetë partizan. Dhe kur çeta u rrit në batalion Tahiri u bë komandant kompanie nën urdhërat e xhaxhait të tij. Agush Tomorrica e donte këtë nip se e kishte si djalin e tij. Mban-te një palë çizme prej meshini në ngjyrën e mjaltit, një çantë hedhur krahut po me ngjyrën e mjaltit. I gjatë dhe me mustaqe të holla, kur delte para kompanisë Agush Tomorrica e vështronte dhe mburrej me të. Ky, mendonte Agushi, komandant brigade do të bëhet, gjeneral do të bëhet. I gojës ishte, i pushkës ishte, i vuajtjeve ishte... Por Agush Tomorrica më vonë e kuptoi se i nipi nuk ishte siç e mendonte ai. Dainë filloi ta quajë të vjetëruar, që nuk e njuh luftën e re, që zë prita si kaçakët dhe që s'di t'u flasë partizanëve. Dhe anës e anës këtë mendim ua kishte shprehur edhe shokëve të tij, komandantëve të kompanive, Sefkës dhe të tjerëve. Madje tinëz-tinës iu kishte thënë se komandant batalioni duhet të ishte ai, Tahiri. Këto pëshpëritje i kishin rënë në vesh edhe Agush Tomorricës dhe ishte bërë pikë e vrer pa vënë gjumë në sy tri netë. E kishte takuar, e kishte sharë dhe e kishte quajtur «burgjez» dhe «oficerkë zogist».

— Ti, dai nuk më do mua! — i kishte thënë Tahiri.

Agush Tomorrica ishte hedhur përpjetë.

— Të kam dashur! Kur bëhen njerëzit lapangjozë më dalin nga zemra. Dhe nuk i dua!

— Mos ki frikë, dai, vendin nuk ta ze! E ku pyesin malet nga dëbora! Ti pyet për ca fjalë që përhapin gënjeshtarët! — kishte thënë Tahiri.

— E di unë, e di! Unë kam sy edhe prapa kokës. Shikoj unë, shikoj! — kishte folur nën hundë Agush Tomorrica.

— Sefka është gënjeshtar! — kishte thirrur Tahiri.

— Mos bërtit! Sefka është burrë!

Agush Tomorrica donte ta thërriste Sefkën dhe ta vinte sy ndër sy me Tahirin, por kjo nuk iu duk e nder-shme. Njerëzit e zakonisht këtu nuk e bëjnë.

Më vonë Tahir Grebeneja e kishte ulur pakëz kokën, por ishte mërzitur dhe kishte rënë pas pijes dhe pas dashurikave. Njihte një vajzë, që i kishte lënë fjalën se do të fejojeshin dhe kur batalioni zinte vend pranë fshatit të saj, ai e linte kompaninë dhe shkonte e kalonte natën



me të. Vajza ishte e bija e Kamber Rehovës, që kishte ndjekur nja dy vjet shkollën Normale të Elbasanit dhe pastaj e kishte lënë. Ishte një vajzë e bukur me shkollë, që dinte të fliste dhe të mbahej, e veshur si qytetare. Kamber Rehova, me që e njihte Agush Tomorricën dhe e kishte mik, donte që të bëhej një krushqi e mirë dhe ta martonte Rushën e tij me Tahirin. E pëlqente edhe Tahirin, se në atë kohë nuk ishte për të mos e pëlqyer.

Por Agush Tomorrica e shihte vëngër këtë shkëputje të herëpashershme të të nipit nga kompania për të shkuar në takim me vajzën e Kamber Rehovës. E kishte paralajmëruar se do të kërkonte që ta shkarkonin si komandant kompanie dhe të vinin një tjetër. Atëhere Tahiri i kishte thënë:

— «Ti, dai, e ke zënë keq me mua!»

— «E ke zënë ti keq! Ke ardhur të luftosh, jo të bësh dashuri! Të lesh kompaninë dhe të sillesh pas fustanit të një femre!».

— «Unë nuk kam ikur nga lufta. Kur nuk luftojmë, shkoj e takoj! Po ti kërkon të më ulësh mua në sy të të tjerëve! Ti ke frikë!» — kishte thënë Tahir Grebeneja dhe kishte goditur çizmen e tij ngjyrë mjalti me një shufër shelgu.

Agush Tomorrica ishte bërë ngjyrë manushaqe në fytyrë. I nipi po luante mënc! Nga goja e tij rridhte lëngu i paturpësisë.

— «Ç'm'i kërcet çizmet me shufër si oficerkë, pusht! Shporrmu!» — i kishte shfryrë të nipit dhe pastaj i kishte dërguar fjalë Kamber Rehovës të vinte dhe ta takonte.

Kamber Rehova erdhi menjëherë dhe e gjeti Agush Tomorricën tek një mulli duke pirë duhan i mërziatur. Partizanët përgatiteshin për udhë në grykën e Devollit mbi Sinicë dhe Arrëz, pasi pritej që atje të kalonin gjer-manët. U takuan të dy dhe Agush Tomorrica i tha se Tahir Grebeneja nuk ishte për vajzën e tij. Ishte mirë që vajza vetë të mos e qaste dhe madje ta linte. Nuk duhej të bëhej kjo krushqi, se vajza do të merrej më qafë.

— «Unë e kam nip, por ai është një pizeveng me brirë!» — i kishte thënë më në fund Agush Tomorrica.

Kamber Rehova i bindej Agushit dhe ia dëgjonte fjalën, por këtë radhë i erdhi habi dhe me vete e quajti të rrjedhur:



— «Gjë që s'bëhet! Nuk prish unë një krushqi kaq të nderuar! Pastaj asnjëri nuk më beson që e prisha unë krushqinë. As vajzën s'e beson askush. Njerëzit do të thonë se Tahir Grebeneja e la vajzën. Tahirin e mban në gojë gjithë krahina për të mirë. Gjë që s'bëhet! Mbase të del inati. Ne jemi me huqe, Agush!»

Agush Tomorrica ia dha dorën në portë të mullirit: — «Unë ç'pata, ta thashë! Ti bëj si të duash».

Atë ditë batalioni zuri vend mbi Sinjë poshtë Arrëzës dhe Videhovës. Kompania e Tahir Grebenesë zuri pritë nën Vidëhovë në të dy anët e përroit nën shkëmbenjtë të rrethuar me dushqe, të sapo zbardhur nga një dëborë e lehtë. Gjermanët pë vonoheshin dhe Tahir Grebeneja mendoi se ata do të vinin të nesërmen në mëngjes. Prandaj e la kompaninë në pritë dhe u nis për në fshat te çupa e Kamber Rehovës. Fshati nuk ishte larg dhe ai sidogoftë mund të kthehej shpejt në kompani. I dërgoi fjalë Rushes, vajzës së Kamber Rehovës, dhe ajo shkoi në shtëpinë e Xhires, nënës së Tahirin. Ishte e pastër, e bukur, me një qafë të gjatë dhe me një gropëz të vogël në mjekër. Xhirja, që e donte këtë çupë, i la vetëm në odë, se shtëpia nuk kishte njeri, burri i kishte vdekur me kohë dhe i kishte mbetur veç Tahiri. Dhe ç'donte Tahiri, bente Xhirja, e ëma e tij, që i ngjante një burri të guximshëm.

Me Rushën u shtrinë bashkë në dyshek dhe ajo e përkëdhelte, e puthte dhe e donte si e marrë. Por duke e përkëdhelur, i tha:

— «Kam frikë për ty, Tahir!»

— «E pse ke frikë?»

— «Po ti ikën nga batalioni dhe vjen tek unë! Nuk duhet të vish kaq dendur!»

— «Po pse të dua, pa vij» — tha ai dhe e puthi në sytë, në mjekër, në qafë, në gjoksin e bardhë dhe në portokajtë e gjoksit.

— «Më duket sikur nuk do të kthehet kjo mbrëmje!» — tha ajo e përvëlur si pas etheve.

Tahir Grebeneja qeshi:

— «E di se ç'thotë Çajupi? Kam lexuar një libër, që e kam gjetur në Korçë në librarinë Pepo»:

— «E ç'thotë?» — pyeti ajo.



Është e jona këjo natë,  
Zoti e bëftë të gjatë!

Dhe ata qeshën të shtrirë në dyshekun me lesh dy pëllëmbë të lartë.

Kështu e kaloi Tahir Grebeneja natën dhe nuk e dinte se ç'bëhej andej nga batalioni. I gëzuar e kaloi vërtet, por diçka parandjente dhe për diçka trembej. Po sikur të kenë vajtur atje gjermanët?

Ç'eshtë e vërteta gjermanët erdhën të nesërmen. Filloi përpjekja. Partizanët i mbajtën gjermanët gjatë, pasi grykat ishin të vështira për t'u kaluar nga ata që nuk i njihnin. Por papritur në vendin ku ishte kompania e Tahir Grebenesë ata e çanë qëndresën dhe i dolën batalionit nga lart. Kompania kishte mbetur pa komandant. U vranë katër-pesë partizanë bashkë me nënkomandantin e saj. Agush Tomorrica kujtoi se e humbi gjithë batalionin dhe nga mërzia i ra me kokë një lisi me dëborë. Dëborë ra mbi trupin e tij dhe ai erdhi në vete.

Kur erdhi duke vrapuar Tahir Grebeneja ishte vonë. Vetë ai kishte marrë një plagë në vrapim e sipër për të arritur batalionin. Ishte zvarritur dhe i kishte takuar partizanët, pasi kishin ikur gjermanët. Agush Tomorrica i kishte rënë dy herë me pëllëmbë në të dy faqet dhe e kishte pështyrë. Që atë mbrëmje e kishte shkarkuar si komandant kompanie dhe kishte vënë në vend të tij Sefkën, një partizan të ri, që dikur kishte qenë bari dhensh.

Tahir Grebenenë donin ta dënonin me pushkatim, por meqë ishte i plagosur e falën, duke e lënë si partizan të thjeshtë po në atë kompani. E ku duronte Tahir Grebeneja të ishte nën urdhërat e Sefkës? Dhe një natë u ngrit vjedhurazi-vjedhurazi, e plagosi rëndë Sefkën dhe u zhduk nga batalioni.

Më vonë u muar vesh se Tahir Grebeneja ishte hedhur nga ana e ballistëve. Dhe meqë kishte një nam të madh për familjen e tij, u bë komandant batalioni në forcat e Ballit Kombëtar. Në këtë batalion ai i zbukuroi më shumë rrypat, çizmet dhe jakat e tij. Ecte dhe vetëntine rruga. Madje edhe gjermanët rastësisht kur e vështronin në ndonjë qafë mali, apo në ndonjë fshat a qytezë thoshin: «I rregullt si gjerman!». Por e bija e Kamber Rehovës nuk dëshironte një komandant të tillë. Ajo e donte



Tahirin siç ishte më parë, partizan. Megjithatë, ishte e vështirë të shkëputej prej tij. Kishte diçka të fshehtë, hë për hë të padukshme që e lidhte me të, megjithse i ati, Kamber Rehova i shkretë, i lutej që ta braktiste këtë njeri. Por ai nuk e dinte se ajo priste një fëmijë.

I rraskapitur në shpirt Kamber Rehova i shkoi përsëri kokëulur Agush Tomorricës në batalion dhe i kërkoi ndjesë:

— «Vritmë me dorën tënde, Agush!»

Agush Tomorrica, duke i rënë me pëllëmbë në krah dhe pastaj duke e shtyrë me krahun e tij të fortë, tha ngadalë me buzë gjer pranë veshit të Kamberit:

— Na duhen plumbat, Kamber!

— «Ah, more Agush, po ma ka lënë çupën me barrë i mallkuari!» — tha Kamberi me lot në sy.

— «Hëm! — bëri Agushi. — Ai hambar ishte, ai misër do të hidhej në hambar!» — dhe e vështroi me inat Kamber Rehovën.

## 2

Agush Tomorrica kishte mbetur gjatë i shtrirë në mimin me minderë dhe kishte dremitur, kur erdhi e motra me një çember të zi gjer në gjysmën e ballit. Ai u ngrit përgjysmë nga mimi dhe e përqafoi.

E motra u ul pranë tij dhe ia hodhi dorën e ligur në supa me një pshërëtimë të thellë.

— Agush, pse nuk ke ardhur në shtëpi? Ç'paske zënë vend të Kamberi në anë të anës? — tha ajo me sy gjysmë të përlotur.

— E di ti, Xhire, e di! — tha Agush Tomorrica pa e vështruar në sy.

Xhirja kryqëzoi të dy duart në gjoks dhe tundi kokën e heshtur. Nga korija dëgjohej kërkërima e gjinkallave dhe pëllitja e ndonjë lope që kthehej nga kullota pranë vëçit të saj.

— Agush, — tha ajo — partizanët e tu po bastisin nëpër fshat...

— E pse të ha merakun ty? Bastisin, le të bastisin! — tha ftohtë i vëllai.



Kamberit iu ngatërruan mendimet dhe nuk dinte ç't'i thoshte mikut të tij: kishte apo s'kishte faj e bija.

— Të priste sa të martohej, pastaj të bënte ato lodra natën nëpër plevica me një zuzar! — tha Agush Tomorrica i pushtuar nga një valë inati.

— Ku e dinte ajo se...

— Edhe ti ke faj që i lije! — tha Agushi dhe u ngrit të vështronte nga dritarja.

— Agush, lere, mos e vrit! Ai mund të kthehet përsëri me partizanët. Njeriu gabon në këtë jetë! — tha Kamberi.

— Edhe motra ime këto fjalë m'i pëshpëriti në vesh! — tha Agushi duke vështruar nga dritarja.

Zhurma e gjinkallave tani ishte rralluar se dielli po perëndonte. Nuk duhej shumë kohë sa të vinte mbrëmja dhe ende i nipi i Agush Tomorricës nuk ishte gjetur. Po të zbriste nata ai nuk do të gjendej kurrë. Mes errësirës do të ikte dhe do të bashkohej me ballistët e shpërndarë në ndonjë anë. Prandaj Agushin nuk e zinte vendi. Megjithatë ai kishte një dëshirë të mjegullt, që buronte nga thellësitë e nëndërgjegjes: më mirë i nipi të ikte dhe të gjente vdekjen nga ndonjë tjetër dhe jo nga dora e tij. Atëhere atij nuk do t'i vinte keq.

Dhe ndërsa bluante këto mendime, diku larg u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe të tjera të lehta, që duhet të ishin krisma revolveri. Mos erdhën ballistët? mendoi ai. U dëgjuan edhe dy-tre të tjera dhe për një çast heshtën.

— Ç'janë këto? — tha Kamberi dhe shkoi pranë Agushit që vështronte nga dritarja.

Agush Tomorrica për një çast nuk i dha përgjigje, pastaj mblodhi supet:

— S'e marr vesh!

Ndërkohë erdhi në çardhak me vrap Naum Shtika. Ai tha se Tahir Grebeneja ende nuk ishte gjendur, por nëpër fshat flitet se po vijnë gjermanët. Agush Tomorrica e vështroi nën vetulla Naumin:

— Nuk lëvizin gjermanët natën, budalla! Po shko i thuaj Sefkës të ma gjejë shpejt Tahir Grebenenë.

Naumi doli me vrap siç kishte ardhur, ndërsa Agush Tomorrica i ra ballit me shuplakë dhe filloi të qeshë. Qeshte dhe fliste me vete. Këto të shtëna i mori vesh se nga vinin dhe të kujt ishin. Pastaj e qeshura iu shua në fyty-



rë dhe u zëvendësua me një pikëllim të hidhur. Mëkatë!  
tha ai me vete. Ah, ç'mëkatë! Nga një grua e tillë si Xhi-  
rja, të dalë një këlysh i keq si Tahiri! Ah, Xhire, Xhire!

— Ç'thua?! — pyeti Kamber Rehova duke dëgjuar  
Agush Tomorricën që fliste me vete.

— Hiç, asgjë! Mendoj! — tha Agush Tomorrica dhe e  
ftoi Kamberin të uleshin.

Sa filluan të pinin, përsëri u dëgjuan të shtëna.

— Mos erdhën ballistët? — u shqetësua Kamber Re-  
hova, ndërsa Agushi murmuriste:

— Nuk janë gjë, por pi! Pi, Kamber, pi!

Kamberi hapi krahët:

— Më vjen habi me ty, Agush!

— E pse të të vijë habi?

— Ty të duket si lojë lufta. Dëgjon pushkë dhe thua  
se s'ka gjë!

— Pi, Kamber, pi! E di unë se kush qëllon! — tha  
ai.

Me nuhatjen e një njeriu të regjur nga lufta Agush  
Tomorrica e kuptoi se Xhirja kishte dalë dhe qëllonte në  
erë me pushkë dhe me revolver, që partizanët të kujtonin  
se po vinin ballistët apo gjermanët. Me këtë ajo mendon-  
te të shpëtonte të birin. Eh, ç'i pjell mendja nënës së  
shkretë! — mendoi Agush Tomorrica për të motrën.

— Po të ma sjellin Tahirin, nuk do ta vras! Do ta  
dërgoj në shtabin e brigadës. Mbase nuk e dënojnë! — tha  
ai me zë të lartë në çardhak ulur në mim pranë Kambe-  
rit.

Kamberi prapë i habitur me Agush Tomorricën mblo-  
dhi supet:

— Ç'flet kështu, o Agush? Mirë bën që flet.

Agushi e kuptoi se ato që mendonte i fliste me zë të  
lartë dhe u zemërua me vetveten.

— Eh, jemi të rrjedhur, o Kamber vëllai! Por ato të  
shtëna që dëgjove, janë të Xhires. Motra ime qëllon që të  
ma humbë mendjen dhe të shpëtojë të birin.

— Jo, more! — tha Kamberi. — Eh, e shkreta.

Qëndroi edhe pak me Agushin dhe zbriti shkallët,  
duke e lënë të vetëm.

Agush Tomorrica u lehtësua që iku Kamberi. Donte  
të ishte i vetëm, të pinte raki në heshtje pa njeri.

Që nga hashefi poshtë dëgjoheshin të shara e të thi-



rrura. Kamberi i bërtiste të bijës për turpin që kishte bërë. Agush Tomorrica dëgjoi poterën dhe u pendua që i foli rëndë Kamberit për të bijën.

— Eh! — psherëtiu ai. — Edhe ky Kamberi i zi me këtë çupë!..

Në këto e sipër ai vuri re në lëndinën para se të fillonte korija një njeri që po vraponte. E njohu. Ishte Tahir Grebeneja, i nipi, biri i vetëm i së motrës.

Do ta le të ikë! Në djall të vejë! mendoj për një çast. Por pastaj u pendua... Mori pushkën, e vuri në shenjë dhe qëlloi.

I nipi u hodh, u kthye nga dritarja, ku qëlloi Agush Tomorrica, u mënjanua, por nuk ra. Ashtu në këmbë qëndroi gati një minutë dhe pastaj thirri me zë të lartë dhe të qartë:

— Më vrave, dai!

Hodhi edhe dy-tri hapa përpara, u shtri në bark dhe filloi të zvarritej për të arritur në dushkun e dendur të korijes. Agush Tomorricës i gjëmonte në veshët zëri i njohur i të nipit «më vrave, dai» dhe i mbeti i ngrirë në sytë e plakur trupi i tij më këmbë pranë dushqeve të gjelbër të korijes, ku këndonte gjinkalla e fundit. Dhe me pushkë në dorë ngriu në dritaren e hapur të çardhakut. Nuk e ndjeu as ballin e mbuluar me djersë të ftohtë, djersë që kishte mbushur gjithë rrudhat e thella.

### 3

Kamber Rehova me të dëgjuar pushkën që qëllonte nga dritarja e shtëpisë së tij, e la të bijën dhe ngjiti me vrap shkallët. E gjeti Agushin më këmbë me pushkë të ulur në mimin me minderë dhe me vështrim nga korija.

— Ç'bëre? — pyeti ai.

— Atje kaloi... Qëllova... — tha Agushi.

— E?

— Duhet të ketë vdekur në dushqe... — tha Agush Tomorrica gjithmonë me vështrim nga korija.

Të dy burrat heshtën gjatë gjersa nëpër shkallët dëgjuan hapa të shpejtë dhe rënkime. Vinte e motra e Agush Tomorricës e çjerrë dhe me këmbë të gjakosura nëpër



gurë dhe ferra. Pa e përfillur Kamber Rehovën, ajo e zuri të vëllanë për jake, e tundi dhe i thirri me një zë që dëgjohej si lebetimë:

— Ç'ma bëre djalin, Agush!

Agush Tomorrica heshtëte para t'ë motrës të mbërthyer me duar për jakën e xhaketës së tij.

— Ç'ma bëre djalin, vëlla! — përsëriti ajo pa i lëshuar duart nga jaka e Agush Tomorricës.

I vëllai ktheu kokën nga korija dhe me mundim të madh, sikur lëvizte një shkëmb, tha:

— Atje!.. Mes dushqeve!..

Ajo u zbe e tëra. U duk sikur edhe sharpi i zi mbí ballë u bë i zbehtë. Pastaj u mpi në trup dhe i vari krahet në minder. Por kjo zgjati vetëm për një çast. Pa e vështruar të vëllanë zbriti shkallët, duke u mbajtur nëpër parmakët. Poshtë në hashef u dëgjuan zëra grash. Kamberi e njohu zërin e të bijës. Dhe nga dritarja e hapur e çardhakut të dy me Agush Tomorricën panë dy gra që vraponin njera pas tjetrës. Përpara vraponte e motra e Agush Tomorricës dhe pas saj vinte e bija e Kamber Rehovës.

Tanimë kishte rënë muzgu i dendur dhe korija nxinte. Nëpër këtë muzg pranë korijes Agush Tomorrica dhe Kamber Rehova panë dy drita të vogla që uleshin, ngriheshin dhe lëviznin drejt dushqeve. Ndriste kandili i së motrës së Agushit, ndriste kandili i së bijës së Kamberit. Të dy dritat kërkonin Tahir Grebenenë, njëra të birin, tjetra të fejuarin...

Agush Tomorrica dhe Kamber Rehova kryqëzuan vështrimet.

— Breh! E vrave, Agush! — tha, duke zgjatur fjalët Kamber Rehova me sy nga dy dritat e dy kandilëve.

— S'kisha ç'të bëja, Kamber! — psherëtiu Agush Tomorrica dhe mbylli dritaren.



# Egërsia

## 1

Jeta ndonjëherë është e tmershme, or mik.  
Disa në këtë jetë kanë patur fat më të  
llahtarshëm se ata që ranë në luftë, or mik...

Nga në bisedë

Kali im ndali para portës së avllive të larta. Ai që  
ngrohej në diell bashkë me një qen të madh e të dobët,  
shikoi nga unë i frikësuar dhe u ngrit.

— Mu-mu-mu! tha diçka të pakuptuar nëpër hundë  
dhe shtyu portën. Edhe qeni e ndoqi dhe u fsheh prapa  
portës. Pas pak, kanata u hap prapë dhe unë pashë një  
fytyrë të shtrembëruar dhe një gjuhë të gjerë të dalë në-  
për dy buzë të trasha si mëlçi.

Mu-mu-mu — bënë dy buzët e trasha si mëlçi. Edhe  
qeni e nxori surratin e tij të shëmtuar e të përgjumur dhe  
më hodhi një vështrim indiferent.

— Cili është ky që po më saluton me një delikatesë  
të tillë? — i thashë shoqëruesit tim, që kish zbritur nga  
kali dhe qeshte.

— Gani, Gani! Ky shoku do të na vjedhë qenin! —  
i thirri shoqëruesi im njeriut me qen.

— Ti pyet se cili është ai? Nuk e ke dëgjuar, Gani



Bredhin? — u kthye nga unë shoku im. — Gani Bredhi është me nam këtej.

E atëhere, nëpër atë portë të vjetër me një kanatë të kalbur e të mbërthyer me copra llamarine, para syve të mij rrodhi një jetë me aq trazira dhe aq drithërima, sa unë druhem ta shkruaj se do të duket si një përrallë e frikëshme, e pabesueshme...

Ndodhi kështu! Në një dimër të ngarkuar me dëborë, në këto anë, u vunë re ca të panjohur.

Në fillim, ata dukeshin e zhdukeshin nëpër portën e kësaj shtëpie të shtyrë rrëzë malit, pastaj humbën. Po kjo kanatë, mbrëmjeve kërciste dhe këtej dilte një njeri me një thes mbi shpinë. Njeriu merrte përpjetë malin dhe kthehej, kur fundosej në errërsirë edhe mali, edhe shtëpia me avlli, edhe porta me kanatë të kalbur.

Një ditë, para portës erdhën tre veta me automatikë, erdhën nëpër dëborë dhe erë. Ata trokitën në kanatat e ngrëna nga krimbi. Një grua, me fytyrë të verdhë e me sytë me rreth mavi, hoqi llozin dhe njerëzit me automatikë hynë brenda. Pranë oxhakut ngruhej një burrë, i cili kur i pa të ardhurit, u ngrit në këmbë. Ishte i gjatë dhe duart i kishte të mëdha. Qëndronte i heshtur dhe gjakftohtë.

— Në emër të popullit je i arrestuar! — tha njëri nga ata të tre. Gruaja dhe një djalë dymbëdhjetëvjeçar shikonin pa folur herë burrin e gjatë, herë ata të tre, herë njëri-tjetrin. Porta u hap. Njerëzit me automatikë dhe burri i lidhur u zhdukën në bardhësinë e dëborës që hidhte era.

Nuk kaloi ndonjë kohë gjatë, kur në prag të portës u dukën përsëri të tre njerëzit me automatikë dhe burri, i cili këtë herë duart nuk i kishte të lidhura.

— Mund të ketë qenë ndonjë gabim! — i tha njëri nga ata gruas në hajat, kur dy të tjerët ishin ulur me të zotin e shtëpisë pranë zjarrit, mund të ketë qenë tjetër kush ai që u shpie diversantëve bukë. Po ne kemi patur informata, se një njeri çdo mbrëmje dilte nga kjo portë me një thes mbi shpinë...

Dymbëdhjetëvjeçari dëgjonte dhe shikonte një herë të atin, një herë njerëzit e sigurimit. Duke gjykuar, sipas fytyrës së tij, nuk i vinte mirë që ndodhi në këtë mënyrë. Ai diçka donte të thoshte, diçka që ndofta kishte shumë



kohë që e kishte menduar, po heshtete. Kjo dukej në sjelljen e tij, në qëndrimin e tij, në fytyrën e tij. Duke e vështruar ate mund të arrije në përfundim, se ai nuk ishte një fëmijë dymbëdhjetëvjeçar, po një djalë i pjekur, me logjikë dhe forcë vullneti. Dymbëdhjetëvjeçari tha:

— Unë e di kush është ai njeri që del me një thes në kurriz çdo mbrëmje; unë e di. Ai në thes fuste edhe mish dele, bile edhe një dash të therrur. Ky është babai im. E kam marrë vesh. Ai mban diversantët me bukë.

Burri u ngrit. Rrëmbeu sëpatën që ishte në qoshe të dhomës dhe u turr nga fëmija. Të dy të tjerët e kapën. Gruaja ngriu në këmbë. Duart e atij përsëri u lidhën...

## 2

Tetë vjet kaluan në oborrin e asaj shtëpie pa u ndjerrë zëri i të zotit. Po në një vjeshtë, kur ahet filluan të hëdhin fletët mbi çatinë e vjetër, njëra nga kanatat e portës u hap dhe në oborr hyri burri. Ai ishte mplakur, sytë i ishin thelluar dhe kokën e kishte të qethur. Kthehej nga burgu. Djali, tanimë njëzetvjeçar, iu hodh në qafë, gruaja qeshi. Burri qëndronte i ftohtë. Tetë vjet larg vatrës, tetë vjet!

Natyrisht ky ishte një gëzim, që ai u kthye në vatrën e tij, që ndjeu erën e këndshme të mureve të shtëpisë dhe afshin e druve të lisit që digjeshin, që kërcisnin, që lëshonin tymin e ëmbël.

Mbrëmjeve rrinte pranë zjarrit duke mbushur dhe zbrazur çibukun, duke menduar e kujtuar diçka të largët. Fliste pak dhe nuk e shikonte në sy të birin.

Ai ishte përbrenda një zemërim dhe ky zemërim zjente i egër, i furishëm dhe priste gjithnjë rastin që të shpërthente, s'ka gjë se ky shkak mund të ishte i vockël. Ndonjëherë, një shkëndijë mospërfillëse bie në një qipi bari të thatë dhe ndez një zjarr të madh, të cilin, edhe sikur të mblidhet gjithë fshati,, nuk mund ta shuaje.

— Flokët e qethura po të rriten, baba! — i tha një mbrëmje i biri, duke ndenjtur me të pranë vatrës. Babai nuk foli, po vrejti vetullat. Dhe kur gruaja qeshi, ai thirri:



— Me mua shaka mos bëni! Ti mos zbardh dhëmbët! — i tha ai të shoqes pa shikuar nga i biri.

Nisi një shi. Një pikë filloi të pikojë në mes të truallit. Babai qëndroi pranë dritares, duke shikuar shiun që binte e duke ndjerë trokitjen e pikës mbi pjatën që grua-ja kishte vënë për të mos u lagur trualli. Burri u kthye nga i biri, po pa e shikuar në sy.

— Të djelën do ta nxjerr në pazar kalin. Duhet shitur, të ndreqim shtëpinë — tha ai.

— Së shpejti ndahen të ardhurat e kooperativës, — tha djali, — lekë do kemi, pse ta shesim kalin?

— Ah, prit gomar të mbijë bar! Të djelën unë do të shes kalin — përsëriti babai me një ton të prerë.

— Kalin ia kam premtuar kooperativës — tha djali.

Burri u kthye përnjëherësh nga i biri.

— Të thashë se kalin do ta shes të djelën. Mbaroi. Pa fjalë — tha ai.

— Kali është imi — tha djali.

— Yti? — pyeti babai, dhe duart nisen t'i dridheshin.

— Po i kujt? — pyeti djali.

— Kush është kryetar familje, unë apo ti? — shtërngoi dhëmbët e prishur babai.

— Aq më bën mua kush është. Puna qëndron këtu: kalin, të lutem shumë, lere rehat — tha djali.

Në dhomë dëgjohej vetëm pika që binte në pjatë. At e bir u shikuan sy ndër sy dhe heshtën për një çast, bile ata prenë edhe frymëmarrjen në ato sekonda.

— Maskarà! — thirri babai duke u dridhur i tëri. Kjo thirrje ishte një thirrje hysterike prej një njeriu me karakter. Djali nuk iu përgjigj.

— Maskara! — thirri babai përsëri dhe e shtypi kurtinë e duhanit me dorën e fortë.

Djali prapë nuk u përgjigj.

— Maskara! — thirri babai për të tretën herë. — Unë të kam bërë kokën, ti kërkon të më vërtitesh si të dojë qejfi. Tetë vjet ndenja në burg për hatrin tënd! Ti më bërë të mos kem guxim t'i shoh njerëzit në sy...

— Në burg s'të futa unë, po koka jote — tha djali, duke i hedhur një vështrim nënës, që ishte ngritur dhe shikonte e frikësuar. Ky shikim kërkonte mbështetje në sytë e nënës.

— Maskara! — thirri edhe një herë burri i gjatë.



— Mjaft, se ngrite më këmbë mëhallën — i tha i biri dhe u mat të dalë. Po i ati e zuri për jake me duart e trasha dhe e shkundi. Djali u mundua të shpëtojë nga këta krahë të fuqishëm. Jaka e xhakëtës mbeti në duart e babait. Nëna u hodh t'i ndajë duke u lutur. Burri shtriu krahun dhe rrëmbeu një hu të gjatë, që ishte në qoshe të dhomës. E ngriti lart dhe me sa fuqi që pati, ia lëshoi mbi kokë të birit, po djali lëvizti pak dhe huri e zu në krahun e djathtë. U dëgjua një krismë e rëndë, sikur diçka u thye. Djali u shtri pa ndjenja në truall.

Dëgjohej vetëm pika që binte në pjatë...

...Një javë të tërë, i shtrirë në dyshek, ai nuk foli. Pas një jave, filloi të lëshojë ca tinguj pa kuptim. Njërin krah dhe njëren këmbë nuk e lëvizte fare. Po t'i jepje hante, po ta lije rrinte pa ngrënë. Ushqimin ia jepte me lugë e ëma.

— Mu-mu-mu — i përgjigjej ai.

Një mjek që erdhi, e pa, tha se djali kish mbetur për jetë idiot. Nuk kaloi edhe shumë kohë, kur fytyra e tij e këndëshme filloi të marrë një pamje tjetër.

### 3

Babai iku nga fshati dhe punoi në një pyll muaj të tëra. Në atë pyll piu dhjetra kilogram duhan, pastaj shkoi si gurthyes në një gurore të largët, që përgatiste gurë për çakëllet e rrugëve. Po më në fund, ai erdhi në shtëpi akoma më i rrudhur, akoma më i vrejtur, akoma më i heshtur. Ai thithte çibukun në vatër. Idiote tërë jargë rrinte në qoshe të odës dhe bënte «mu-mu-mu».

— Të meremetojmë dhomën tjetër. Nuk mund të rri dot bashkë me këtë — i tha burri së shoqes. — Nuk mund!

— Mu-mu-mu, bëri idioti

Era trokiste në xhamet. Llampa digjej në oxhak. Idiotein e zuri gjumi në qoshe të dhomës. Ai ishte shtrirë në kurriz, kishte hapur gojën dhe nga të dy cepat e buzëve dilnin jargë. Burri pinte duhan. Rrathët mavi të syve të nënës ishin bërë më të mëdhenj.

Burrë e grua shuan dritën dhe ranë të flenë. I biri murmuriste në gjumë:



— Mu-mu-mu!

Babai mbylli veshët me duar.

— Nuk mund ta dëgjoj! — thirri ai.

— Mu-mu-mu! — iu përgjigj i biri.

Dhe ai atëhere u hodh nga dysheku, u vesh dhe ndenji gjer në mëngjes pranë vatrës. Do dëshironte të shkonte tek ndonjë shok, të kuvendonte, të pinte një duhan bashkë, po në fshat të gjithë ia kishin kthyer shpinën. Bile kur dilte në rrugë, gratë e shikonin nga dritaret dhe pëshpërisnin:

— Ja, ai!

E ai e dinte se njerëzit nuk e përfillnin, nuk e donin. Atë e mundonte heshtja e tyre kur i takonte rastësisht në rrugë. Kjo ishte një heshtje egër, e dëshpëruar, e hidhur. Ata heshtnin kur e shihnin, po ndërmjet tyre e shanin dhe e quanin të poshtër. Ç'është e vërteta, kishte edhe të tjerë që ia kishin thënë në sy, haptazi, se e urrenin dhe nuk donin ta shikonin në fshat.

Një ditë u zhduk. Banorët e atij fshati nuk e panë më të dilte rrugicave. E pati parë vetëm rojtari i pyllit, që e kishte gjetur të varur në një degë ahu të lashtë me rrypin e pantallonave të veta. Kishte varur veten. Kështu pat mbaruar kjo histori, kjo histori e Ganiut dhe e të jatit të tij.

Ne i ramë kuajve dhe u fshehëm në pyllin e dendur.



# Njeriu i kohës

## 1

— Do t'i dërmoj! — kishte thënë Festim Çuçua në një rreth me njerëz të zgjedhur, ku ndodheshin dy shkrimtarët e famshëm Sherif Abeceja dhe Ymer Hasan Kadrihy-seni, ku merrnin pjesë gjithashtu edhe gazetari Qani Balli dhe funksionari Abdulla Gështenja. Ky i fundit ishte gjendur fare rastësisht, megjithse shoqërohej me Festim Çuçon dhe rrethin e tij.

Kur u thanë këto fjalë, aty për aty nuk morën ndonjë rëndësi, se ishin tepër të përgjithshme dhe nuk dihej se kujt i drejtoheshin. Domethënia e tyre doli shumë vonë. Por le të vijmë te vetë Festim Çuçua.

Ai nuk ishte ndonjë njeri kushedi se sa i shquar në fushën e shkencave ekonomike, por edhe pa gjë në kokë nuk mund ta quajë. Lexonte libra, e njihte mirë kontabilitetin, e dinte veprimin e ligjeve ekonomike dhe mund të shpiegonte shumë nocione të tjera të kësaj natyre. Kish-te mësuar edhe një gjuhë të huaj që i jepte dy mundësi, e para të shfrytëzonte një literaturë më të begatë dhe, e dyta të hynte më lehtë në rrethet letrare dhe kulturore të njerëzve të zgjedhur të kryeqytetit, që pinin kafe në hotelin pesëmbëdhjetë katësh, duke u mbledhur katër e nga katër sipas shijeve estetike dhe sipas harmonizimit të ndjenjave miqësore me njëri-tjetrin. Me atë kulturë që zotëro-



nte, ai nuk e kishte të vështirë edhe të shkruante artikuj dhe reportazhe nëpër gazeta dhe bile edhe tregime dhe gjini më të gjata. Por këto shkrime, veçanërisht tregimet, nuk kishin tërhequr vëmendjen e njerëzve, pasi ishin të stisura dhe të ndërtuara logjikisht në sajë të kulturës së tij dhe të leximeve. Megjithatë, ai e rëndiste veten në radhën e atyre djemve me koncepte të gjera bahkëkohore dhe evropiane për jetën, ekonominë, kulturën dhe letërsinë. Si admirues i madh i Heminguejt, rrinte pranë shkrimtarëve më të shquar dhe gazetarëve të papajtuësëm me çdo lloj prapambetjeje dhe mediokriteti, pranë atyre njerëzve që synojnë vetëm drejt përparimit. Mes këtyre njerëzve kishte përvetësuar edhe disa terma si «struktura e romanit», «elementët kontemporanë», «stofi poetik» e të tjera, si dhe kishte përpunuar një stil sjelljeje me nihilizëm, me pak ftohtësi, me pak snobizëm dhe me pak ironi në buzët e tij që i lëvizte me elegancë dhe bënte herë pas here me përçmim: «pëh!», duke tundur dorën në erë. Këto veti, sipas tij, janë të domosdoshme për njeriun kontemporan. Doemos këto është mirë që të harmonizojnë edhe me pamjen e jashtme. Por edhe këtë ai e kishte.

Ishte i gjatë, me gjoks të gjerë dhe me fytyrë të lëmuar, me një ngjyrë të trëndafiltë të hapur. Ngjyrën e fytyrës së tij do ta dëshironte të zbehtë, ngjyrë prej intelektual, por kësaj nuk kishte se ç't'i bënte, se nuk e kishte në dorën e vet. I gjatë, i këndshëm dhe me zë të butë muzikor, ulej në grupet që thamë dhe pinte kafe me elegancë. Edhe në ngritjen e filxhanit dhe në afrimin e tij në buzën e poshtme ndjehej kultura dhe shija bashkëkohore.

Tek e ngrinte filxhanin e kafes ekspres, një paradite, aty nga ora njëmbëdhjetë, ai vuri re që po afrohej drejt tij përmes hollit të hotelit shumëkatësh gazetari Qani Dalli, me një fytyrë pak të zhubrosur dhe me pikla sikur ta kishin bërë palarë mizat. Gazetari e zuri për dore dhe u ul, duke marrë shpejt e shpejt edhe një cigare nga kutija që ishte në tryezën e gjatë katërkëndëshe me këmbë të shkurtra, barazi me kolltukët.

— Nesër në gazetë lëshojmë një bombë! Bombën të takon ty ta përgatisësh! — tha Qani Balli dhe u hodh përjetë në kolltuk.

— Për ç'problem? — pyeti Festim Çuçua dhe ngri-



ti kokën me flokë të drejtë, kokën vezake dhe të lëmuar nga të gjitha anët.

— Bombë, Festim Çuçua, bombë! Nesër gazetat botojnë një lajm për një nismë të madhe! Shkojnë në zonat e Veriut dhjetra quadro të dikastereve, dhjetra shkrimtarë dhe artistë. Tundet Kukësi, Tropoja, Puka, Burreli, Mirdita! Reportazhin e parë për këta njerëz që nisen në Veri ke fatin ta bësh ti, Festim Çuçua! Mbetesh në histori. Bombë e vërtetë. Do të dridhen disa mikroborgjezë që s'kanë dalë vullnetarë... — tha Qani Balli dhe fërkoj duart duke u hedhur në kolltuk.

Festim Çuçua e dinte këtë nismë. Në dikasterin ku punonte i kishin thënë edhe atij nëse kishte dëshira për të shkuar në Veri, por ai nuk kishte pranuar. Sipas fjalëve të tij të shoqen e kishte të sëmurë me nerva, kishte dy fëmijë të vegjël, njeri tjetër në shtëpi nuk kishte. Nuk mund ta linte shtëpinë në këtë gjendje të vështirë dhe të jetonte larg saj në Tropojë apo Kukës, qoftë edhe në Burrel, që ishte qyteti më i afërt. Në dikaster kishte shkuar edhe vetë e shoqja dhe kishte qarë para titullarit. Por e kishin qetësuar duke i thënë se në Veri shkojnë ata që kanë dëshirë dhe që nuk kanë vështirësi familjare. Veç kësaj Festim Çuçon e kemi kuadër, që nuk zëvendësohet lehtë dhe na vjen keq edhe neve ta dërgojmë. Me që edhe ai vetë nuk ka dëshirë të shkojë, na lehtëson edhe ne. Kështu i kishin thënë. Madje një njeri shumë i afërt i Festim Çuços, me një autoritet të madh dhe që i shkante fjala, kur e pa të prekur dhe të shqetësuar nga që refuzoi të nisej në Veri, e qetësoi duke i premtuar një udhëtim me vlerë.

— Do të shkojmë bashkë! — i kishte thënë njeriu me autoritet.

Por kërkesa e gazetarit Qani Balli e vuri në mendime Festim Çuçon. A duhej ta shkruante reportazhin me këtë temë? Ç'mund të thoshin ata që e dinin refuzimin e tij. Megjithatë do ta shkruante! Bombën do ta lëshoj! mendoj ai.

— Nesër duhet të publikohet patjetër shkrimi? — pyeti Festim Çuçua pas heshtjes së gjatë para gazetarit Qani Balli, duke përdorur fjalën «publikim» në vend të «botim».

— Medoemos! Prandaj sa të pi edhe unë kafen, ngreu



dhe nisu; tako ndonjë nga ata që do të shkojnë, gjej ndonjë shprehje pikante dhe në mbrëmje sille shkrimin në redaksi. Ama të jetë bombë e vërtetë! — tha Qani Balli dhe kafshoi filtrën e cigarit.

## 2

Reportazhi u botua të nesërmen, ashtu siç i kishte thënë Qani Balli. Ishte një reportazh i zakonshëm, i shkruar shpejt e shpejt, me premtime për të punuar mirë e të tjera. «Kwadrot tanë, të formuar me koncepte të shëndosha për jetën, e kanë bërë mënyrë jetese afrimin me popullin, qëndrimin e tyre pranë popullit dhe vetëm popullit. Ata nuk e quajnë sakrificë të jenë mes popullit. Për ta Shqipëria është e njëlojtë si në Tiranë, ashtu edhe në Kukës e Tropojë. Hallet dhe shqetësimet e vockla familjare janë të papërfillshme para problemeve kontemporane të socializmit dhe të civilizimit të ri socialist». Me këtë frazë e mbyllte reportazhin Festim Çuçua. Dhe kur e mori gazetën në mëngjes këtë mbyllje e lexoi pesë herë për ta shijuar dhe për ta ndjerë më shumë. Veçanërisht i pëlqente shprehja «civilizimi i ri socialist». E kishte dëgjuar këtë shprehje atje në hollin e hotelit shumëkatësh nga goja e dy shkrimtarëve më të shquar të vendit, tek pinte kafe bashkë me ta. Që atëhere e kishte mbajtur mend dhe kur i erdhi rasti e përdori me vend në reportazh.

Pas botimit të shkrimit, që siç i thoshte ai «publikimit», në orën njëmbëdhjetë të paraditës, si zakonisht shkoi në hollin e hotelit shumëkatësh. Atje gjeti të dy shkrimtarët e famshëm dhe gazetarin Qani Ballin tek flisnin për gazetën «Drita», që nuk para i kënaqte me shkrimet e saj. Sa e panë Festim Çuçon, i bënë me kokë të ulej, duke mos e ndërprerë bisedën.

— «Drita» pak i pasqyron proceset e ndërlikuara letrare! Nivel, nivel duhet! — tha gazetari Qani Balli.

— Pëh! — bëri Festim Çuçua dhe vështroi të dy shkrimtarët e famshëm, sidomos njërin, Sherif Abecenë, që rrinte i vrenjtur me sy në vrimën e gjerë me fund të zi të filxhanit.



Sherif Abeceja nuk fliste. Vetëm dëgjonte. Ai nuk donte të merrte nëpër gojë «Dritën», se fjala e tij autoritare përhapej në gjithë kryeqytetin, kalonte gojë më gojë mes gazetarëve përtej gjer tek studentët e universitetit, hynte në qarqet e shkrimtarëve e artistëve dhe ngjitej e zmadhuar deri në redaksinë e «Dritës». Gjoja, ja, si paska thënë shkrimtari i famshëm Sherif Abeceja! Për këtë arsye ai nuk fliste. Ndërsa shkrimtari tjetër Ymer Hasan Kadrihyseni, me një tufë flokësh të rënë mbi gjysmën e ballit plot brazda mendimi, autori i të famshmes dramë «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan» dhe konsumatori më i madh i duhanit në hollin e shumëkatëshit, nuk i kursente fjalët:

— «Dritën» e merr era. Është një gazetë e lehtë si pëndë!

Këtu u hodh gazetari me fytyrë pikla-pikla si të spërkatur nga mizat. Mes piklave prej mize atij i vetëtinë sytë e veckël si kopsat e jelekut të shkrimtarit Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Duhej të quhej «Pënda», jo «Drita»! — tha ai.

Dhe këtu të gjithë qeshën. Qeshi edhe më i famshmi Sherif Abeceja. Por përnjëherësh u përmbajt dhe e ndërpreu të qeshurën. Ah, ç'bëra që qesha, mendoi ai. E qeshura ime do të merret vesh. Do të përhapet në kryeqytet dhe do të thonë: «Qeshi Sherif Abeceja me «Dritën». Edhe ky pikaloshi i dreqit, ç'na bën të qeshim? Është shumë e vështirë të jesh i madh! — mendoi ai. — Të qeshësh, të thonë: — qeshi Sherifi! — të vrënjtësh, të thonë: — u vrënjt Sherifi! Ky pikaloshi dhe ky tjetri, ky Festim Çuçua, që na nënvizon në gazetë disa fjalë që i kemi thënë ne në bisedë e sipër «civilizimi socialist», e kanë mirë, se rrijnë nën hijen tonë. Fjalët e tyre i merr era. Por fjalët tona, ehu!... mendoi Sherif Abeceja dhe u inatos me konsumatorin më të madh të duhanit Ymer Hasan Kadrihysenin. U inatos edhe me mbiemrin e tij të gjatë. Pastaj u qetësua me vetëveten se ky mbiemër tregon lidhjen e ngushtë me frymën popullore, me folklorin dhe legendat që kohët e fundit e kishin joshur së tepërmi dhe kishte shkruar studimin me rëndësi ballkanike, që gazetari Qani Balli e kishte quajtur ndërkontinentale «Ago Ymeri dhe Luftrat në Ballkan», ku kishte gjetur disa fije që lidhnin malësinë e Veriut me Trojën e lashtë. Pran-



daj gazetari Qani Balli e kishte ngritur zërin e tij në një konferencë shkencore, se studimi i Sherif Abecesë duhet të popullarizohet dhe t'i bëhet një propagandë më e madhe, pasi publicistët borgjezë po e sulmojnë shumë. Unë, kishte thënë Qani Balli jam gati të bëj një artikull në revistën «Le letrë albanezë», që del në gjuhë të huaja, për t'ua rekomenduar popujve studimin me vlera kolosale të Sherif Abecesë. Këtu ishte hedhur kontemporani Festim Çuçua, që, megjithëse merrej me studime ekonomike dhe gazetari, ndiqte hap pas hapi jetën e shkrimtarit të famshëm Sherif Abeceja për të shkruar biografinë e tij:

— Përpara se t'i bëhet popujve i njohur përmes «Lë letrë albanezë», studimi «Ago Ymeri dhe Luftrat në Ballkan», duhet shkruar një reportazh për procesin krijues të Sherif Abecesë. Dhe jam gati ta shkruaj këtë reportazh!

Dhe ata përsëri u hodhën në gazetën «Drita», në nivelin e shkrimeve të saj dhe në mjaft dobësi të tjera.

— Në fakt — tha Ymer Hasan Kadrihyseni — «Drita» ndodhet në vështirësi. Vetë ne duhet ta ndihmojmë. Reportazhi i Festim Çuços po të ishte botuar atje dhe jo në gazetën N., do t'ia ngrinte vlerat...

— Më mirë që s'u botua atje! E kush do ta lexonte? Gazeta, ku punoj unë, e ka tirazhin pesë fish më të madh se «Drita». Kjo s'ka rëndësi! Unë do të bëj një artikull që do ta dërrmoj «Dritën». E kam menduar. E dërmova! Iku!

Shkrimtari Ymer Hasan Kadrihyseni me tufën e flokëve të rëna mbi ballë vuri pakëz buzën në gaz, e vështrroi Sherif Abecenë, që e ndiqte me vëmendje gazetarin Qani Balli, dhe sikur të merrte miratimin e tij, tha:

— Ti, Qano, do ta bësh artikullin kundër «Dritës», por duhet të kesh parasysh kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Ai, sidoqoftë, do të tharohet pakëz. Apo jo, i dashur Sherif? — dhe u kthye i tëri nga Sherif Abeceja, u kthye me gjithë tymin e cigares.

Sherif Abeceja për pak sa do të fliste, e mbylli gojën.

— Kryetari i Lidhjes vetë e ka kritikuar «Dritën» në plenumet e shkrimtarëve dhe artistëve! — ndërhyri gazetari Qani Balli, duke kërcyer në kolltuk.

— Hëm! Kur ia kritikojnë të tjerët, tharohet!.. — prishi buzët Ymer Hasan Kadrihyseni për të treguar shijen e thartirës, dhe iu kthye Sherif Abecesë: — Apo jo?

— Mua mos më ngatërroni në këtë diskutim! — tha



Sherif Abeceja me buzë të prishura nga përfytyrimi i thartirës të kujtuar nga Ymer Hasan Kadrihyseni, dhe mendoi: Po ky trashaman ç'na i kujtoi thartirën? Ah, ç'më pihet një lëng me limontos!

— Të mos e ndërlikojmë Abecenë! Fjala e tij duhet ruajtur. Fjala e tij kalon caqet kombëtare! Fjala e tij... — tha Festim Çuçua për të mos e lënë të flasë Sherif Abecenë.

Sherif Abeceja shtrëngoi buzët dhe i bëri si një ko-kërr fiku e ndarë përgjysmë:

— Edhe ti, Festim Çuçua, ç'i shkruan ato fraza «civilizimi socialist»? Nuk hyjnë ato në një reportazh të thjeshtë. Ato hyjnë në artikuj fundamentalë që prekin probleme kardinale, probleme kyçe të historisë dhe të ekzistencës së një kombi. Këto fraza «civilizimi socialist» hyjnë në një artikull, ku ballafaqohen dy civilizime, në një ese, ku interpreton, fjala vjen, eposin dhe civilizimin. Kurse ti më shkruan: Zeqo Kadëmlari u nis për në Tropojë dhe kjo tregon civilizimin socialist! — tha Sherif Abeceja, duke dalë nga kështjella shpirtërore e durimit.

Dhe me t'i thënë këto fjalë përsëri u pendua dhe u mbyll në vetvete. Pse e shpreha këtë gjykim, këtë ese? Këta kokëtula, si pikaloshi Qani Balli dhe idioti Festim Çuçua me kokë vezake, ose do ta pëshpëritin diku, ose do ta shënojnë në ndonjë nga ata artikujt e tyre mediokër! Unë s'duhet të flas. Mua m'i marrin gjërat dhe m'i transformojnë!

Festim Çuçua u dëshpërua me vërejtjen që i bëri shkrimtari Sherif Abeceja për frazën ku përmendej «civilizimi socialist». Ai dëshironte t'i jepte një përgjigje në formën e pendimit, i hapi pakëz buzkat, u hipnotizua nga vështrimi i Sherif Abecesë dhe shtangu. Dhe këtu ndërhyri me vend autori i të famshmes dramë «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan», shkrimtari Ymer Hasan Kadrihyseni. Ai tha këto fjalë:

— Festim Çuçua ka bërë mirë që ka përdorur në reportazhin e tij shprehjen «civilizimi socialist». Struktura kontemporane e gjinive letrare dhe publicistike ka pësuar një evolucion. Kjo strukturë ka grumbulluar nënstruktura të tjera, i ka përzierë këto nënstruktura, i ka hedhur lart dhe poshtë, ka krijuar mbistruktura dhe i ka zbritur përsëri. Ç'dua të them me këtë? Dua të them se struktura



rën e romanit e ka marrë dhe e ka zbritur në strukturën e reportazhit dhe strukturën e reportazhit e ka ngjitur te struktura e romanit. Domethënë kemi strukturë plus mbistrukturë dhe anasjelltas mbistrukturë dhe minus strukturë. Me që përzihen strukturat mund të përzjehen edhe idetë. Rrjedhimisht ideja e Festim Çuços «civilizimi socialist» mund të futet edhe në një reportazh që bën fjalë për Zeqo Kadëmlarin, vullnetar në Tropojë, edhe në një roman me një personazh epik, ta zemë Homer Ora. Prandaj, me gjithë nderimin e madh që kemi për ty, Sherif Abeceja, rezervojmë edhe të drejtën të bëjmë një kundërshtim modest!

Ky ishte arsyeimi më i madh që ishte dëgjuar ndonjëherë në hollin e hotelit shumëkatësh të kryeqytetit. Shkrimtari me famë ballkanike përpara mikut të tij po me famë botërore heshti. Por heshtja kishte domethënie. Ai mendonte: më mirë të përhapet fjala në kryeqytet që Sherif Abeceja heshti. Kjo fjalë le të shkojë gjer në Universitetet dhe le të hyjë atje ku duhet të hyjë: heshti.

Ndërsa të dy shkrimtarët e mëdhenj heshtnin, Festim Çuçua mendonte për kulturën e tyre universale dhe thoshte me vete se ato pakëz rrjeshta që janë shënuar në «Fjalorin Enciklopedik» të vendit për këta personalitete nuk janë hiç gjë. Ata meritojnë faqe të tëra në eciklopedi dhe jo pesë rrjeshta.

Ndërkohë në holl të hotelit u rrit figura e njeriut të gjatë me rrobe të zeza. Ishte ai njeriu me autoritet të madh, ai i afërti i Festim Çuços.

— Shoku Abdullah Gështenja! — pëshpëriti Festim Çuçua dhe një drithmë e lehtë i kaloi nëpër trup. — Me siguri që e ka lexuar shkrimin tim! — tha ai me vete.

Të dy shkrimtarët e mëdhenj e ndoqën me sy njeriun me autoritet dhe thanë ngadalë:

— Shoku Abdullah Gështenja!

Abdullah Gështenja i përshëndeti nga larg dhe ata lëvizën nga vendi në shenjë respekti. Njeriu me të zeza i bëri me gisht Festim Çuços, duke e ftuar. Në gjoksin e Festimit u ndje përsëri ajo drithmë e lehtë. U ngrit dhe shkoj pranë tij. Abdullah Gështenja e zuri për dorë dhe pastaj i ra në shpatulla.

— Bukur! Reportazh me vlera!

— Shkrim i shpejtë! — tha ai.



Abdullah Gështenja ia vuri dorën nën krah.

— I shpejtë, por i bukur! I sjell dobi edhe asaj çështjes që kemi biseduar. Së shpejti ajo punë mbaron! Bukur, bukur! — tha Abdullah Gështenja dhe u nda me Festim Çuçon, që i rrihte zemra.

Të tre njerëzit e letrave e prisnin Festim Çuçon me plot kuriozitet. Bile këtë kuriozitet nuk e fshihte as Sherif Abeceja, që zakonisht shquhej nga gjakftohtësia.

— Ç'të tha shoku Abdullah? — pyeti Qani Balli.

— E kishte pëlqyer! — u skuq Festim Çuça dhe u zemërua me veten për këtë skuqje.

— Thashë unë që është shkrim i mirë! — pohoi Ymer Hasan Kadrihyseni, ndërsa Sherif Abeceja u vrenjt.

Në këto çaste në hollin e hotelit erdhi nëpunësi i shërbimit dhe tha se gazetarin Qani Balli e kërkonin në telefon.

Qani Balli me kokën lart, duke lëvizur krahët me shpejtësi, duke kthyer sytë paralelisht në gjithë hapësirën e hollit, duke ngritur flokët e imët me dorë, duke tundur të dy cepat e xhakëtës bojë hiri, zbriti me vrap në sportel ku ishte telefoni. Ai qëndroi gjatë në telefon dhe u kthye me vonesë në tryezën e nderuar. Sa u kthye tha, duke përsëritur mendimin e tij të mëparshëm:

— Ata të «Dritës» unë do t'i dërmoj! Do të shkruaj një artikull kundër tyre!

Dhe këtu papritur u ngrit shkrimtari Sherif Abeceja dhe tha se po i sillnin një dëm të madh në opinionin publik. Fjala mbi qëndrimin e tij ndaj këtyre bisedave për gazetën «Drita» do të përhapej në gjithë Republikën.

— Ç'ke që ngrihesh? Ti s'ke thënë asnjë fjalë ndaj kësaj gazete! Ti ke heshtur... — tha autori i dramës «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan».

— Qysh? Pikërisht se kam heshtur do të merret vesh në gjithë vendin! Pse heshti? Pse s'reagoi? — tha ai, duke qëndruar në këmbë.

Ata e ulën me zor. Dhe ai u bind, duke menduar: nesër do të thonë se atë e ulën me detyrim...

— E, ç'të thanë në telefon? — pyeti shkrimtari Ymer Hasan Kadrihyseni gazetarin Qani Balli, si u ul i famshmi Sherif Abeceja, u përgjigj:

— Ah, ç'e pyet! Ja për këtë më tërhoqi vërejtjen kry-



eredaktori! — tha Qani Balli, duke treguar me gisht Festim Çuçon.

— E pse? — pyeti shkrimtari Ymer Hasan Kadrihseni.

— Qysh, pse! Festim Çuçua ka kundërshtuar të dalë vullnetar në rrethet e Veriut dhe na shkruan për gatishmërinë patriotike të të tjerëve!.. — tha Qani Balli.

Të tre vështrimet u kryqëzuan dhe u përqëndruan vetëm në një pikë: në nishanin e zi sa një kokërr meli të fytyrës vezake të Festim Çuços.

— Vërtet? — pyeti shkrimtari Ymer Hasan Kadrihseni.

— Gruaja ime vuan nga nervat! Pëh! Ku ta le? — tha Festim Çuçua.

— Pak vuante gruaja e Tolstoit nga nervat? E megjithatë Tolstoi rrinte në Jasnaja Poljana! — tha Ymer Hasan Kadrihseni dhe me një thithje plot domethënie të cigares ia hodhi vështrimin Sherif Abeceja.

— Dale, dale! — tha Sherif Abeceja, por nuk foli.

— Pse s'thoni ju gruaja e Heminguejt! I madhi Heminguej shtegtonte mes pllajave me tigra të Afrikës, ndërsa e shoqja rrinte e mbyllur tërë nerva në një shtëpi diku në Amerikë! — i ndriti sytë gazetari Qani Balli, që në shkrimet e tij përpiquej ta imitonte Heminguenë.

— Dale, dale! — tha Sherif Abeceja dhe përsëri nuk u shpreh.

— Mengadalë! — ndërhyri Ymer Hasan Kadrihseni duke e përmbajtur të qeshurën, ndërsa Sherif Abeceja e vështrroi me zemërim:

— Ymer! — bëri ai me rreptësi.

— Hiç! — tha Ymer Hasan Kadrihseni.

— Dale, dale! — tha Sherif Abeceja — Heminguej paguante për të shkuar në Afrikë. Paguante dollarë për të njohur jetën...

— E, ç'ë? — pyeti Ymer Hasan Kadrihseni.

Sherif Abeceja mblodhi supet. Kaq gjë s'kupton ky trashaman? mendoj ai.

— Si e, ç'ë? Ernest Heminguej paguante dollarë nga xhepi për të shkuar në Afrikë, kurse Festim Çuços i paguajnë dieta, i japin edhe rroga për të shkuar në Tropojë dhe nuk shkon... — tha Sherif Abeceja duke i theksuar rrokjet e çdo fjale.



— E, ç'ë? — përsëriti Ymer Hasan Kadrihyseni.

Këtu nuk u përmbajt gjigandi i letërsisë Sherif Abeceja! Po e mërziste së tepërmi ky folklorist i patalentuar, ky buall letrar i mbetur në kënetat e frazeologjisë, Ymer Hasan Kadrihyseni, ky skelet i dinozaurit të islamizmit.

— Ç'janë këto e-ç'ë-ra», more! Heminguej nuk mernte dieta për njohjen e jetës, kurse Festim Çuços i japin dieta për ta njohur jetën! — tha dhe vështroi buzët e Ymerit: — Mos do të bësh ndonjë «ç'ë» tjetër, zotrote?

Kolegët qeshën.

— Nuk të kuptoj, Sherif! Atëhere Festim Çuça sipas logjikës e ka më të lehtë se Heminguej për ta njohur jetën, se paguhet! — tha Ymer Hasan Kadrihyseni.

Sherif Abeceja mbështeti bërrylat në gjunjë dhe tundi kokën mes dy krahëve të ngritur paralelisht:

— Nuk e ka më lehtë se Heminguej! — tha ai.

— Absurd! — tha Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Ymer! Po sikur Festim Çuça të ishte në rangun e Heminguejt, si do ta njihte jetën?

— Edhe pa dieta! — u përgjegj Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Do të shkonte në Tropojë? Flas për Heminguenë tonë!

— Jo! — tha kategorikisht Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Jo! — tha çuditërisht Sherif Abeceja.

Gazetari Qani Balli dhe letrari Festim Çuça vështronin në heshtje këta dy mjeshtra të mëdhenj të fjalës dhe nuk po e kuptonin se ku do ta nxirrnin përfundimin.

— Pse nuk do të shkonte Festim Çuça në Tropojë, po të ishte në rangun e Heminguejt? — nuk iu durua të pyesë Qani Balli.

— Pse do të kërkonte një vend më të vështirë. Do të kërkonte Dukagjinin. Pse do të kishte talent. Do të shkonte se do të kishte talent! — tha hapur Sherif Abeceja.

— Pëh! — bëri padashka Festim Çuça, duke e quajtur me mendjen e tij këtë diskutim si një lojë fjalësh.

— Ç'është kjo pëh! — u nxeh Sherif Abeceja.

Festim Çuços iu muar goja:

— Lojë fjalësh! — tha ai ngadalë.

— Nuk është lojë fjalësh! — tha Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Po ç'është? — tha Qani Balli.



— Shprehje e lojës së talentit. Kemi një lojë talenti në qënien e Festim Çuços dhe e shprehim përmes lojës së fjalëve... — tha vrenjtur Sherif Abeceja.

Dhe gjeniu Sherif Abeceja qeshi me të madhe. Duke fshirë sytë me shami tha:

— Le ta marrë vesh i tërë vendi që unë qesha. E di se të gjithë do të thonë: «Sherif Abeceja qeshi»! Le të thonë. Po, po! le të thonë! Ky gomar më bëri për të qeshur! — tha Sherif Abeceja e zgjati gishtin drejt fytyrës vezake me ngjyrë trëndafili të hapur të Festim Çuços, që heshte i hutuar.

Hutimi i tij pastaj kaloi në dëshpërim. Kishte frikë që shkrimi i tij i botuar në gazetë të mos bëhej shkak për t'ia prishur atë të ardhmen që i kishte premtuar Abdullah Gështenja. Dhe mallkoi veten që i kishte premtuar këtij pikaloshit të prapë, që i ishte qepur pas dhe nuk i ndahej. Eh, ku më gjeti mua ky pikaloshi i dreqit! Si nuk ia caktoi shkrimin ndonjë tjetri?

Tek notonte nëpër mendime të shqetësuar, Sherif Abeceja dhe Ymer Hasan Kadrihyseni vazhdonin të qeshnin.

### 3

E qeshura e të madhit Sherif Abeceja në hollin e hotelit shumëkatësh bëri bujë në gjithë qarqet studentore dhe letrare e artistike të kryeqytetit. Madje kjo e qeshur filloi të arsyetohej edhe në shumë kuadro drejtuese të rangjeve të mesme dhe të larta. Ç'domethënie kishte kjo e qeshur?

A ishte kjo e qeshur një fshikullim për Festim Çuçon, apo një tallje me figurën e Heminguejt? Një palë thoshte se e qeshura e Sherif Abecesë ishte një dërmim i hapur për Çuçon, një palë tjetër pohonte se ishte një çshenjtërim i plotë i Heminguejt. Konsumatorët tradicionalë të kafes në hollin e shumëkatëshit ishin tepër të gëzuar që Çuçua u bë qesharak nga një autoritet me famë si Sherif Abeceja. Kurse konsumatorët modernë të kafes ishin mjaft të kënaqur që i guximshmi me zë ballkanik Sherif Abeceja



nuk pyeti as për gjeninë e prozës së re, Ernest Heminguejn!

Kur i vanë në vesh këto diskutime rreth të qeshurës së tij, Sherif Abeceja u dëshpërua dhe shau veten që nuk u mendua para se të qeshte:

— E dija që do të më shtrembëronin të qeshurën time. E qeshura ime nuk ka fyer as Çuçon, as Heminguejnë. Të dy unë i çmoj! — kishte thënë ai në një rreth të zgjedhur njerëzish.

Dhe ndërsa e qeshura e Sherif Abecesë diskutohej, ekonomistit dhe publicistit Festim Çuço i ishte ndaluar e drejta të botonte, që siç thoshte ai, të publikonte artikuj për nismat revolucionare të punonjësve. Artikuj dhe reportazhe për revolucionin tekniko-shkencor, që ai e quante RTSH, mund të publikonte. Mund të botonte edhe shkrime për mjediset e kulturuar të qyteteve, për letërsinë dhe artin, për blegtorinë e të tjera, por vetëm për nismat stop!

Dhe kur mblihdeshin në hollin e shumëkatëshit Qani Balli, Sherif Abeceja dhe Ymer Hasan Kadrihyseni për të pirë kafën ekspres, sa e shihnin trupin e gjatë me kokën vezake mbi qafën e Festim Çuços, thonin:

— Stop, domethënë për nismat!

— Stop, domethënë! — qeshte Festim Çuça.

Por një ditë të tre këta, Sherif Abeceja, Ymer Hasan Kadrihyseni dhe Qani Balli, kur e panë Festim Çuçon me të shoqen në hollin e shumëkatëshit, u habitën. Ai kurrrë nuk delte me gruan në këtë holl, pikërisht në këtë holl!

I gjatë dhe i pashëm, me një grua të shkurtër për krahu, por të këndshme, ua bëri me dorë të treve. Ç'pati? menduan ata me vështrime plot kuriozitet, duke ndjekur lëvizjet e tij. Dhe ndërsa ata e ndiqnin me sy, ai u ul në kolltuk me të shoqen e imët, me buzë të kuqe e me qerpikë të gjatë. Të dy ishin të gëzuar dhe luanin me copa letre të mbledhura në toptha të vegjël në tryezën e gjatë. Festim Çuça i binte me gisht topthit prej letre dhe e shoqja e priste me gishtin e hollë me thua me manikyr.

— Ç'bëhet, more ç'bëhet! — tha autori i dramës «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan».

— E ç'bëhet? Asgjë s'bëhet! — tha kolegu i tij i famshëm Sherif Abeceja.



— Si asgjë s'u bëka! A nuk e shikon si luan me të shoqen me toptha letre? — pyeti Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Luan se e ka të sëmurë me nerva. Ai prandaj nuk shkoi në Veri. Nuk shkoi që t'i bëjë psikoterapi së shoqes! — tha Sherif Abeceja dhe u drodh. «Ç'pata që i shpreha këto mendime! Do t'i marrë vesh gjithë kryeqyteti!» mendoi ai.

Kur dy kolegët e shquar këmbenin mendime për Festim Çuçon dhe të shoqen e tij, gazetarin Qani Balli nuk e zinte kolltukun. Ai lëvizte, ai hidhej, ai fërkohej aq sa sustat e kolltukut tingëllonin nën pjesën e prapsme të pantallonave të tij.

— Do të shkoj atje! — tha ai duke bërë me kokë nga Festim Çuçua.

— Shko! — tha Ymer Hasan Kadrihyseni.

— Shko, po mos i thuaj që u more vesh me ne, se përhapet fjala. Dhe këtë ta kesh parasysh! — urdhëroi Sherif Abeceja.

Gazetari Qani Balli e la kolltukun dhe mori vrapin nëpër holl. Gjithmonë ai të ecurën e kishte si vrapim. Hidhej dhe vetëm hidhej duke mbajtur kokën lart me fytyrën e zhubrosur dhe të piklosur, si nga spërkatjet e mizave. Dhe duke u hedhur iu afrua Festim Çuços, e zuri për dorre të shoqen e tij dhe u ul. Festim Çuçua ngriti lart gishtrinjte nga kamarierja për të porositur kafe. Gazetari Qani Balli, megjithse sa kishte pirë kafe, nuk e kundërshtoi mikun e tij.

Filluan të lëvizin duart, të bëjnë me shënja, të qeshin me zë të lartë dhe bile të nxjerrin disa tinguj si vërshëllima. Të dy shkrimtarët me nam ballkanik kishin mbetur vetëm dhe nuk e zbulonin dot fshehtësinë e gëzimit të Festim Çuços dhe së shoqes, gëzim që rrëmbeu edhe gazetarin Qani Balli Ata mes coprave të bisedës së Festim Çuços, së shoqes dhe Qani Ballit dëgjuan vetëm tri fjalë:

— Ua thyem hundët!

Sa dëgjuan këto fjalë, vështruan njeri-tjetrin.

Autori i dramës «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan» tha:

— Kujt ia thyen hundët ky mediokër?

I madhi Sherif Abeceja mblodhi supet:



— E pakuptueshme!

— Do të shkoj unë atje! — tha Ymer Hasan Kadrihyseni dhe me cigaren e përjetshme mes dy gishtrinjve u nis dalngadalë me njerën dorë në xhepin e pantallonave gri.

I përshëndeti, ia shtrëngoi dorën së shoqes së Festim Çuços dhe u ul.

Shkrimtari emërmadh Sherif Abeceja i vështronte fshehurazi, se druhej që të mos e vinin re të tjerët dhe të përhapnin fjalët: «Sherif Abeceja u bë kurioz ndaj Festim Çuços». Dhe me këtë drojtje ai ishte më fatkeqi. Jo vetëm që nuk mund të shkonte në shoqërinë e tyre, por edhe nuk mund të vështronte në atë tryezë. Po të shkonte atje, të nesërmen në mëngjes gjithë studentët e Universitetit, artistët e Teatrit të Operës dhe Baletit, kinestët e Kinostudios, shkrimtarët dhe gazetarët do të pëshpërisnin: «Sherif Abeceja shkoi në tryezën e Festim Çuços!»

Nga kjo gjë ai e nënshtroi veten të rrijë fillikat në kolltuk në anën tjetër të hollit. Ndërsa ata, në tryezën e Festim Çuços, qeshnin dhe luanin me toptha letre. Edhe autori i të papërsëritshmes dramë «Mrekullia e njeriut tonë kontemporan» hyri në këtë lojë. Ai e godiste me gisht topthin e letrës dhe e shoqja e Festim Çuços e priste me thoin e lyer me manikyr. Edhe ajo e godiste Ymer Hasan Kadrihysenin dhe ai qeshte me zë të trashë.

— «Edhe ky trashaman!» — shau Sherif Abeceja, kur dëgjoi të qeshurën e Ymer Hasan Kadrihysenit.

— Ua thyem hundët! — u dëgjua në gjithë hollin.

— E pakuptueshme! — tha me vete Sherif Abeceja fillikat i fillikatëve, duke i vështruar vjedhurazi.

Në këtë çast ai e ndjeu që po vinte kolegu i tij Ymer Hasan Kadrihyseni. Atëhere u lehtësua se e mposhti vetminë.

— Edhe ti, Ymer, me ata topthat!.. — e qortoi Sherif Abeceja kolegun e tij:

— Ha-ha-ha! — qeshi i papërmbajtur Ymer Hasan Kadrihyseni.

— E pakuptueshme! — pëshpëriti Sherif Abeceja.

— Ç'e pakuptueshme? Festim Çuçua shkon në Paris për specializim! Do të rrijë tre vjet, sa ata në Veri! — tha



Ymer Hasan Kadrihyseni dhe u shkul së qeshuri: — Ha-ha-ha!

Sherif Abeceja u hutua. I pahutuari Sherif Abeceja u hutua!

— Po ai të shoqen e ka me nerva! Si do ta lerë vetëm? pyeti ai me navitet, duke zbritur nga lartësitë e famës ballkanike në tabanin kombëtar.

— Ha-ha-ha! — qeshi Ymer Hasan Kadrihyseni, duke vënë përpara gojës dorën me gishtrinj me nikitinë.

— Ha-ha-ha! — thirri i famshmi Sherif Abeceja dhe në çast e ndërpreu «ha-ha-hanë». Ah, ç'do ta marrin vesh këtë të qeshur dhe do ta përhapin! S'kam dëshirë të thonë: «Sherif Abeceja qeshi në hollin e shumëkatëshit, kur dëgjoi se Festim Çuçua do të niset në zonat e Francës» mendoi ai me vete dhe padashka tha me zë të lartë:

— Shkon në zonat e Francës!

Atëhere Ymer Hasan Kadrihyseni e vështroi me habi, u përkul mbi tryezën e gjatë, ia afroi fytyrën pranë hundës dhe qeshi me zë të lartë:

— Në zonat e Francës; Ha-ha-ha!

— E pse qesh? Edhe në zonat e Francës njihet jeta!

Dhe këtu u tremb me të vërtetë Sherif Abeceja. Obo-bo, mendoi ai. — Këto fjalë me siguri që do të përhapen!

Nga tryeza e gjatë matanë, Festim Çuçua me të shoqen dhe me gazetarin Qani Balli ua bënë me duar...



# Nderi i heshtur

## 1

Shtëpia e Osman Mejdanit nga Reçi në një mëngjes të majit të 1942-së u rrethua keq nga italianët dhe xhandarët. Para se të rrethohej, në kopshtin me kumbulla dhe mollë, në breg të përroit, këndonin bilbilët dhe cicëronin zogjtë. Pastaj ata pushuan dhe ra një qetësi e thellë. Të tre ilegalët që e kishin kaluar natën në shtëpinë e Osman Mejdanit u ndodhën në një gjendje të vështirë që me pushkën e parë.

Ata iu lutën të zotit të shtëpisë të delnin, që të shpëtonte kulla nga zjarri dhe njerëzit e familjes nga fatkeqësia.

— Të dorëzohi? — tha Osman Mejdani.

Ilegalët nuk u përgjigjen menjëherë. Vetë fjala «dorëzim» përshkoi rupert e tyre si një drithmë e ftohtë, si një nepërkë e akullt që shket papritur mbi gjoksin lakuriq të një njeriu të dremitur në hijen e një peme në një ditë të nxehtë vere.

— Të dalim! Mund të vritemi, mund të shpëtojmë! — tha më i madhi në moshë, Hazir Shipshani.

— Punë që s'bëhet! — ia preu Osman Mejdani dhe urdhëroi të katër djemtë e tij të armatosur dhe çupën pesë, të zinin dritaret e kullës dhe të luftonin.

Ai e bëri këtë me një lehtësi të madhe, sikur të ishte



një gjë e përditshme dhe e zakonshme. Pastaj vetë u ngjit në baxhën e kullës me një kobure të vjetër në dorë.

Edhe të tre ilegalët zunë dritaret pranë djemve të Osman Mejdanit. Çupës i lanë një dritare më vete, që të ishte më e lirë dhe të mos druhej nga burrat.

Nga dritaret nuk dukeshin as italianët e as xhandarët. Ata ishin fshehur prapa avllisë dhe prapa gurëve të mëdhenj të mbuluar me ferra dhe hithra. Më vonë që andej do të zgjateshin tytat e pushkëve dhe do të ngriheshin dhe uleshin kapelat e ushtarëve dhe xhandarëve.

Ilegalët ishin të lodhur dhe të pagjumë. Ata kishin ardhur në shtëpinë e Osman Mejdanit pas mesit të natës. Një javë të tërë kishin qenë nëpër fshatra, ishin takuar me njerëz dhe kishin kuvenduar për luftën. Matanë përroit të Reçit, mes lisave të mëdhenj, kishin formuar edhe çetën e parë partizane të krahinës. Prandaj gjithë ajo lodhje dhe gjithë ato netë pagjumë tani kishin mbetur pas, të mbushura plot ngjarje dhe çaste të bukura dhe tërë jetë. Vërtet në fytyrat e tyre kishin mbetur gjurmët e lodhjes, por këto nuk ishin shenja dëshpërimi dhe mundimi. Ato tregonin më shumë burrëri dhe pjekuri. Vetëm kur u ndodhën para një të papriture, një rrethimi të egër në atë mëngjes maji me blerim dhe këngë zogjsh, i pushtoi një trishtim i hidhur. Të vritesh në këtë ditë maji, kur ke bërë gjithë atë rrugë dhe kur ke menduar se ke shpëtuar nga ndonjë plumb, është diçka e kobshme dhe e tmerrshme.

Pas pushkës së parë u dëgjuan zëra që i ftonin të tre ilegalët për t'u dorëzuar, përndryshe shtëpia do të digjej dhe njerëzit do të vriteshin. Osman Mejdani e njohu atë që thërriste. Ishte kapteri i xhandarëve Kalem Gashi, dikur mik shtëpie. Shumë herë me të atin e tij, Hasan Gashin, ai vinte tek Osman Mejdani dhe rrinte me ditë të tëra, duke ngrënë e duke pirë. Veçanërisht kur i zinte dimri dhe rrugët mbuloheshin me dëborë, at e bir rrinin gjatë, të ngrohur nga zjarri dhe miqësia e kësaj shtëpie. Tani e solli rasti që Kalem Gashi të vinte në këtë shtëpi jo me të atin e tij; por me italianët.

— Mirë se na vjen, o Kalem Gashi, i biri i Hasan Gashit! Na paske shumë njerëz me vete dhe s'di nëse do të gjej aqë jorganë për t'i mbuluar — i thirri nga baxha e çatisë Osman Mejdani.



Përgjigja e Kalem Gashit u vonua. Në këto çaste nuk pipëtinte asgjë dhe dukej sikur shtëpia ishte gdhirë e qetë si ditët e tjera. Megjithatë kjo qetësi ishte e nderë dhe e rëndë për njerëzit që rrinin prapa dritareve dhe për italianët dhe xhandarët e fshehur pas mureve dhe gurëve me ferra dhe hithra.

— Ne miq kemi qenë dhe miq mbetemi, or Osman Mejdani! Vetëm thuaji të dalin ata të tre që ke brenda! — thirri Kalem Gashi me një zë të trashë si nëpër hundë.

— Pse ç'janë ata të tre? Mos janë deshër për t'ua bërë kurban italianëve? Bukur folke, o Kalem Gashi, bukur! — u dëgjua zëri i Osman Mejdanit nga baxha.

Edhe se çastet ishin të vështira, të tre ilegalët vunë buzën në gaz. Më i madhi prej tyre, Hazir Shipshani, një djalë i gjatë me fytyrë të parruar dhe me sy të mëdhenj të kaltër, i tha ngadalë shokut të vet, që rrinte nën dritaren e afërt me nagant në dorë:

— Ah, Osmanit të shkretë nuk i shkojnë këto fjalë! E ku merr vesh koka e Kalem Gashit!

Dhe ai vështroi vajzën e Osman Mejdanit, që ishte mbështetur në pushkën e gjatë pranë dritares. Fytyra e saj e bardhë ishte e pikëlluar. Ajo diçka fliste me vete pa vënë re se mund ta dëgjonin.

— E njeh Kalemin? — pyeti Haziri

Vajza uli sytë:

— E kam parë kur vinte në shtëpi.

Po, po! Mira e kishte parë. Ai donte të martohej me Mirën. Edhe i ati i tij, Hasan Gashi, kishte qejf të bëhej krushk me Osman Mejdani, këtë burrë të zgjuar dhe mikpritës nga një fis i dëgjuar. Meqë edhe çupës i pëlqente djali, ishte bërë një fejesë e heshtur, ende e pahapur në fshat. Më vonë kjo mblesëri u ftoh dhe u harrua, se Kalemi, i biri i Hasan Gashit papritur u vesh xhandar. Osman Mejdani u zemërua dhe u prish me Gashët, pasi nuk i donte njerëzit që visheshin xhandarë. Atij iu duk sikur Gashët e kishin bërë kastile për ta tërbuar dhe turpëruar. Mos kanë kujtuar se vajza me që e dashka Kalem Gashin do të ikte nga shtëpia pa pyetur të atin? Apo mos kanë kujtuar se vajzës i pëlqejnë rrobet ngjyrë qielli dhe çizmet e ndritura?

— «Ë, ç'na thua, moj çupë e babait? — e kishte pyetur Osman Mejdani të bijën.



Ajo kishte ulur sytë dhe, e skuqur prush, kishte thënë se nuk donte të martohej me një xhandar. Vetëm teze Bajamja, një grua qejfleshë me vetulla të holla e qafë të gjatë, me një mes të hollë si të grerës, duke u tundur dhe duke përpjekur buzkat, kishte thënë:

— «Të isha pak më e re, nuk e lija pa marrë Kalem-in! Të keqen, o Kalem! Me çizme, me kapotë të gjatë, me strehë kapele që i vetëtin nga dielli!»

Osman Mejdani, me ta dëgjuar, u tërbua, e shau me fjalët më të rënda të kunatën, e quajti xhadi dhe e përzuri nga shtëpia. Dhe sa herë zihej me gruan, ia përmentte Bajamen, të motrën e saj, duke i thënë:

— «Soj i keq! E motra e xhadisë, që ma ka atë mesin si të grerës, që mezi ia mban vithet!»

Gruaja e shkretë çirte faqet dhe i lutej të mos thërriste se do ta dëgjonte mëhalla dhe do të bëheshin për turp të botës.

— «Mos do edhe ti si motra jote, që t'ia japim çupën një xhandari, një pisi me çizme?» — thërriste Osman Mejdani.

— «Aman! Ç'janë këto? S'e sheh? U dogja unë të bëhem vjehrrë e një xhandari!» — ia priste e shoqja.

Por Mira këtë xhandar ende e donte. Ishte i pari djalë që kishte hyrë në zemrën e vajzës, megjithse e dinte që kurrë nuk do të bëhej gruaja e tij. Edhe tani, kur dëgjonte zërin e Kalem Gashit, ndjente sikur diçka i këputej në shpirt. Në këto çaste mendonte se si mund ta qëllonte me pushkë kokën e tij, kur ta shihte të ngrihej prapa avllisë.

## 2

**Italianët përmes zërit të Kalem Gashit i bënë thirrje** edhe një herë Osman Mejdanit që të dorëzonte të tre ilegalët. Pas kësaj thirrjeje i zoti i shtëpisë qëlloi dhe krisma e kobures së tij u ndoq nga katër krismat e pushkëve të djemve, nga një e Mirës dhe nga tre të ilegalëve. Atëhere u ndezën edhe bataretë e italianëve dhe xhandarëve të shoqëruara me bomba-dore që përplaseshin për mure dhe atje pëlcisnin.



Mira, përgjysmë e shtrirë, qëllonte dhe gëzhojat e fisheskeve të saj përhapeshin në postën e bardhë, ku mbështeste gjunjët. Ajo vetëm qëllonte, duke tërhequr dhe shtyrë shulin e pushkës, qëllonte dhe nuk thërriste si vëllezërit e saj.

Tek tërhiqte për herën e fundit shulin e pushkës, vërshëlleu një plumb nëpër dritare dhe ajo ra mbi posten e bardhë. Aty për aty i ndriti vetëm një mendim, si një vegim i shpejtë: «Nuk është plumbi i Kalemit».

Hazir Shipshani u hodh me vrap drejt saj. U ul dhe ia vuri kokën në gjoksin e tij. Ajo rënkonte fare lehtë sikur të psherëtinte, duke mbajtur sytë në tavanin me dru të gdhëndura në formën e zogjve dhe të luleve. I dukej sikur këta zogj të drunj të fluturonin duke e marrë edhe atë me vete diku në një qiell të pafundmë, në një qiell tjetër të ndryshëm nga ky që ishte mësuar ta shihte çdo ditë.

Me sy në tavan, në gjoksin e Hazir Shipshanit, ajo lëvizi pakëz buzë gati të zbardhura dhe nxori një zë si një psherëtimë:

— Nuk ishte plumbi i Kalem Gashit. Më thuaj, nuk ishte?

Hazir Shipshani, ky ilegal si një dru pa lëng, ky njeri i kthyer në ide të thata për të kryer vetëm një qëllim të një lufte të shenjtë, si një besimtar fanatik, u drodh i tëri. Kësaj vajze që po vdiste, me gjithë thatësinë e tij jo njerëzore, ai duhej t'i bënte lëshime dhe t'i thoshte një gënjeshtëri. Sipas tij ishte Kalem Gashi që kishte qëlluar. A mund t'ia thoshte këtë? Dhe ai vendosi të tradhëtonte mendimet e tij, të bënte human human një xhandar! Hëm! Bukur, Hazir Shipshani, bukur!

Ai lëmoi flokët e vajzës me dorën që i dridhej dhe tha:

— Nuk ishte plumbi i Kalem Gashit. Unë nuk pashë ndonjë xhandar që të qëllonte. Pastaj ai që të dashuron, nuk të vret...

Vajza përnjëherësh ia shtrëngoi Hazir Shipshanit dorën e varur në gjunjë:

— Mirë!.. Vetëm ti e di... Edhe babai do të...

Por ajo i la fjalët përgjysmë. E zuri lemza, regëtiu dhe vdiq. Krahët e saj tani vareshin dhe koka me flokë të gjatë binte poshtë pa jetë.



— E vranë! — tha Hazir Shipshani me trupin e saj në krahët e tij të shtrirë përpara.

Të katër djemtë e Osman Mejdanit, duke u zvarritur gjunjazi, u mblodhën rreth trupit të motrës. Pushkët e tyre heshtën për një çast. Dëgjoheshin vetëm të shtënat e italianëve dhe xhandarëve dhe koburja e Osman Mejdanit.

Heshtja e pushkëve në dritaret e odaye e shqetësoi Osman Mejdantin dhe zbriti me vrap nga baxha e çatisë, duke thirrur:

— Ç'bëni, more? Ç'keni që heshtni?

Mes heshtjes, pas pak, në odë u ndjenë hapat e rën-  
da të Osman Mejdanit. Ai qëndroi përballë Hazir Shipshanit që mbante në krahë të bijën e vdekur. Nëpër mustaqet e tij të thinjura rrodhën lotët e nxehtë dhe ranë në ballin e ftohtë të çupës. I heshtur u përkul dhe e puthi në sytë që vështronin pa jetë në tavanin e gdhendur të odës.

— Çupë e babait! — pëshpëriti ai dhe e mori nga krahët e Hazir Shipshanit.

Sikur të kishte frikë se mos e zgjonte, e shtriu në posten e bardhë dhe me gishtrinjtë e trashë ia mbylli kapakët e syve. Të tre ilegalët vështruan shoku-shokun. Në këtë vështrim dukej sikur ndjehej pesha e një faji të padëshiruar.

— Na fal, o Osman Mejdani! E kush mund ta mendonte, se do të arrinim gjer këtu!.. — tha Hazir Shipshani.

Osman Mejdani nuk foli. Zuri dritaren e sërë bijës dhe qëlloi tri herë me koburen e tij të vjetër. Ndërsa Hazir Shipshani ndezi një cigare i ulur në posten e bardhë pranë trupit të vajzës. Duke nxjerrë tymin e kaltër të duhanit nga hundët vështronte i heshtur kurmin e ri të hijshëm, kurmin e palëvizur që para pak minutave merrte frymë dhe vinte erë manushaqe.

— Të gjithë do të vdesim. Mua më vjen keq të vdes! — tha ngadalë më i riu i ilegalëve, Andrea, një djallë me flokë të krehura mënjanë, me një fytyrë të imët me faqe me push të verdhë si i pjeshkës së arrirë.

— Ke parë ndonjëherë njerëz të vranë? — pyeti Haziri pa i hequr sytë nga fytyra e vajzës së shtrirë.

Andrea u drodh dhe mbuloi fytyrën me dorë.



— Nuk kam parë! — tha ai me një zë si të fillimit të një kënge të vajtueshme.

Hazir Shipshani u kthye nga ai, e vështroi drejt e në sy dhe ia fërkoi flokët, duke ia shpupuritur, si një fëmije:

— Eh! — bëri ai dhe nuk tha gjë tjetër.

Djemtë e Osman Mejdanit bashkë me të atin dhe illegalin e tretë vazhdonin të qëllonin. Që prapa avllisë ngriheshin dhe uleshin tytat e pushkëve të italianëve dhe të xhandarëve.

— Si thua ti, Hazir, do të vritemi? — pyeti Andrea me një naivitet fëmije.

Hazir Shipshani padashur buzëqeshi, megjithse çastet ishin të rënda.

— Nuk besoj të vritemi të gjithë, — tha Hazir Shipshani dhe ia shpupuriti përsëri flokët Andreas, siç bën vëllai i madh me të voglin.

Në këtë kohë vërshëlleu një plumb dhe goditi në qoshen e odës. Pas vërshëllimës ra nën dritare edhe djali i mesëm i Osman Mejdanit. Në fillim u duk sikur asnjëri nuk e vuri re, se të gjithë qëllonin. Pastaj u ngrit Osman Mejdani me Hazir Shipshanin, u përkulën mbi trupin e tij, e morën dhe e shtrinë pranë së motrës. Andrea përsëri mbuloi fytyrën me duar dhe filloi të qajë me dënësë. Para tij rrinin shtrirë dy trupa të bukur pranë njeri-tjetrit. Në këmbë të tyre gjunjëzohej i ati, që dukej sikur falej.

Andrea zbuloi fytyrën dhe thirri gati në lebetitje:

— Ne do të vritemi të gjithë! Nën at tona kanë edhe nga një djalë tjetër. Osman Mejdani do t'i shuhen krejt. I kanë mbetur edhe tre kandilë pa shuar. Ç'të bëjmë, Hazir Shipshani. Ti je më i madhi dhe na nxirr nga këtej të dorëzohemi!

Hazir Shipshani që një herë ishte dorëzuar para vajzës së Osman Mejdanit e vështroi me dhimbje Andrean dhe nuk foli.

Ilegali i tretë që qëllonte krah djalit të sapovrarë, ktheu kokën nga Andrea dhe ia hodhi sytë zyrtë. Nofullat e tij të rënda u dukën sikur po thyenin lajthi, pasi kërcitën tri herë. Ai e kishte zakon të shtrëngonte nofullat dhe të kërciste dhëmbët pas ndonjë kuvendimi të pa-



pëlqyer. Por ai pas kësaj shenje zakonisht nuk fliste. Edhe të tjerët heshtnin nga frika e ndonjë zënke e shërrë, se ishte njeri hijerëndë dhe përherë i zemëruar. Tërë jetën kishte punuar maleve qymyrtar me dy-tre shokë dhe ditë e netë i kishte kaluar nëpër shira, dëborëra dhe vapë të rëndë. Krahët i kishte si degë lisi dhe qafën të shkurtër dhe të trashë.

Andrea kur dëgjoë kërcitjen e nofullave të tij në fillim heshti, pastaj nuk u përmbajt:

— Mjaft! Të duken pak kërcitjet e pushkëve të tyre? Dashke të na tmerrosh edhe me kërcitjet e tua!

Qymyrtari e vuri revolverin në dorën e majtë, hodhi dy hapa dhe e kapi Andrenë për gjoksi:

— Të marr shpirtin! — tha ai duke e tundur.

— Zyko! — thirri Hazir Shipshani.

Zykoja e la Andrenë dhe shkoi përsëri pranë dritares pa folur.

Hazir Shipshani e uli grykën e kobures. Vetullat i ranë mbi sytë e tij të kaltër.

— Nuk vritemi të gjithë! — i tha Andreas dhe u ngrit nga poshtë dritares; hodhi disa hapa nëpër odë, pastaj u përkuul mbi trupin e Mirës, ia vuri të dy duart nën shpinë dhe e ngriti në krahë. Pushkët e tre djemve heshtën. Osman Mejdani hapi krahët, që do të thoshte se asgjë nuk kuptonte se ç'bëhej. Pa thënë asnjë fjalë, Hazir Shipshani, me trupin e Mirës në duar doli nëpër derë.

— Ku shkon? Lajthite? — thirri Osman Mejdani, duke e ndjekur pas me vrap.

— Nuk vritemi të gjithë! Do të shkoj të vritem unë. Do të shkoj me një të vrarë në krahët e mi!

Andrea pas një çasti tërë hutim, diçka pëshpëriti nëpër buzët e holla dhe vrapoi në gjurmët e Hazir Shipshanit.

— Hazir! Unë nuk thashë të vritesh ti! Hazir, unë pyeta më shumë veten time! Falmë, Hazir! — thirri ai i skuqur në fytyrë si një vajzë.

— Ktheu! — urdhëroi ashpër Hazir Shipshani.

Kur u kthye, të tre djemtë e Osman Mejdanit dhe Zykoja i ngrysur, rrinin nën dritaret e tyre me pushkë në duar. Në posten e bardhë shtrihej pa jetë djali i mesëm.

Në mes të odës qëndronte Andrea. Dukej sikur mbannte vesh se ç'bëhej andej prapa avllisë.



Djemtë filluan të qëllonjë përrsëri nga dritaret. Por në këtë kohë u dëgjua zëri i Hazir Shipshanit:

— Mos qëlloni! Unë po iu dal përpara italianëve dhe xhandarëve!

Pas këtyre fjalëve Hazir Shipshani ia hoqi llozin portës dhe doli në oborr, duke mbajtur në krahë trupin e Mirës. Pas e ndiqte Osman Mejdani me kokën lart dhe me mustaqet si kashtë. Italianët dhe xhandarët e ndërprejnë zjarrin. Nga muri i ulët i oborrit u ngrit trupi i gjatë i Kalem Gashit me pushkë përpara gjoksit.

— Merre, Kalem Gashi, këtë trup dhe jepja si dhuratë italianëve! Në mos është e fejuara jote, është motra jote! Na, merre! — thirri me zë të lartë dhe tronditës Hazir Shipshani.

Degët e kumbullës së gjelbër ulnin krahët mbi supet e tij. Koka e Mirës varej mbi bërrylin e Hazir Shipshanit.

Njëzet hapa larg Kalem Gashit u shfaq shtati me rrobe të gjelbra i oficerit italian, që shtrëngonte në dorë revolverin e mbushur. Ai e ftoi Hazir Shipshanin të dorëzohej.

— Zoti oficer! — tha Hazir Shipshani me trupin e Mirës në krahë. — Para se të dorëzohem erdha t'ju jap këtë shtatore. E keni dhuratë nga shqiptari Kalem Gashi!

Pas një heshtjeje kërcënuese të nderë mes tyre, oficeri italian me kobure në dorë u drejtua nga Hazir Shipshani. Hapat e tij i ndiqte Kalem Gashi me një vështrim të rëndë dhe të egër. Dhe kur oficerit i duheshin edhe dy hapa për ta kapur Hazir Shipshanin e përkulur nga pesha e trupit të Mirës, ngriti pushkën dhe qëlloi. Oficeri nuk arriti dot as ta hedhë vështrimin nga e shtëna. Ra pa frymë.

I verdhë dyllë, xhandar Kalem Gashi e la pushkën mbi trupin e italianit të shtrirë, e hoqi kapelën, u çapit me hapa të gjatë dhe ia mori Mirën nga krahët Hazir Shipshanit. E vështroi një minutë të tërë dhe pastaj e uli shtrirë në lëndinën e vogël të oborrit me lule të verdha nën kumbullën me fletë të një gjelbërimi të thellë. I ati i saj, Osman Mejdani, dhe Hazir Shipshani qëndronin më këmbë.

Kalem Gashi ktheu kryet nga të dy burrat pa folur asnjë fjalë. U ul mbi trupin e shtrirë të oficerit, e shtyu



me çizmen e tij të madhe, mori pushkën dhe me vrap u hodh përtej murit të ulët të oborrit.

Hazir Shipshani dhe Osman Mejdani në fillim dëgjuan trokitjen e çizmeve të tij nëpër gurët, pastaj një thirrje të llahtarshme. Pas thirrjes krisi batareja e pushkëve.

— Ç'bëhet kështu? — pyeti Osman Mejdani.

— Xhandarët ua kthyen pushkën italianëve. Kundër njëri-tjetrit! — tha Hazir Shipshani.

— Breh! — bëri Osman Mejdani

### 3

Në oborr erdhën edhe të tre djemtë e Osman Mejdanit dhe të dy ilegalët. Kërcisnin pushkët dhe pëlçisnin bombat tatëpjetë kopshteve dhe përroit me ferra. Dhe përmes këtyre krismave në oborr vrapuan gruaja e Osman Mejdanit dhe e kunata e tij, Bajamja, duke qarë me kujë e duke çjerrë flokët mbi trupin e Mirës në lëndinën e vogël me lule të verdha nën degët e kumbullës së gjelbër. Ato ende nuk e dinin se në odë mbi posten e bardhë ishte i shtrirë edhe djali tjetër. Osman Mejdani, me gjithë atë hidhërim që kishte, e vështroi vëngër të kunatën me mes si të grerës, diçka murmuri nëpër buzë, por nuk e shtyu më tutje. Le të qajë edhe kjo, mendoi ai.

Krisma e pushkëve sa vinte dhe largohej. Hazir Shipshani qëndronte më këmbë i zbehtë me cigare në buzë dhe duar të kryqëzuara para gjoksit.

Andrea e vështronte me ndjenjën e një përgjërimi të thellë. E kishte marrë me mend se Hazir Shipshani, ky njeri i çuditshëm që kurrë nuk hutohej, diçka do të bënte për shpëtimin e tyre. Dhe tek dëgjonte nga larg krismat e pushkëve dhe thirrjet e mjegullta të italianëve dhe xhandarëve, tha i menduar:

— I munde, or Hazir Shipshani, i munde!

— I madh! — psherëtiu fjalërralli Zyko, i vrenjtur dhe i ashpër.

Hazir Shipshani, pa ua vënë veshin Andreas dhe Zykos, e zuri për krahu Osman Mejdani, që heshte para



trupit të së bijës mes dy grave, ia fshiu me dorë lotët në faqet e vyshkura dhe në mustaqet e thinjura, psherëtiu me tërë gjoksin e tij të madh dhe tha me sy nga Mira e shtrirë:

Hazir Shipshani nuk e tha dot se ajo i kishte mundur të gjithë, edhe atë vetë. Këtë ai nuk mund ta thoshte, megjithse e mendonte.

---

1981



# Një grek i vogël në shtëpi

## 1

Im atë kishte pasur një mik nga fshatrat greke aty pranë kufirit. Më kujtohet që greku vinte shpesh në shtëpinë tonë i veshur me qillota shajaku dhe me jelek me kopsa të dendura. Ngaherë mbante në kokë një kapele republrike të vjetër me strehë të varura dhe në buzë një çibuk me bisht të gjatë, që gjithmonë tymonte. Babai i thoshte grekut qirjes Thoma, dhe ai t'im eti qirjes Rizai.

Sa herë vinte në shtëpinë tonë hapte portën e madhe të oborrit, pa trokitur dhe thërriste:

— Qirjes Rizai!

Gjyshja, që e dëgjonte zakonisht e para, se rrinte në odën me dritare përballë portës, dilte në hajat, ku ngriheshin shkallët e drunjta për në katin e dytë të shtëpisë dhe i thërriste babajt:

— Të erdhi qirjes Thomaj yt, po dil!

Ajo vetë nuk dilte ta priste qirjes Thomain, se grekërit nuk i kishte qejf që kur e kishin plagosur gjyshin rëndë në mulli andartet e tyre. Dhe çdo grek ajo e quante andart. Pastaj ajo e dinte mirë se si kishte luftuar hallo Zyhraja me të vëllanë e saj në Qafën e Kazanit kundër njëqind e ca andartëve dhe kishte parë njerëz të sakatosur dhe gjak. Prandaj shpesh i thoshte babajt:



— Aman, ç'e ke këtë qirjes, more Riza? — dhe prishte buzët sikur të kishte përpara diçka të mërzitshme dhe të keqe.

Babai nuk donte të hynte gjatë në kuvendim me gjyshen time nga frika se mos mposhtej dhe mos zihej në fjalë, pasi ajo kishte shumë gjëra bindëse.

— Qirjes Thomai është burrë i vërtetë! — u përgjigjej ai.

— Aman! Ti vetë tetëmbëdhjetëvjeçar ke luftuar me grekun në Zervackë të Pogradecit, kur u vra Gani Butka e Zalo Prodani!... Aman!...

— Mirë, mirë, Nalkë!

Im atë gjyshen time e thërriste me emër, megjithëse e kishte nënë. E quanin Naile dhe ai i thoshte shkurtimisht Nalkë.

Mua qirjes Thomai më pëlqente, se kishte një violinë dhe kur vinte në shtëpi i binte aq bukur sa të gjithë mbeteshin gojëhapur. E mbështeste mjekrën për violinë, lëvizte harkun dhe gishtërinjtë e dorës së majtë luanin valle. Unë atëhere isha nëntë vjet dhe kisha filluar t'i pëlqej gjërat e bukura.

— Të lumtë ajo dorë, o qirjes Thomai! — thoshte babai, duke pirë raki bashkë me të në odën e miqve.

Dhe një ditë qirjes Thomai erdhi në shtëpinë tonë me një djalë të vogël në moshën time. Djali nuk e hiqte dorën nga ajo e babait të tij, sikur të kishte frikë se mos ndahej dhe të mbetej për jetë në shtëpinë tonë, mes një-rëzve të huaj.

— E solle? — i tha babai. — Mirë, bëre! Pavli do të rrijë bashkë me Dritin! — dhe m'u kthye mua: — Merre e shpjere andej nga qershija. Hipni në qershë, po mos hani shumë se u ze barku!

Unë iu afrova grekut të vogël dhe ia zura dorën që e kishte të lirë. Por ai nuk e lëshonte dorën e të atit. Me buzë të varura dhe me sy të mëdhenj, të zez, të mbushur me lot, shtrëngohej pas qillotave të qirjes Thomajt.

— Eh! — tha qirjes Thomai. — Dunja, dunja! Vdiq Lefteria e zezë. Bota është e turbullt. Luftë do të kemi! Mbaje Pavlin, qirjes Riza, se s'kam ç'të bëj me të. Do të shkoj të gjej ndonjë punë në Selanik. Të ishte Lefteria gjallë, e mbante ajo...

E kuptova që greku i vogël do të jetonte në shtëpinë



tonë dhe bashkë do të ruanim lopët. Po si i bëhej puna që ky Pavli s'dinte asnjë fjalë shqip? Si do të merreshim vesh dhe si do t'ia mësoja gjuhën tonë? Mbaroi! Duhej ta merrja me vete në shkollë.

Qirjes Thomai i fliste greqisht të birit dhe ia fërkonte flokët e zez. E merrja me mend se ai i lutej të vinte me mua. Ndofta që ta merrte me të mirë, por edhe që t'i linte një kujtim, i dha të birit një shami të vogël të lidhur me nyje. Pavli e futi menjëherë në xhepin e pantallonave prej shajaku. Atëhere greku i vogël ma dha dorën. Dora e tij ishte njëlloj si imja! Ç'thoshte kjo gjyshja që greku ka dorë tjetër?

Kur Pavli ma dha dorën, pashë që qirjes Thomai nxori nga xhepi një kuletë të vjetër prej meshini. Im atë e vështroi dhe i ngrysi vetullat.

— Qirjes Thomai! Ç'janë këto që bën! Ne jemi miq! Mos më jep gjë se do t'i hedh!

Qirjes Thomai nxori një pare të vogël, të verdhë që vetëtinte. Ishte një monedhë floriri. Babai e mori, u mat ta hidhte, pastaj e fshehu në grusht dhe ia futi qirjes Thomait në xhep.

— Më erdhi keq ta hidhja, o qirjes Thomai! — tha ai.

Këtu qirjes Thomai e nxori kapelen me strehë të varura, u përlot dhe e përqafoi babanë.

Pas kësaj ai hapi këllëfin e murmë dhe nxori violinën dhe harkun. E mbështeti mjekrën në drurin e lëmuar të violinës, e lëvizi harkun dhe në oborr fluturoi kënga e qiparisit që e pëlqente shumë im atë:

Ushtari trim donte një strehë,  
Një fshat kërkonte a një fortesë,  
S'gjeti as fshat e as fortesë,  
Përrveç një qiparis të shkretë.  
O qiparis, më jep ti strehë;  
— Ja degët: armët var në to,  
Ja rrënjët: kalin lidh në to,  
Ja hija ime: shtrihu, biro!...

Babai e vështroi njëherë qirjes Thomanë dhe njëherë grekun e vogël, nxori shaminë, ktheu kokën që të mos



e vinim re se ç'do të bënte. Po unë e kuptova që ai fshinte lotët.

— Ja, këtë flori dua unë, o qirjes Thomai. Tani më ke paguar.

## 2

Greku i vogël mbeti në shtëpinë tonë. Rrinte i pikëlluar si një jetim pa njeri dhe natën unë e ndieja si qante ngadalë dhe herë-herë ofshante. Këtë e ndieja se ne flinim në dyshekët pranë e pranë në odën e madhe të katit të dytë. Një natë bile unë u ngrita dhe me kandil në dorë i qëndrova te koka, duke ia lëmuar flokët e duke e ngushëlluar:

— Ç'ke ti, Pavli! Ja, më ke mua! E kemi baba Rizanë. Dhe qirjes Thomai do të vijë sa të mbledhë ca pare andej nga Selaniku dhe ti pastaj do të shkosh me të në Greqi dhe unë do të vij si mik dhe ne do të hamë stafidhe! — Mua më pëlqenin stafidhet.

Pavli nuk kuptonte se ç'i thosha unë, por diçka të mirë ndjente dhe më vështronte me sy të përlotur nën dritën e kandilit. I lodhur nga mërzia dhe pikëllimi ai mbyllte sytë dhe flinte, duke u trembur në gjumë.

Gjyshja në fillim i rrinte ftohtë grekut të vogël dhe nuk e përkëdhelte. Megjithatë nuk e shante. Vetëm e qortonte babanë që e mori në shtëpi.

— Ti, Nalkë, mos e shaj grekun e vogël! — thoshte babai.

— Aman! Tërë shtëpia më bie erë grek! — thoshte gjyshja dhe merrte erë me hundë, sikur donte të nuhaste.

— Po mos mba j' erë ti, Nalkë! — tha babai.

Ajo u nxeh:

— Tallu, Riza, tallu, kur të rritet ky greku dhe të vijë e ta bëjë shtëpinë hi! Na, ta bëjë — dhe gjyshja shtriu pëllëmbën e hollë. Se ky greku, që duket sa një plesht, do të na i mësojë të gjitha huqet, do të shohë çdo vrimë të shtëpisë e çdo hatull, e çdo gur, e çdo tjegull, e çdo deriçkë, e çdo hendek e pastaj fap të vjen e të djeg. Hallo Zyhraja, ndjesë pastë, nuk kishte mbajtur në shtëpi ndonjë grek e nuk e kishte rritur, dhe kur zbritën grekë-



rit nga Qafa e Kazanit erdhën e ia dogjën ç'kishte e ç'nuk kishte, sikur t'ia dinin të gjitha. Dhe ti tani, ja, hopa na marrke një grek, që thyeftë këmbën ai qirjes Thomai i mallkuar, që na e solli! Unë kam hallin e Dritit që fle me dyshek pranë këtij grekushit! — tha ajo e kapuliti sytë mes kapakëve të rrudhur.

— E ç'frikë do të kesh? — tha babai duke e vështruar t'emën me vëmendje.

— Ç'frikë thotë! Eh! Po ja, zoti mos e dhëntë, ngrihet natën, ia ngul thikën dhe ikën. Eh, sikur s'i di unë grekërit? Pse, s'ia nguli thikën djalit të hallos tënde në Nikolicë dhe pastaj Zyhraja, ndjesë pastë, e vrau me dyfek dhe ua hodhi qenve? Po djali i hallos tënde shpëtoi se iu shërua plaga. Dhe pastaj në Qafë të Kazanit bashkë me hallo Zyhranë bënë kërdrinë. Aq sa në degët e lisave dhe pishave kanë mbetur akoma kockat e grekërve, se i morën galat dhe galloft për t'i ngrënë nëpër drurët e pyllit...

— Ishte tjetër kohë atëhere! — psherëtiu babai.

— Na qenka kohë tjetër! Aman! Sikur koha është fustan dhe ndërron një herë për behar, një herë për dimër! Aman! — tha gjyshja dhe i ktheu babait kurrizin e ligur.

Im atë e dinte se ç'kokë kishte gjyshja dhe dyshonte se mos ajo do t'i rrinte grekut të vogël ngaherë hundë e buzë e do ta shante gjersa t'ia mërziste jetën e t'ia bënte skëterrë. Duke e ndjerë veten të pafuqishëm ndaj saj, më thoshte mua që t'ia lavdëroja Pavlin dhe t'ia mbushja mendjen se ai ishte i mirë, se duhej t'i vinte keq që kishte mbetur jetim.

Dhe gjyshja një ditë më tha:

— Po ky grekush, more bir, ka ardhur në shtëpinë tonë goxha derr! Po ta kishim marrë që kur ishte një vjeç a gjashtë muaj, e mësonim me huqet tona! Ku mësohet tani! Ja, si më vjen erë grek! — tha ajo dhe mori erë me hundën rrudha-rrudha.

Unë zura të qesh me të madhe. Babai e dëgjoi të qeshurën time dhe erdhi se u gëzua që gjyshja qënkesh bindur për t'i pasur mirë punët me grekun e vogël. Tek qendronte babai në këmbë, gjyshja vazhdonte:

— Nuk i mëson ai huqet tona! A nuk e shikon ti si mban një shami me një nyje? E mban në xhep dhe kur



fle e shtrëngon në grusht... He, harron ai? E ç'ka në atë shami të lidhur?

Mua m'u kujtua shamia e Pavlit dhe më erdhi çudi me gjyshen që ia kishte vënë re aq me kujdes.

— Qirjes Thomai kur iku ia dha unazën e tij. Po të vdesë qirjes Thomai, a po të vritet, Pavlit do t'i mbetet një kujtim. E ç'të keqe ka? — thashë unë.

— Posi! Ç'të keqe ka! Ja, në atë shami greku i vogël ka të mbështjellë grekun! S'paska asgjë! Si s'paska asgjë! E ç'të ketë më shumë se grekun! — tha gjyshja tërë inat.

— Po lere tani! Grekun, grekun! — tha babai në këmbë, duke bërë me dorë i mërzhitur. — Do të mësohet greku me ne dhe do të kemi një mik. Çfarë do ti që të bëjmë, ta therim?

Gjyshja ngriti fytyrën për të parë babanë që qëndronte në këmbë.

— E di unë që greku s'i harron huqet! Më vjen erë grek!

— Po ç'të bëjmë që të ta pakësojmë këtë erë? — tha babai me qesendi, gjysmë seriozisht, gjysmë shaka.

— Po të paktën ta bëjmë synet! Po ta bëjmë synet gjysma e erës do t'i ikë! — tha gjyshja.

Babai dhe unë filluam të qeshim me zë të lartë. Unë u ngrita dhe vrapova në derë duke u hedhur e duke e ulur kurrrizin.

— Nëntë vjet është ai. E mban synetin. Ja, kaqkëz e ka, sa një cironkë. Edhe Driti vjet u bë synet. E thërresim xherahun dhe e bëjmë. Kasem Kosturi e bën menjëherë. Ja, vete unë i them! — dhe gjyshja u ngrit sikur nuk priste puna.

— Nuk do ta bëjmë synet! — tha babaj siç ishte në këmbë.

Gjyshja u kthye nga ai e tëra e vrenjtur:

— Nuk e bëmë synet? Të hajë dhe të pijë këtu, të flerë dhe të zgjohet këtu dhe të mos bëhet synet? — thirri ajo duke përpjekur këmbët e vogla në truall.

Im atë nuk i ktheu përgjigje gjyshes. Ai shpejtonte për diku. Më duket se do të shkonte në Bilisht për të bërë pazar. E hapi derën pa folur dhe doli të përgatiste kalin, t'i vinte shalën, hejbetë dhe frerin. Pas i ra gjyshja, duke u çapitur shpejt e shpejt me kërcinj të hollë, me



grushte të shtrënguar si guriçkat e zallit të lumit tonë. Ecte, tundte kokën, duke folur me vete: «Ja, kështu ma bën ky mua! E hedh një fjalë dhe ikën. E di unë që nuk pyetem në këtë shtëpi. Sikur të jem e botës! Po? I vë shalën kalit dhe ikën! Mirë e ka. Na le ne me një greçkë dhe na thotë: mos e bëni synet!» Dhe duke vrapuar me çelësat, që i bënin xhenger-xhenger në brez, iu afrua tim eti, që shtrëngonte palldemin e shalës së kalit. Kali shkrofetiu dhe teshtiu me të madhe.

— Plaç! — bëri gjyshja e trembur.

— Mos i thuaj «plaç» kalit — e qortoi babai pa i ngritur sytë nga palldemi.

— Eh, se më mori vesh kali mua! Mua s'më merr vesh ti që je njeri, jo kali pastaj! — tha gjyshja.

— Unë do kthehem në darkë! — tha babai.

— Në darkë nuk do t'ia gjesh shoputkën e cironkës grekut tënd! — tha gjyshja.

Im atë me duar në shalën e kalit e vështroi vëngër:

— Nuk do ta bësh synet! Qirjes Thomait unë do t'ia kthej djalin siç ia mora. E solli me shoputkë, do t'ia kthej me shoputkë. Merr vesh ti?

Gjyshja e zuri kalin për freri dhe e tundi:

— Unë do ta bëj synet dhe shoputkën do t'ia hedh në lumë t'ia hanë zhabat dhe s'të pyes as ty, as Metaksanë, të madhin e Greqisë! Na sjell ti në shtëpi një grek dhe na thua të bëjë ç'të dojë. Të gjithë djemkat e fshatit janë pa shoputkë, greku na e tundka shoputkën mes tyre dhe na u mburrka: «unë kam shoputkë!» Si do ta mësojë shqipen ai po të ketë shoputkë? Shoputka nuk e le të mësojë shqipen! E ç'e duam në shtëpi një njeri që s'di të flasë, një memec? Pse me gishtërinj do të merremi vesh? Ja, ditën që i shohim gishtërinjtë, po natën? Dhënke urdhër ti: «mos e bëni synet»!

Babai ia mori nga dora frerit. E nxori kalin nga porta e madhe e oborrit, e shaloi dhe duke u larguar porositë edhe një herë:

— Mos e bëj synet!

— Gjer sa të dalësh ti përtej fshatit, cironka e grekut nuk ka më shoputkë! — thirri gjyshja, duke i bërë dy gishtërinjtë si gërshtë.

Ajo më gjeti mua në sofat dhe më tha se do të mbathte këpucët, do të hidhte në kokën sharfin dhe do të



shkonte të gjente xherah Kasem Kosturin, ta merrte me vete dhe ta bënte synet grekun e vogël.

— Po babai nuk do! — thashë unë.

— Yt atë nuk do, po dua unë! U bë ai të më urdhërojë mua!

Unë fluturoja nga gëzimi. Pavli, greku i vogël, do të bëhej synet! Dhe thosha me vete: «Sa e zgjuar dhe sa e zonja është kjo gjyshja! Pu-pu! Ç'gjyshe! S'pyet ajo as nga babai, as nga njeri!»

### 3

Nuk kaloi shumë kohë dhe erdhi xherah Kasem Kosturi me një enë si legen të vogël, me ilaçe dhe brisqe. Ai erdhi bashkë me gjyshen, që mbante kokën lart dhe ishte e kënaqur dhe e qeshur. Kasem Kosturi me një kokë nga pas të shtypur me pak flokë, pyeti se në ç'odë do ta bënte synet grekun, dhe gjyshja e shpuri në çardhakun me dritare të mëdha, që vështronin nga porta e oborrit.

Unë e mora grekun e vogël për dore. Pas nesh vinte gjyshja si në një ceremoni të rëndësishme, e heshtur dhe e krekosur. Greku nuk dinte se ç'ishte syneti dhe as mund ta kuptonte edhe sikur t'ia shpjegoje, megjithëse unë i bëja me shenja duke zgjatur gishtin para pantallonave dhe duke imituar briskun e berberit:

— Pavli! Kesh-kesh-kesh! Po nuk të dhemb! Mos ki frikë!

— E ç'i bën ashtu? Ku merr vesh ai? Më mirë nxirre cironkën tënde dhe tregoja! — tha gjyshja.

Unë nuk kisha zemër të rrija atje, ku Pavli do të bëhej synet dhe ika, duke e lënë atë me gjyshen dhe me xherah Kasem Kosturin. U fsheha prapa derës së odës dhe prita se ç'do të ndodhte. I fshehur mendoja se Pavli këtej e tutje nuk do ta donte gjyshen. Ai kurrë nuk do të pajtohej me të, pasi ajo ishte shkaktare e dhembjeve që do të ndjente kur t'ia prisnin shoptukën.

Në këtë kohë greku i vogël filloi të qajë e të bërtasë dhe pastaj të lebetitej. Unë vështroja përmes derës së hapur dhe gjithë gëzimi, që kisha pasur për ceremoninë e synetit, m'u kthye në pikëllim. Me vete fillova t'i shaj



gjyshen dhe xherah Kasem Kosturin, duke i quajtur katilë dhe të pashpirt.

Mandej Pavli dalëngadalë erdhi dhe u qetësua. Atëherë dëgjova gjyshen të thoshte:

— Ia premë, Kasem! Shoputkën ti merre dhe vare në degën e kumbullës që ta hajë ndonjë laraskë. Mos ma lerë këtu!

— Le t'ia hajë macja — tha Kasem Kosturi.

— T'u thaftë goja, Kasem! E ç'ta bëj unë macen pastaj? Të mbaj një mace që ka ngrënë një shoputkë greku? Të më lëpijë mua macja me gjuhën që ka lëpirë shoputkën e grekut? Tfu! T'u thaftë goja Kasem! — thirri ajo.

Gjyshja i veshi grekut të vogël atë fustan që më kishte veshur mua, kur u bëra synet, dhe i tha duke ia vënë dorën në flokët:

— Hë! Mos qaj, xhan! Shpëtove tani! E hoqe një të ligë!

Unë hyra në çardhak dhe e putha Pavlin në të dy faqet e lagura nga lotët. Ai qëndronte i veshur me dolloma dhe me këmbë të hapura, se i dhimhte vendi ku ishte bërë synet. Vështronte me sy të hutuar nga që nuk kuptonte se ç'duhej gjithë kjo punë.

Gjyshja nxori qesen dhe i dha Kasem Kosturit pare dhe ai falenderoi duke thënë:

— Qoftë për të mirë!

Kur iku Kasem Kosturi gjyshja zbriti poshtë, duke tundur kokën e kënaqur si pas një pune të madhe dhe të nderuar. Pas pak ne ndjemë erën e miellit të skuqur dhe gjalpit. Gjyshja kishte vënë tenxheren dhe bënte petulla dhe hallvë, se kjo ishte një ditë e shënuar. Duke gatuar ajo këndonte me veten e saj këngë që ne nuk i kishim dëgjuar:

Dasmë ka qirjes Rizai  
Dasmë e zifafet,  
Djalin e qirjes Thomait,  
E bëri synet!

Në ato oda të mëdha,  
Qelqe dhe sedef



Me gërnëtë e tambura  
Bota po bën qejf...

E vështrova Pavlin dhe i thashë duke i bërë shenja me duar dhe me gishtërinj:

— Këndon për ty. Bën hallvë e petulla për ty. Kur bëhet synet një djalë kërcet dasma. Po të ishte yt atë, qirjes Thomai, do t'i binte violinës. Është shumë bukur! Të gjithë do të këndojmë.

Pavlit i erdhi mirë dhe filloi të qeshë, duke harruar dhimbjen. Duke e marrë me të mirë dhe duke e bërë për të qeshur, i qëndrova pranë jastekut gjer sa u err. Tek rrinte shtrirë zuri ngoje disa herë emrin e tim eti, të vetmin njeri që e quante si shpëtimtar. Pa tim atë i dukej vetja i braktisur dhe jetim. Me siguri ai mendonte se po të ishte ndodhur babai, gjyshja nuk do të kishte guxuar ta bënte synet.

Im atë nuk u vonua deri në darkë, megjithëse i kishte thënë gjyshes të mos e prisnim shpejt. Zëri i tij u dëgjua në oborr. Pas pak kërcitën thundrat e kalit. Pavli ngriti përnjëherësh kokën nga jasteku dhe thirri:

— Qirjes Riza!

Prisja se ç'do të ndodhte në mes gjyshes dhe babait. Dëgjoja i tulitur pas derës gjysmë të hapur të derës. Ndjeva kollën e tij dhe pastaj zërin:

— E paske bërë synet! — i tha ai gjyshes në hashef.

— E nga e more vesh? Apo e poqe udhës Kasem Kosturin? — iu përgjigj gjyshja.

— E mora vesh nga hallva dhe petullat që po bën!

— E sheh sa i zgjuar qënke? E po unë s'kam pjellë një djalë budalla. Vetëm nga cër-cëri i tiganit e merr vesh se ç'ka ngjarë në të gjithë shtëpinë!...

«Ç'mend ka kjo gjyshja ime» — fola me vete pas derës.

Im atë ngjiti shpejt e shpejt shkallët. Kur hapi derën, unë kisha shkuar pranë Pavlit.

— Ç'të kanë bërë, o derëzi! — tha ai dhe e puthi Pavlin në ballë.

Greku i vogël ia hodhi krahët e hollë në qafë dhe filloi të qajë, duke sharë gjyshen.

— Mirë, mirë! Mos u mërzit, cironka nesër, shumë-shumë pasnesër do të shërohet dhe do të të bëhet më e



bukur! — e qetësoi im atë, duke ia fërkuar flokët dhe ballin.

— Pak qau. E duroi si burrë briskun e Kasem Kosturit! — thashë: unë.

Mandej ai më urdhëroi t'ia shtroja Pavlit dyshekun në odën e miqve, se do të kishim festë. Do të vinin saze-xhinjtë dhe miqtë për të kënduar e për të bërë qejf.

Vetë ai doli për të ftuar fqinjët dhe sazexhinjtë, ndërsa una ia shtrova dyshekun e ri grekut të vogël dhe i thashë të shtrihej e të çlodhej. Mua më kujtohej se ç'kisha hequr nga prerja e shoputkës.

Gjyshja solli një pjatë të madhe balte plot me hallvë, solli dhe një ftua të verdhë që e kishte ruajtur në sëndyk dhe ia vuri Pavlit pranë jastekut. Ajo tani nuk rrinte buzëvarur si më parë, por ishte e gëzuar dhe bile këndonte:

Qirjes Pavli ha hallva,  
Tarna-na, tarna-na!  
Se shoputkë s'ka që s'ka,  
Ky pedhja...

Greku i vogël i shtrirë përgjysëm në dyshek qeshte dhe mbulonte gjysmën e fytyrës me jorgan, duke lënë jashtë vetëm sytë e zez, që i vetëtinin. Edhe unë qeshja. Por e qeshura jonë shpërtheu më shumë kur gjyshja më zuri për dore dhe më tërhoqi në valle:

Ç'qe ky gaz, ç'qe ky kësmet  
Një grekush u bë synet!

Kur erdhi babai me sazexhinjtë dhe fqinjët tanë, na gjeti në valle edhe mua, edhe gjyshen.  
— Bjeruni sazeve! — u thirri babai sazexhinjve i papërmbajtur.

Dhe oda gjëmoi. Pastaj babai shtroi sofrën me mehze dhe raki për të festuar ashtu siç duhej.

Greku i vogël qëndronte gjysëm i shtrirë me pjatën prej balte me hallvë dhe me ftuan e verdhë pranë jastekut. Unë i rrija te koka...



Kaloi koha dhe Pavli mësoi aq mirë shqip, sa nuk e dallonte njeri që mund të ishte i huaj. E mësoi shqipen me mua dhe me shokët e mi, duke kullotur lopët e duke prashitur në arë. Ai luante si ne, qeshte si ne, këndonte si ne, shante si ne dhe vishej si ne. Bile edhe gjyshja kishte çaste që nuk e kujtonte si grek. E quante djalë siç më quante edhe mua. Ndërsa babai i thoshte:

— Ma ka lënë amanet qirjes Thomai, që të të mbaj si djalin tim. Po ti mos u mërzit, se qirjes Thomai do të vijë. Dhe do të gëzohet kur të të shohë se je bërë burrë...

— E po ky është trim, palikar është! — tha babai.

— Pa le kur ta marrë vesh qirjes Thomai që të kemi bërë synet! — thoshte gjyshja dhe Pavli qeshte, duke zbuluar dhëmbët e tij të bardhë.

— Po ti mos i trego që të dhëmbi! — qeshja une.

— Unë e harrova dhe s'më kujtohet nëse më ka dhëmbur! — thoshte ai.

— Po ky qirjes Thomai, more Riza, si s'dërgoi një kartë? — tha gjyshja një ditë, tek rrinim të gjithë në dhomën e zjarrit.

Babai e hoqi kapelën që e kishte harruar në kokë dhe e vuri në anë të postes:

— E ku vijnë letrat në këtë botë të poshtër!

Vërtet koha ishte e ligë. Sa kishte filluar lufta italo-greke dhe nga gjithë anët vërtiteshin ushtarë me helmeta dhe pushkë, makina dhe mushka të mëdha të ngarkuara me arka me fishekë e me thasë me bukë. Greku i vogël i vështronte ushtarët italianë, që ecnin njëri pas tjetrit me pushkë dhe çanta pas shpine edhe heshtëte. Tani ai ishte dhjetë vjeç, sa ç'isha dhe unë, dhe e merrte vesh se ku vinin këta ushtarë.

— Po këta do ta thyejnë qafën! — tha babai. — Andej do të t'u dalë përpara qirjes Thomai dhe këtej unë. Dëgjomë mua ti!

Pavli e dëgjonte babain dhe pastaj shikonte gjyshen, që tondte kokën dhe thoshte:

— Ta them unë, o Pavli! Do të dalë qirjes Thomai atje në kodrën e Poçrovës dhe do të bëjë kërdrinë. E di unë. Qirjes Thomai është burrë!

Dhe greku i vogël shtrëngonte në xhep nyjen e sha-



misë ku kishte unazën. Vetëm kjo shami dhe kjo unazë i kishte mbetur nga i ati. Rrobat dhe opingat i ishin grisur dhe babai i kishte blerë të tjera si të mijat.

— Pa ta shohim një herë atë unazën! — i tha babai.

Pavli e nxori nga xhepi shaminë dhe ia dha babait. Im atë e mori, e shtrëngoi nyjen e trashë me dorë dhe tha:

— Këtu nuk ka vetëm një unazë, por edhe një gjë tjetër.

Gjyshja dhe unë afruam fytyrat nga dora e babait, se u bëmë kuriozë për shaminë. Babai u mundua ta zgjidhte nyjen, por ajo ishte e shtrënguar, e përlyer me djerse si dyllë dhe ishte bërë si një kotkë spangoje. Babai mori një gozhdë të gjatë, e futi nëpër nyje dhe më në fund e zgjidhi.

— Ti s'e paske zgjidhur asnjëherë, more shejtan! — tha ai.

— Nuk e kam zgjidhur! — tha greku i vogël.

Im atë e hapi shaminë dhe para nesh doli një unazë e madhe e argjendtë me dy shkronja në sheshin e saj. Bashkë me unazën ishte edhe një gëzhjë fisheku, që kishte brenda një copë letër të mbështjellë. Në letër babai lexoi emrin e fshatit ku kishte lindur Pavli, emrat e kushurinjve dhe të afërmëve të tij dhe në fund: «Pavli mos harro qirjes Rizain».

— Breh! — tha babai dhe e lexoi me zë të lartë. Dhe greku i vogël menjëherë u hodh nga minderi dhe ra në gjoks të babait si një zog i vogël, ra dhe zuri të qajë me dënese. Babai ia lëmoi flokët dhe i tha i prekur:

— Mirë, mirë, Pavli! Ja, kështu, shkruan qirjes Thoma!

Edhe gjyshja u përmalua dhe tha se Pavli qënkesht një djalë i mirë dhe se kur të rritet do t'i gjejmë një nuse dhe këtë shami do t'ia fusim në një hajmali, që ta mbajë të varur në gjoks.

## 5

Ne e kishim fshatin buzë kufirit me Greqinë, gjysmë ore më këmbë dhe i kishim parë edhe italianët, edhe grekërit. Italianët hynë në Greqi dhe u thyen. Në fshat erdhën ushtarët grekë me rrobe ngjyrë dheu dhe me ka-



pota të gjata. Por ata qëndruan pak në fshat. Ikën pas gjurmëve të italianëve larg. Greku i vogël i vështronte një nga një të gjithë, se kujtonte mos gjente mes tyre qirjes Thomanë, të atin e tij.

— E ku e gjen dot, more i zi! Sa janë këta! Si dru-rët e pyllit. Dhe njëlloj të veshur! — i thoshte gjyshja Pavlit.

Por në dimër, kur grekërit ktheheshin në Greqi në kolona të gjata njëri pas tjetrit me fytyra në jakat e kapotave ngjyrë dheu, Pavli mendonte se patjetër do ta gjente të atin. Dhe një ditë ai u duk sikur humbi. E kërkoi nëpër shtëpi, nëpër oborr dhe nëpër kopshtije dhe s'e gjenim.

— Po ky grekushi ç'u bë? Mos ka ikur me ushtarët? — tha gjyshja.

— Hëm! — bëri babai. — Ai nuk mund të ikë, po s'erdhi ta marrë qirjes Thomai. Kot kërkon babain e tij nëpër ushtarët, budallai. Qirjes Thomai po të jetë me ushtarët vjen drejt e në shtëpi.

Gjyshja prishi buzët:

— Posi! Vjen! E ku e lenë kumandarët të vijë! Se mos qirjes Thomai është ndonjë kumandar!

— Qirjes Thomai bëhet edhe kumandar! — tha babai.

— Posi! Me atë që i bie vili — viu na u bëka kumandar — tha gjyshja dhe bëri sikur i ra violinës.

Babai m'u kthye mua:

— Shko, more, kërkije! Ku është futur shejtani!

U nisa nëpër dëborë dhe e gjeta në kodrën mbi rrugë, të mbështetur pas një gorice. Qëndronte dhe ndiqte me sy kolonën e ushtarëve grekë, që ecnin të lodhur dhe të rraskapitur. Disa çalonin, disa ecnin me kokë të lidhura e me krahë të varur në lecka të bardha. Ecnin dhe nuk flisnin.

— Pavli, ç'bën këtu? — e pyeta une.

— Shikoj mos del Babai! — tha ai me sy nga vargu i ushtarëve grekë.

Pas goricës u mbështeta edhe unë dhe fillova të ndjek me sy ushtarët që ecnin nëpër dëborë.

— Pse ikin? — pyeti Pavli.

— Ikën se në Greqi ka hyrë gjermani! — i thashë unë, se e kisha dëgjuar nga babai.

Pavli më zuri për krahu dhe u kthye nga unë:



— Kështu thotë qirjes baba Rizai?...

— Ëhë! — bëra unë me kokë.

Na hyri një i ftohtë i madh, se atje te gorica frynte erë me thëllim. Greku i vogël dridhej dhe ngrohte duart me frymë. Kishte filluar edhe të errej dhe fytyrat e ushtarëve tani nuk dukeshin. Ata lëviznin si hije nëpër dëborë. Dhe ne shkuam në shtëpi.

Gjyshja na shau dhe na tha se ne ishim budallenj që rrinim mes dëborës dhe erës për të parë ca ushtarë. Na tha që t'i zbatnim opingat dhe çorapet dhe të ulëshim pranë zjarrit, që të mos merrnim ndonjë plevitë. Pastaj iu kthye Pavlit:

— Dashke të ikësh ti me ushtarët. Sa një plesht e dashke të marrësh rrugët! E ku të të gjejë yt atë pastaj! Nuk rri në të ngrohtë, po te greku e ke mendjen! Të bë më edhe synet... — i tha gjyshja duke ia hequr xhaketën e lagur dhe pantallonat.

Pavli u nxeh. I shtrëngoi dhëmbët dhe i ndriti sytë si vetëtimë.

— Nuk të dua ty, plakë!

Këtë gjyshja s'e priste. Iu drodh dora dhe iu ngjit mjekra te buza e poshtme.

— Uh, më març pleshtat. U bë një grekush të më shajë! Uh, unë e ngroh, unë ia thaj rrobet, ai më bërtet! Kam faj unë që nuk ia preva fare atë cironkën e keqe! Ç'm'u desh ta bëja synet? Më mirë t'ia kisha prerë dhe t'ia hante laraska atje në kumbull! Do ta thërres xherah Kasëm Kosturin dhe do t'ia pres! — thirri gjyshja.

Sa dëgjoi xherah Kasëm Kosturin, greku i vogël ia krisi të qarës, duke mbuluar fytyrën me duar në qoshe të odës. Ndërkohë kishte dëgjuar babai dhe erdhi nga hajatit pa e xhveshur pallton.

— Ç'keni që shaheni? — tha ai.

— Edhe më pyet? — tha gjyshja. — Ky grekushi ma vuri emrin plakë e keqe.

Pavli u hodh nga qoshja si tigër i vockël.

— Nuk i thashë «plakë e keqe». Gënjen! I thashë vetëm plakë. I thashë edhe se nuk e dua!

— Po si! Plakë! Ti e kishe në mend të më thoshe plakë e keqe! — tha gjyshja.

Babai për një çast nuk foli. Një herë shikonte gjyshen, një herë grekun e vogël.



— Hëm! Na duhet që të pajtohemi. Sherri nuk është punë e mirë — tha ai.

Gjyshja mori mashën dhe trazoi zjarrin. Në oxhak u ngritën në fillim shkëndijat, pastaj flaka.

— Eh, m'u dashka mua të pajtohem me këtë rabec-kë! Kam faj unë që ndez zjarrin! — tha ajo.

— E dëgjon, qirjes baba Rizai, si nuk ka qejf të pajtohet? — tha Pavli, duke treguar me gisht gjyshen.

— Hëm! — tha babai. — Ashtu bën ajo, por në të vërtetë i vjen mirë të pajtohet

Atëherë greku i vogël e vështroi si me drojtje dhe me frikë gjyshen dhe iu afrua ngadalë, duke shkëlur me këmbët e zbathura në minder. U ul në gjunjë dhe e përqafoi. Edhe ajo e përqafoi.

— Po ky grekushi, more Riza, di edhe të të hyjë në zemër! Jo, jo! Ky është nishan! — tha ajo dhe e qetësoi: — Mirë, mirë! Ngrohu tanë. Hoqa dorë, nuk e thërres xherah Kasëm Kosturin.

I vogli i mbante sytë përdhe dhe buzëqeshte lehtë-lehtë.

## 6

U rrokullisën ditët dhe muajt, u zëvendësuan vitet dhe erdhi një kohë që u mbushën malet me partizanë. Babai merrej me këshillin nacionalçlirimtar të fshatit dhe priste e përcillte partizanë. Ne me grekun e vogël rrinim me ta dhe mësonim këngë partizane. Pavli kishte një zë të bukur dhe i këndonte më mirë se unë.

— I ka ngjarë qirjes Thomait. Pa-pa! Ç'zë që kishte i shkreti qirjes Thoma! — thoshte babai kur e dëgjonte Pavlin duke kënduar.

— Eh! Qirjes Thomai përpara këtij s'ishte hiçgjë! Ky është bilbil i vërtetë! — thoshte gjyshja për Pavlin.

— Bilbil i vërtetë! — pohonte im atë.

— Që kur e bëmë synet, u bë bilbil! — thoshte gjyshja.

— E pse s'e ka Driti zërin e tij? E pse s'është si bilbil? Edhe ai është bërë synet! — thoshte babai, duke buzëqeshur nën mustaqet.

Ne me Pavlin dëgjonim dhe qeshnim, sikur të bënim garë njëri me tjetrin.



— E po ky, o Riza, është grek. Dhe grekun po e bëre synet i vjen zëri më mirë! — thoshte gjyshja, duke mbrojtur mendimin e saj.

— Ama llaf! — kundërshtonte babai.

Dhe tek kuvendonim për këngët dhe për zërin, një ditë vijnë dhe e thërresin babanë dy fshatarë me pushkë nga ata të njësitit partizan të fshatit. Babai mbathi me vrap këpucët dhe iku pas tyre.

— E po këtë Rizanë s'e lenë rehat! Një herë në mal me kumandarët, një herë në fshat për të marrë bukë e për ta dërguar në batalion, një herë për të mbledhur djem e për t'i shpënë me partizanët... U rraskapit i gjori!... Po mirë bën... Ja sa ta mundim këtë dushman gjerman. Theu qafën italianin. E mundëm e vate. Edhe gjermani do të bjerë në hundë... I varfëri Riza u dërmua!... S'e dimë se ç'bën qirjes Thomai. Edhe ai i zi si Rizai, bamb me italianin e bamb me gjermanin!... — tha gjyshja.

Pavli e dëgjonte dhe kënaqej që gjyshja e vinte qirjes Thomanë baraz me babanë.

— Të dy bamb me italianë e bamb me gjermanë! — tha Pavli me sy të ndritur, duke iu afruar gjyshes.

— Ashtu, xhan, ashtu! — tha gjyshja dhe ia vuri dorën në flokët.

Në këtë kohë vjen me vrap babai. Mezi merrte frymë dhe ishte i shqetësuar. Asnjëherë nuk e kishim parë kaq të turbulluar dhe të tronditur. Edhe gjyshja u hutua nga pamja e tij.

— Riza! — thirri ajo.

— S'ka gjë, s'ka gjë! — tha babai dhe e mori për dore Pavlin.

— Ku e shpie? — tha gjyshja.

— Këtu, këtu! Ka ardhur qirjes Thomai! — tha babai. — Kërkon ta shohë të birin.

— Po pse s'vjen në shtëpi qirjes Th... — tha gjyshja dhe s'arriti ta mbarojë fjalën, se babai i bëri shenjë, duke kafshuar buzën.

Gjyshja e kuptoi se kjo nuk ishte shenjë e mirë. Kurse Pavli u hodh përpjetë nga kjo e papritur.

— Do të vij edhe unë ta shoh qirjes Thomanë! — thashë dhe shkova pas tyre.

Në një dhomë të shkollës së fshatit mbi një minder të shtruar me një qilim të vjetër ne pamë një partizan të



mbështetur në jastëk, me gjoks të lidhur me një beze të madhe të bardhë me pulla gjaku. Ishte qirjes Thomai. I zbehtë dhe i lodhur, mezi rrinte shtrirë. Dy partizanë qëndronin pranë tij. Sa e pa Pavli iu hodh në qafë, duke qarë. Qirjes Thomai ngriti me zor dorën dhe e lëmoi në kokë e në fytyrë.

— Mos qaj, mos qaj, bir! — i tha ai në gjuhën e vet. Edhe babai, edhe unë qëndronim pikë e vrer.

Qirjes Thomai me të birin pranë, iu drejtua me vështirësi babait:

— Qirjes Riza! Evkaristo! E di që do të ma ruash djalin! Ti je burrë i mirë, qirjes Riza! Unë tani jam nisur andej... — dhe ngriti sytë në qiell.

— Ç'thua, qirjes Thomai! Ne do të të shërojmë! — tha babai.

— Ëhë! — bëri qirjes Thomai dhe tregoi me sy violinën atje në qoshe të dhomës. — Atë merre dhe ruaje. Jepja me vete Pavlit kur të rritet. Të tjerat i kam shkruar në një kartë në një kalamidhe në shami.

Ai pastaj e puthi të birin, e zuri lemëza dhe vdiq....

Pavli, i biri i qirjes Thomait, qante në gjoksin e madh të babait. Qaja edhe unë. Dy partizanët qëndronin më këmbë me kapele të hequra. Violina rrinte e mbyllur në kapakun e murrmë.

Të dy partizanët thanë se qirjes Thomanë e kishin gjetur të plagosur rëndë në përroin e kodrës sonë. Ai kishte luftuar në tokat greke pranë kufirit tonë, ishte plagosur dhe ishte zvarritur dy ditë për të ardhur këtu në fshat dhe për të parë të birin. Kur e gjetën në përrua, kishte humbur shumë gjak...

— Vetëm shpresa për të parë të birin e mbajti gjallë gjer këtu! — tha njëri nga partizanët.

## 7

Trupin e qirjes Thomait po atë ditë erdhën dhe e morën partizanët grekë. Ata shkruan edhe emrin e fshatit tonë, emrin e Pavlit dhe emrin e babait. Babai u ngarkoi një kalë me bukë; ata e përqaftuan Pavlin dhe ikën.

Pavli tani rrinte si jetim i vërtetë. Ne të gjithë e përkëdhelnim dhe nuk e linim kurrë vetëm. Im atë i bleu edhe një palë robe të reja, bile edhe këpucë. Gjyshja fli-



nte pranë tij dhe meje. Ajo nuk u nxeu pastaj kurrë me Pavlin. Por që ditën që vdiq qirjes Thomai, iu bë zakon që të dalë në dritare dhe të vajtojë ngadalë me ligje. Vajtonte më shumë për Pavlin.

— O i zi ç'të gjeti! — thoshte ajo.

Che Pavli i lutej që të mos qante:

— Mos, gjyshe, mos! Ja, kemi qirjes baba Rizanë!

— Ah, është luftë, more bir! Ja, zoti mos e dhëntë, të vritet edhe Rizai, ç'do të bësh ti? — tha gjyshja një gjë që nuk dëshironte ta shprehte, por i shpëtoi dhe pastaj u ra buzëve me dorë.

— Jo! Nuk vritet qirjes baba Rizai! — thirri greku i vogël.

Dhe filloi të qajë me dënësë dhe të përpjekë këmbët për tokë.

— M'u thaftë goja që ma nxori këtë llaf. Nuk vritet, bir, nuk vritet! — tha ajo me sy të përplotur.

— Ashtu! — tha greku i vogël. — Tani ta marr violinën e t'i bie?

— Merre, bir, merre të shkretën! — tha gjyshja.

Ai e hapi dhe filloi ta lëvizë harkun. Nxirre vetëm ca tinguj të shkëputur që nuk i shëmbëllenin këngës.

— Do ta mësoj atë «Malet me blerim mbuluar!» — tha ai.

— Mësoje, bir, mësoje! — tundi kokën gjyshja.

Në këtë kohë në oborr u dëgjuan këmbë kuajsh. Ne dolëm në dritare dhe pamë dy kuaj dhe një partizan me një xhaketë gjysmë të verdhë. Me partizanin ishte edhe babai.

— Është partizan grek! — tha gjyshja.

Pavli e la violinën dhe vrapoi bashkë me mua në oborr.

— Ky është? — pyeti partizani babanë, duke vështruar nga unë.

— Jo! — tha babai. — Ky është im bir. Ai tjetri është Pavli!

Partizani na përqafoi të dyve dhe pastaj i foli greqisht Pavlit. Pavli na vështroi mua dhe babanë si me keqardhje.

— Po urdhëro të hamë bukë, qirjes Kostas — i tha babai partizanit grek me emër.

— Jo, qirjes Rizai! Shpejtoj! Mund të vijnë papritur



gjermanët. Përgatite djalin, jepi ç't'i japësh dhe të ni-semi. Faleminderit! — tha qirjes Kostas.

Në sofat doli gjyshja.

— Ç'thotë ky djali, more Riza? — pyeti ajo.

— Erdhi ta marrë Pavlin! — tha babai me hidhërim.

— Ba! Si e marrka? Ne atë e kemi bërë edhe synet...

E ku do ta shpjerë? Të presë sa të mbarojë lufta! Ba! Mos i ndodhë ndonjë gjë e keqe djalit, m'u thaftë goja! — tha gjyshja.

Qirjes Kostas e pyeti babanë se ç'thoshte gjyshja. Kur babai ia shpjegoi, ai u përgjegj:

— Do ta marrim, mitera! Ju faleminderit. Pavli është rritur tani dhe do të vijë me partizanët!

Pavli i përpoqi shuplakat:

— Me partizanët! — thirri duke u hedhur.

— Edhe unë do të shkoj me partizanët! — thirra unë.

Qirjes Kostas dhe babai qeshën.

— Po si! Me partizanët! Dy rabecka me partizanët! — tha gjyshja.

Gjyshja dhe babai ia mblodhën plaçkat Pavlit në një bohçë. i vunë bukë e djathë dhe i futën në hejbetë e kalit. Pastaj të gjithë e përqaftuan dhe e puthëm. Ai i mbushi sytë me lot dhe filloi të qajë herë në gjoksin e babait, herë në gjoksin e gjyshes dhe herë në gjoksin tim. Partizani Kostas shikonte dhe bënte me gjuhë «cëk-cëk» dhe «kajmeno, more kajmeno».

Kur do të hipnin në kuaj, gjyshja thirri me violinë në dorë:

— Na, more djalë! Na, more, violinën e të shkretit qirjes Thomai!

— Ç'thotë? — pyeti qirjes Kostas.

— E harruat, thotë, violinën e qirjes Thomait! Kur vdiq këtu ia la Pavlit.

Partizani e mori violinën, e puthi dhe e futi në hejbetë e kalit, ku kishte hipur Pavli.

Dy kalorës dolën nga porta jonë e madhe. Njëri nga këta kalorës ishte Pavli, i biri i grekut qirjes Thomai. Dhe këtë kalorës unë nuk e pashë kurrë më.



# Pesha e turpit

— Baladë malesh —

1

KK

Hajrije Çeremi me shami të zezë deri mbi vetulla dhe me cigare të trashë në dorë rrinte pranë zjarrit e mërzi-tur. Dy cepat e shamisë së zezë i binin mbi supet e mëdhenj si majat e krahëve të një zogu mbi një shkëmb të murrmë. Ajo kishte shtatë ditë që nuk fliste me njeri, veçse rrinte pranë oxhakut me cigare në mes dy gishtërinjve të zverdhur nga nikotina dhe me filxhanin e kafes në vatrë. Nuk i besohej që djali më i dashur i saj, SHEME Çeremi, të kishte bërë një turp kaq të madh, turp që do të rëndonte tërë jetën mbi trarët e kësaj shtëpije. Nga që nuk i besohej, kishte dërguar njerëz në shtëpinë ku kishte ndenjtur çastet e fundit kapedan Tahsin Haxhihajdari, që të merrnin vesh një për një se ç'kishte ndodhur. Këta njerëz ende nuk po ktheheshin dhe ajo priste pa lëvizur nga oxhaku me një si lëmsh të mbledhur në gjoks.

Kapedan Tahsin Haxhihajdari kishte qenë mik i ngushtë me burrin e saj të vvarë nga serbët mbi Dragobi. Shumë herë ajo e kishte pritur dhe përcjellë, ia kishte tharë rrobot dhe ia kishte qepur këmbishën si vëllait të saj. Dhe kur një dimër u plagos me një plumb në gjoks, e mbajti gjashtë muaj në shëpi, pa marrë vesh njeri. Atë

ate baba ai  
jo dhe pa  
trëpikë

Nga kjo zëllje paske 121  
marrësit të xh. n. makonave  
je xh. n. ambpudt n. rreben



dimër kapedan Tahsin Haxhihajdari kishte luftuar mbi Dragobi vetëm për vetëm me një serb. Serbit tek luftonte i kishin mbaruar fishekët dhe e kishte hedhur pushkën.

— Tani më vrave, kapedan Tahsin Haxhihajdari! — kishte thirrë ai në mes dëborës pas një pische të vjetër.

— Nuk vras një njeri që i kanë mbaruar fishekët — i ishte përgjigjur kapedan Tahsin Haxhihajdari nga ana tjetër dhe i kishte hedhur mbi dëborë dy krehër me fishekë.

Serbi e kishte marrë pushkën e hedhur dhe dyluftimi kishte nisur përsëri. Në të shtënë e pestë të dy kishin rënë përnjëherësh mbi dëborë: serbi i vrarë, kapedan Tahsin Haxhihajdari i plagosur rëndë. Atëherë e kishte marrë Hajrije Çeremi me tre djemtë e saj dhe ia kishte shëruar plagën në shtëpi.

Dhe tani Hajrije Çeremi kishte dëgjuar gjëmën më të madhe. I biri i saj, Shemja, i futur nga hasmët, i kishte zënë pritë dhe e kishte vrarë kapedan Tahsinin tek zbriste për në Valbonë. Kjo ishte një vrasje e blerë, siç i thonë, prapa shkëmbenjve.

— Janë fjalë! S'është e vërtetë! — fliste me vete Hajrije Çeremi pranë zjarrit me kërcunjtë të trashë, duke pirë e vetmuar kafën e shtatë.

Dy njerëzit që kishte dërguar, erdhën kokëulur dhe ajo e kuptoi se fjala e hapur ishte e vërtetë.

— E vërtetë? — pyeti ajo.

Të dy të dërguarit tundën kokat në heshtje. Atëherë Hajrije Çeremi thirri njërin nga djemtë e saj, Selimin e gjatë si bredh, me qeleshe të bardhë si gjysmë molle të papjekur.

— Të shkosh e të gjesh Shemen. T'i thuash që jam sëmure unë. Të vini të dy... — urdhëroi ajo.

## 2

Pas tri ditëve Selimi e solli Shemen në shtëpi. Mjekra e parruar e tregonte të zbehtë dhe të dobët. Madje Hajrijes iu duk sikur i biri kishte filluar të kërrusej dhe të plakej para kohe.



— Qënke mirë! — tha ai, ndërsa e ëma i hodhi një vështrim të gjatë, të egër dhe të zyrtë.

— Selim! — i tha djalit tjetër. — Shko e thirr Elezin!

Mbetën të dy vetëm për vetëm. Hajrije Çeremi ulur me cigare në mes dy gishtërinjve, Shemja më këmbë, i parruar, i zbehtë dhe i lodhur. Për një çast asnjeri nuk fliste. Dëgjoheshin vetëm frymëmarrjet dhe kërcitjet e zjarrit në oxhak.

— Jam mirë, the? — e prishi heshtjen e ëma.

— Selimi tha se ishte sëmurë! — foli me vështirësi Shemja.

E ëma psherëtiu.

— Të hapësh dy varre dhe të jesh mirë? — tha ajo.

Shemja u ul në gjunjë sikur të donte të dëgjonte më shkoqur fjalët e s'ëmës.

— Dy varre? — tha ai.

— Një për kapedan Tahsin Haxhihajdarin, mikun e kësaj shtëpie dhe një për Sheme Çeremin, djalin e këtij oxhaku... — tha Hajrije Çeremi.

Në fytyrën e të birit u duk një buzëqeshje e shtrembër. Dontë të pyeste se ç'kuptim kishin fjalët e s'ëmës, por ndërkohë erdhën dy vëllezërit, Selimi dhe Elezi.

— Ngreu! — urdhëroi Hajrije Çeremi Shemen të ulur në gjunjë.

Të tre vëllezërit në këmbë, vështruan njëri-tjetrin. Selimi me Elezin mezi ia hidhnin sytë në fytyrën e zbehtë të Shemes, në fytyrën si prej të sëmuri.

— Pushkën Elez! — urdhëroi Hajrija.

Prapë nënë e bir mbetën vetëm. Në ballin e Shemes filluan të dalin bulëza djerse. E ëma këtë edhe pa e parë, e ndjente. Shemja do të djersijë, mendonte ajo. Që i vogël djersinte shumë.

— Eh, dy varre! Pa pritur e kujtuar, dy varre! — psherëtiu ajo.

— Ç'thua? — thirri ai dhe u ul përsëri në gjunjë.

— Ngreu! — urdhëroi e ëma.

Erdhën të dy djemtë me pushkë. Hajrije Çeremi ende rrinte pas oxhakat dhe pinte kafën e njëmbëdhjetë.

— Selim, dhe ti Elezi i vogël!... — foli ajo dhe për një çast heshti.

Gjithë dhoma dukej sikur ishte pa frymë. Të tre dje-



mtë druheshin të mbushnin kraharorët, si të kishin frikë se mos mbarohej ajri.

— Selim, dhe ti Elezi i vogël! E dini se vëllai juaj, Shemja, ka vrarë kapedan Tahsin Haxhihajdarin, mikun e shtëpisë dhe të babait tuaj.

Të dy vetëm sa tundën kokat në heshtje.

— Ne do ta vrasim Shemen!... — tha ajo.

Shemja u këput dhe ra në prehërin e të ëmës. Qeleshja i shkau nga koka dhe flokët e tij prekën mjekrën e nënës. Ajo ndjeu erën e tyre, erën më të mirë dhe u gëlltit, se një lëng i nxehtë iu ngjit gjer në gojë. Por nuk lëvizi nga vendi. Rrinte drejt me vështrim nga muri i bardhë me kokën e të birit në prehër.

— Selim, merre këtë! — i tha djalit tjetër dhe ai e ngriti të vëllanë.

Hajrie Çeremi vuri duart në gjunjë dhe u ngrit me zor. Shtati i saj i lartë e mbushi odën. Dy cepat e shamisë dukeshin si dy krahët e një zogu të zi të madh gati për fluturim. Shkoi dhe ia hodhi krahun e trashë Elezit, që ishte zbehur dhe që dridhej i tëri

— Je burrë, Elez! Burri nuk rritet lehtë! — tha ajo dhe u bëri me kokë të tre djemve të dilnin përjashta.

### 3

Buzë përroit, nja dyqind metra larg shtëpisë, Hajrije Çeremi u bëri shenjë djemve të qëndronin. Pastaj i tha Shemes të shkonte pranë lisit me gungë, që nxinte mbi dëborën e porsarënë. Dy djemtë e terë, Selimi dhe Elezi i vogël, qëndronin pranë saj me pushkë në dorë.

— Për gjakun e kapedan Tahsin Haxhihajdarit! — tha ajo dhe ngriti dorën drejt Shemes.

Selimi me Elezin vështruan njëri-tjetrin me grykat e pushkëve të ulura mbi dëborë. E ëma përsëriti:

— Për gjakun e kapedan Tahsin Haxhihajdarit!...

Ndër kohë i biri i saj, Elezi i vogël, papritur e hodhi pushkën dhe ajo u fundos në dëborë. Mbeti vetëm një gjurmë e gjatë pushke. Pastaj mbuloi me të duart fytyrën dhe ia dha vrapit drejt shtëpisë, duke lëshuar ulurima pa kuptim. Hajrije Çeremi për çudi nuk ktheu kokën



nga Elezi i vogël. Dukej sikur nuk kishte ndodhur asgjë, sikur të mos ishte fare një Elez. Ajo as djalit tjetër, Selimit nuk ia hodhi vështrimin. Vetëm thirri me dorë e sy nga Shemja:

— Për gjakun e...

Atëherë Selimi ngriti pushkën. Mori shenjë mbi të vëllanë, Shemen. Pastaj e uli dhe ktheu kokën nga e ëma pa asnjë fjalë. E ëma nuk lëvizi nga vendi. Të tre qëndronin në heshtje: nëna, Selimi, Shemja. Nga larg vinin ulurimat e Elezit të vogël. Sakaq Hajrije Çeremi hodhi një hap të gjatë mbi dëborë drejt Selimit. Pastaj shtriu dorën nga ai, duke i kërkuar pushkën. Selimi u drodh i tëri. Nofulla e tij e poshtme u shtrembërua dhe thirri:

— Joooo!

Kjo ishte një «jo» shpelle, nga ato që tremben lakuriqtë e natës, kur oshëtijnë në faqet e guvës. Dhe pas «jo»-së plot llahtarë Selimi i mori të gjitha vetë përsipër. Nuk donte t'ia linte barrën e rëndë nënës. E ngriti pushkën. Shënoi dhe u drodh kur i vëllai ra më kurriz mbi dëborë. Nga dora e madhe i shpëtoi pushka dhe i ra mbi dëborë, edhe ajo e vrrarë. «U vra» — tha ai me vete. Dhe as vetë nuk e kuptoi se kush u vra, i vëllai apo pushka. Mandej ktheu krahët dhe iku duke u lëkundur mbi këmbët e gjata.

Hajrije Çeremi vazhdonte të qëndronte me vështrim nga Shemja i shtrirë në mes të dëborës. Pastaj ajo u ul mbi dëborën e butë fillikate. Zuri të dy faqet me duar dhe e përhumbur i hodhi sytë nga i biri i shtrirë. Era fërshëllente dhe ia ngrinte dy cepat e shamisë së zezë. Mbi fytyrën e verdhë të të birit përhapej hiri i dëborës.



LONA

# Kamarja

1

Abdurahman Arbana, portieri ynë, rri në kabinën me një kamare të vogël, pi duhan dhe mendon. Nuk e di njeri se ç'mendon! Ne të gjithë nuk e dimë se ç'mendon... Unë vetëm ja marr me mend mendimet e tij, pasi në një bisedë të shkurtër para kamares së kabinës së tij, më foli për diçka larg e larg.

— Jo, unë jam njeri i thjeshtë. Ju dini më shumë se unë, po dua të them që... Domethënë po vë re ca gjëra që nuk shkojnë... — dhe e futi kokën përsëri në kabinë, duke ndezur një cigare tjetër.

— Çfarë nuk shkon, Abdurahman? — pyeta unë.

— Jo, që të kam llafin, se ju dini më shumë se unë... — tha Abdurahmani dhe e shkundi hirin e duhanit në tavllën e mbushur me bishta cigaresh.

Ai e kishte ulur kokën dhe shikonte diku në këmbët që nuk i dukeshin. E shihja që diçka e mundonte, por nuk e thoshte. Ju afrova kabinës dhe i thashë të dilte, të merrte pak ajër të pastër. Doli ngadalë dhe qëndroi krah meje në prakun e portës së madhe të institucionit tonë. Në këtë kohë hynë dy nga vajzat e reja që punonin te ne. Ato ishin të gëzuara dhe qeshnin me njëra-tjetrën. Fustanet e shkurtëra u vinin gjer mbi gju. Abdurahmani i pa me bisht të syrit, pastaj u buzëqeshi, duke i përshëndetur dhe m'u kthye përsëri.



— Jo, ju dini më shumë se unë, po i pe ato që hynë?

— I pashë! — u përgjegja.

— I pe, domethënë... — tha ai dhe psherëtiu.

Në rrugë kaloi një grup vajzash e djemsh studentë të fakultetit të shkencave të natyrës. Ata ecnin lirshëm, flisnin me zë të lartë dhe e shponin njëri-tjetrin me bërryl për t'ua tërhequr vëmendjen në bisedë.

— Edhe këto... Një lloj si ato të dyja! — tha Abdurahmani.

— E çfarë, Abdurahman? — pyeta unë.

— Ju, xhanëm, dini më shumë se unë.

Në këtë kohë kaloi Vangjushi, një djalë i ri, i gjatë dhe i pashëm. Ai kishte një vit që punonte në institucionin tonë. Ishte njeri i shkathët dhe tepër serioz në punën e vet. Vangjushi më përshëndeti mua, pastaj Abdurahmanin.

— Lodhesh, Abdurahman? — tha ai.

— Pak, Vangjush, pak — tha Abdurahmani me një buzëqeshje të ngrirë në fytyrë e me mollëzat e faqeve të kuqe. Vërtet portieri ynë gjithnjë mollëzat e faqeve i ka të kuqe.

Abdurahmani u fut në kabinën e tij, e vendosi mirë jastëkun e hollë në karrige dhe u ul. Unë kalova pranë kabinës së tij dhe ngjita shkallët. Pas dëgjova një murmuritje të lehtë dhe fjalë të pakuptueshme që delnin nga kamarja e vogël e portierit.

U ula në tryezë dhe mendja më shkoi te Abdurahmani. «Ndofta, thashë me vete, ai mendon për gjëra që ne s'na shkojnë ndër mend për njerëzit e për sjelljen e tyre. Dreq, o Abdurahman! Dhe unë qesha me vete.

Një ditë tjetër, tek zbrisja nga shkallët, pashë të qëndronin para kabinës së portierit dy djem të veshur mirë. Abdurahmani kishte në dorë receptorin e telefonit dhe sigurisht bisedonte me ndonjë nga nëpunësit e institucionit tonë, te i cili vinin ata dy djemtë.

— Të vijnë, shoku Vangjush? — pyeti ai po me atë buzëqeshje të ngrirë e po me ato mollëza të skuqura.

Djemtë filluan të ngjitnin shkallët, ndërsa portieri tundte kokën e fliste me vete.

— E di unë, e di! Tani, si të duan!..

Unë kisha qëndruar në fund të shkallëve dhe shiko-



ishte shënuar: «Informacion» Pastaj: «Drejtorisë së Institucionit N. Për njoftim organizatës bazë të partisë dhe Komitetit të Partisë». Pastaj: Unë, i nënshkruari Abdurahman Arbana, portier i institucionit N. nën përgjegjësinë time personale, njoftoj si më poshtë vijon: Unë kam dhjetë vjet që punoj në këtë institucion. Detyrën e kam kryer me nder. Edhe të meta kam pësuar, por me ndihmën e kolektivit i kam zhdukur. Si njeri i thjeshtë unë kam vënë re kohët e fundit se në institucionin tonë ka gjëra që nuk venë, ka imoralitet, më falni për këtë fjalë. Në këtë drejtim ka imoralitet. Te vajzat të quajtura Shega dhe Elvira, nëpunëse në institucionin në fjalë, vijnë dy djem. Kodosh, më falni edhe për këtë fjalë, është bërë Vangjush Cilja. Këta dy djemtë vijnë e kërkojnë Vangjushin, futen brenda me anën e tij dhe takohen me Shegën dhe Elvirën. Kjo nuk i ka hije moralit tonë. I kam parë njëherë këta dy djem dhe kanë qeshur në shkallë me Shegën dhe Elvirën. Kjo përsëri nuk është e hijshme. Mund të zbardhësh dhëmbët në një institucion shtetëror? Në këtë drejtim nuk mund të zbardhësh dhëmbët! Edhe një sinjalizim tjetër. Vajzat të quajtura Shega dhe Elvira, kanë një veshje e mbathje të modës borgjeze. Fustanet i kanë dy gisht mbi gju, takat e sandaleve i kanë të trasha dhe të larta me lloj-lloj ngjyrash. Mbajnë rrypa e ku ta di unë, si të borgjezisë. Edhe në drejtim të flokëve kanë mbeturina borgjeze. Njërin sy e fshehin me flokët që i lëshojnë në gjysmën e fytyrës, si ato gratë që kemi parë në filma. Me sa jam informuar unë, njëra nga ato ka televizor dhe nga ky televizor kanë mësuar shumë gjëra të këqija, domethënë borgjeze. Në këtë drejtim mendoj të merren në shqyrtim nga ajo drejtori. Me nderime, Abdurahman Arbana».

E lexova lerën, e mbylla dhe e hodha në qoshe të tryezës. Çupa ime qeshte në gjumë. Unë ndeza një cigare e fillova të mendoja për Abdurahmanin, për «informacionin» e tij, për gjykimet e tij. Dhe papritur psherëtiva.

### 3

Abdurahman Arbana është mbështetur në tryezën e vogël të kabinës së tij, ka vënë dorën në faqe e mendon.



Para meje kalojnë dy vajzat, Shega dhe Elvira. Ato ngjithin shpejt shkallët dhe fustanet e tyre lëviznin si dy krahe fluturë. Ai shikon vajzat i menduar dhe nuk më vë re mua. Kur më vë re, e heq dorën nga faqja dhe zgjat kokën nga kamarja e kabinës. Në xhepin tim rëndon «informacioni».

— E ma korrigjuat? Tani ju i dini këto punë, unë jam njeri i thjeshtë! — thotë ai i drojtur.

Unë e vështrova dhe nuk fola për një çast.

— Apo nuk e kam shkruar mirë? — pyeti ai dhe del nga kabina.

Qëndroj para tij i heshtur. Përtoj të flas. E fut dorën në xhep dhe ja jap shkrimin. Ai e merr dhe e hap. Nuk shikon asnjë ndryshim.

— Ti nuk e paske korrigjuar! — psherëtin Abdurahmani.

— Nuk e kam korrigjuar, Abdurahman! — i them.

— E kam shkruar mirë, domethënë — buzëqesh ai duke vërtitur letrat në duar.

Mollëzat e kuqe të faqeve të tij fillojnë të formojnë nga një rreth të zbehtë. Një zbehtësi e tillë përhapet edhe në të dy anët e hundës, mbi buzën e sipërme. Sytë e vegjël shkëlqejnë dhe bëhen të rrumbullakët si dy kapsa.

Unë vazhdoj të qëndroj i heshtur me vështrim nga kamarja, ku duket koka e Abdurahmanit. Për një çast nuk e dalloj kokën e tij. Ajo shkrihet në sfondin e murit gri, i heq sytë nga kamarja, kthej krahët dhe matem të ngjit shkallët. Abdurahmani diç murmurit si zakonisht. Unë shpejtoj hapin. Në shkallën e tretë ndjej se dikush më tërheq për mënge.

— Unë mund ta dorëzoj edhe të pakorrigjuar, por thashë se do të ishte më mirë sikur të ma ndreqnit.

Ktheva kokën nga ai. Qëndronte një shkallë më poshtë se unë me letra në dorë. Për herë të parë vura re se maja e kokës së tij nuk kish flokë. Ç'është e vërteta, kish flokë, por i kish të imta, si push. Ai ngriti sytë e vegjël nga unë e buzëqeshi me një drojtje të madhe. Përsëri, për herë të parë unë vura re se sytë e tij ishin pakëz të kuq dhe bebet të kaltërta, ose më mirë me një ngjyrë të papërcaktuar.

— Nuk më the, e kam shkruar mirë? — pyeti ai për me atë buzëqeshje.



Unë nuk fola. E pashë me një vështrim tërë mërzi e bezdi. Ai e kuptoi dhe dora që mbante letrën u drodh. Për ta fshehur këtë dridhmë, e futi letrën në xhep dhe nuk e nxori andej dorën.

— E sheh? E dija që duhej korrigjuar, prandaj ta dhashë, — tha ai.

— Nuk korrigohet, Abdurahman! — thashë unë dhe i dhashë të kuptonte se nuk kisha më dëshirë të rrija bashkë me atë në shkallë.

Atëhere ai heshti. Unë dëgjova se si kërciste në xhepin e tij letra e shkruar. Ai e trazonte me dorë. Nuk e dëgjoja dot këtë kërcitje letre.

Hodha një hap dhe fillova të ngjitja shkallët, që i kisha lënë përgjysmë.

Kisha arritur në krye të shkallëve, kur ndjeva përsëri një prekje të lehtë në bërryl. Ai prekte vetëm me majat e dy gishtërinjve të dorës, prekte ngadalë-ngadalë. Përsëri nuk më ndahej! Kjo i shembëllente një ëndërre: ikën e nuk shkëputesh prej dikujt.

— Për të mirën e shtetit e bëra... Ju dini më shumë se unë. Jam njeri i thjeshtë e pa shkollë... Por janë ca gjëra që... — tha ai me kokë të hedhur prapa qafës ngaqë unë qëndroja dy shkallë më sipër prej tij.

— Shko, Abdurahman! — thashë unë dhe vazhdova të ecja.

Ai zbriti ngadalë shkallët dhe hyri përsëri në kabinën e tij. Diçka fliste me vete...

1972



# Martesa e papritur e Pasho Velçanit

— Shënimet e një bashkëkohësi —

## 1

Martesa e papritur e Pasho Velçanit me të bijën e Qenam bej Ormanit bëri bujë të padëgjuar jo vetëm në fshatin e tij, por në gjithë Gorën dhe Mokrën të marra së bashku, se ishte njeri tepër i njohur, i ardhur nga një shtëpi me nam të madh. Të shumtë ishin ata që u çuditën me këtë martesë dhe të panumërt ata që u zemëruan dhe i kthyen krahët njeriut të dashur të tyre. Edhe kapedan Kadri Gurra që kishte qenë miku më i ngushtë i babait të tij dhe që bashkë kishin dalë kaçakë malit para dhe pas Luftës së Parë Botërore, ishte bërë vrer kur kishte dëgjuar dhe ishte betuar që nuk do të shkelte kurrë në shtëpinë e Pashos gjersa të merrte frymë. Kapedan Kadri Gurra në moshën shtatëdhjetëvjeçare kishte qenë edhe vetë partizan me Pasho Velçanin dhe gjithmonë nëpër male e pati kujtuar të atin e tij Banushin, i ndritë shpirti atje në varre ku bën gjumin e përjetshëm. Ia kujtonte Pashos të atin se pati qenë trim i marrë dhe nuk e pati vënë fare në kandar vdekjen. — E mbuloftë turpi Pasho zullapin! I



rëndoftë turpi mbi jorgan natë për natë sa herë të bjerë të flerë me atë bushtrën që i vuri në gisht unazën! — kishte thënë dhe kishte ndukur me dorën e vet tri herë bishtin e mustaqeve të mëdha, që janë shenja e paprekshme e burrave si kapedan Kadri Gurra.

Edhe të gjithë ata burra të tjerë të Gorës dhe të Mokrës, që kishin hyrë dhe që kishin dalë në shtëpinë e Pasho Velçanit dhe që e kishin pritur ditën dhe natën në vatrat e tyre me raki e me këngë gjer në mëngjes, e kishin nëmur për këtë martesë dhe në të njëjtën kohë ishin pikëlluar që kishin humbur një mik me vlera të paçmuara.

— Ç'thotë kapedan Kadri Gurra? — pyesnin shokushokun kur takoheshin në ndonjë gosti apo në ndonjë kafe të qytetit.

— «I rëndoftë turpi mbi jorgan, thotë» — përgjigjeshin ata që pyeteshin.

Dhe kur merrnin vesh se kapedan Kadri Gurra kishte ndukur tri herë mustaqet e veta, bënin «u u uh!» nga habia e madhe.

Ata e dinin se kapedan Kadri Gurra e donte pa masë Pasho Velçanin, por jō kaq sa të ndukë me dorën e vet mustaqet e veta tri herë me të marrë vesh marrëzinë e pashembullt të Pashos. E, Kadri Gurra? Në vitet 1942 dhe 1943, kur fshatin N. dhe katër të tjerë rreth tij për pak sa i shturi në dorë Qenam bej Ormani, që kishte qenë dikur patriot dhe kishte mbajtur krahun e Fan Nolit dhe më vonë ishte hedhur me Ballin Kombëtar, Pasho Velçani, megjithëse ishte farefis me bejlerët dhe kishte pasur plëng e pasuri, mbajti anën e Kadri Gurrës dhe doli bashkë me të partizan, siç kishte bërë i ati në kohën e kaçakëve. Atëhere fshati N. dhe të katër të tjerët, që bëheshin pesë, shkuan pas të dy burrave më të zgjedhur të nahijes, duke e lënë Qenam bej Ormanë me ca krunde që s'i hanin as pulat. Këtë nuk e harronte plaku i moçëm, kapedan Kadri Gurra dhe thoshte për Pashon fjalët e urta që i dimë të gjithë «ku ka rrjedhur do pikojë», se kujtonte të atin e tij, Banush Velçanin, mikun e vjetër që kishin ndarë bashkë jorganin mal më mal, kur ishin komitë. Por tani Pasho Velçani, që është turp ta mbajë këtë mbiemër të nderuar, iu ra me shkelm të gjithave, duke bërë një krushqi nga më të ligat me martesën e tij fazezezë.

— Ç'thotë kapedan Kadri Gurra? — nuk pushonin



së pyeturi njerëzit që ia kshin dashur Pashos të mirën, por merrnin të njejtën përgjigje:

— «I rëndoftë turpi mbi jorgan, thotë».

— Po nuk ka bërë ndonjë hata? — pyesnin dhe kërkonin të dinin hollësisë.

— Edhe tri herë të tjera ka ndukur mustaqet! — përgjigjeshin ata që dinin hollësisë.

— U u uh!... — bënëin ata që dëgjonin.

Dhe prisnin që kapedan Kadri Gurra të bënte hatanë, pasi e dinin se ç'kokë kishte, megjithatë hataja në pushtetin e ri popullor ishte vështirë që të ndodhte. Megjithatë, hatanë e prisnin. Dhe vërtet diçka afër hatasë ndodhi.

Në një mëngjes me dëborë të shtruar dhe të butë, kapedan Kadri Gurra, pasi kishte pirë kafën e parë dhe kishte dredhur nga kutia prej argjendi cigaren e tretë, urdhëroi t'ia vinin shalën e kalit të tij të murrme këmbë-hollë si dre, se kishte në mend të nisej për udhë. Të pesë djemtë e tij, tanimë burra të pjekur, dhe të pesë nusët e kishin lutur ta linte për më vonë këtë udhëtim, por ai nuk donte as t'i dëgjonte këto fjalë.

Kapedan Kadri Gurra, që tani ishte plot shtatëdhjetë e pesë vjet, mbathi çizmet angleze ngjyrë kafeje të papjekur, vuri koburen e madhe në brez, veshi brucën e zezë dhe e hipi kalin e murrme që në oborrin e gjerë të shtëpisë së shtruar me dëborë.

— Të vij edhe unë me ty! — tha më i madhi i djemve.

— S'dua asnjeri! Të më shohë pizevengu i pizevenges, se nuk e shaj dot Banushin! Prandaj nuk i them «i pizevengut»! — shau kapedan Kadri Gurra shaluar kalin dhe doli nga porta si kalorës madhështor me mustaqet gjer te veshi.

Të pesë djemtë dhe të pesë nusët me të shoqen e tij, Havanë, një plakë e gjatë me shami të zezë në kokë e me çorape me lesh ngjyrë hiri kishin dalë në oborr dhe e shikonin tek tundej në kalë.

— O pika! — tha Havaja — kur ta çajë e ta bëjë koritë ndonjë ujë dhe pastaj të na turpërojë të gjithëve! O pika gërxhos!

Tri nga nusët më të reja qeshën, ndërsa djali i madh vuri gishtin në buzë dhe bëri:

— Shisht!



— Shsht! — bëri edhe nusja e madhe.

Kadri Gurra nuk donte ta ngiste kalin përmes fshatit, se nuk kishte dëshirë të binte në sy të njerëzve. Prandaj bëri një hark të madh rreth shtëpive buzë fshatit në këmbë të korijes me dushk të mbuluar me dëborë, kaloi në breg të përroit dhe mori përpjetë tij. Rruga ishte ende e pashkelur, veç tek-tuk dukeshin gjurmët e vogla të ndonjë lepuri dhe nga dëllinjat fluturonin mëllinjat, të trembura nga thundrat e kalit, që mezi dëgjoheshin. Dëborë nuk ishte shumë e lartë, vinte gjer në gjunjët e kalit dhe rrallë gjer në bark të tij. Në ato shtigje ku kishte fryrë erë dëborë e mbledhur arrinte gjer në dy bojë njeriu. Andej ishte vështirë të kalohej, por kapedan Kadri Gurra i dinte mirë këto vende dhe e ngjiste kalin ku dëborë nuk ishte e lartë.

Kalorësi e ndjente veten të lehtë dhe të gjallë, aq sa kishte dëshirë të këndonte mbi shalë të kalit. Por ai nuk këndoi, veçse u mjaftua me një të vërshëllyer. Kjo vërshëllimë në të vërtetë ishte një këngë e vjetër që kapedani e këndonte në rininë e tij bashkë me Banush Velçanin:

Bishtin e urës, ma kanë zënë  
Nja dy djem, nja dy çapkënë.

Edhe këtej, mes këtyre korijeve të mbuluara me dëborë nga fluturojnë mëllinjat e zeza kushedi sa herë është kënduar kjo këngë. Madje një herë e kanë kënduar edhe me Qenam bej Ormanë, kur ktheheshin nga Përmeti hipur në kuaj. Ishin katër vetë: kapedan Kadri Gurra, Banush Velçani, Qenam bej Ormani dhe Ballkizi. Po, Ballkizi, vajza që mori atëhere për grua Qenam bej Ormani. Kjo ishte një jevgjitkë e bukur nga Përmeti me shtat të lartë sa të Qenam bej Ormanit, me flokë të zez e të drejtë, me një nishan të zi në ballë dhe me buzë të trëndafilta. Për këtë jevgjitkë, që mori për grua, Qenam bej Ormani u zu me të gjithë bejlerët dhe pasanikët e krahinës, se iu turpëroi emrin dhe fisin, u zu me të vëllezërit dhe me hanko Zengjinenë, të ëmën e tij të rreptë. Asnjëri nuk donte të shkante krushk në Përmet për të marrë nusen dhe Qenam bej Ormani e hipi dorinë, mori edhe një kalë tjetër me vete dhe u nis filli vetëm. Rrugës për në Përmet



ai e ndali kalin në oborrin e kapedan Kadri Gurrës. Atje gjeti edhe Banush Velçanin dhe nja dy-tre burra të tjerë. Iu tha se për ku ishte nisur dhe iu lut të dyve që të vinin bashkë në Përmet, si krushq, për të marrë nusen. Kapedan Kadri Gurra dhe Banush Velçani, të dy të rinj e trima, ngjeshën armët, shaluan kuajt dhe u nisën me Qenam bej Ormanë. Atyre u pëlqeu që Qenam beut iu mbush mendja të merrte për grua një jevgjitkë dhe nga shkaku i saj të prishej me gjithë bejlerët. Ai me siguri tani do të forconte më shumë lidhjet me ta dhe me kaçakët.

Që në hyrje të Përmetit, poshtë Gurit të qytetit, që ngrihet si kala, kishin dalë për t'i pritur të gjithë jevgjitët, me kuçe e me maçe, duke kënduar e duke luajtur me gërneta e me dajre. Të tre kalorësit me kuaj që turfullonin shkonin të ndjekur pas nga jevgjitët dhe jevgjitkat dhe këngët e gërnetaat dëgjoheshin gjer në majën e Dhëmbelit të përvëlur nga dielli i korrikut. Banush Velçani e mbante kokën ulur nga turpi, që ndodhej mes jevgjitëve, kurse kapedan Kadri Gurra rrinte mbi shalë krenar me një buzëqeshje të lehtë, me vështrim nga Dhëmbeli. Kali i tij ecte krah kalit të Qenam bej Ormanit, pas u vinin pesë jevgjitë të gjatë me gërneta, që ngriheshin dhe uleshin, që vërtitnin tytat në erë dhe përhapnin tingujt e këngëve të dasmës.

— «Ç'bëhet kështu?» — kishte thënë Veli bej Përmeti, duke dalë në sofat të shtëpive me oxhak të bardhë.

— «Ka ardhur Qenam bej Ormani të marrë jevgjitkën e tij!» — i ishin përgjigjur gratë.

— «Faqeziu!» — ishte përgjigjur Veli bej Përmeti dhe kishte hyrë në odën e beharit, duke mbyllur të gjitha dritaret, që mos të dëgjonte këngët e jevgjitëve që përcillnin turpin e hatashëm të Qenam bej Ormanit, të cilin e kishte njohur para 1920-s dhe ishte zënë me të nga që kishte mbajtur anën e Fan Nolit.

Oborri i shtëpisë së Ballkizit ishte mbushur plot. Kishin ardhur bashkë me jevgjitët edhe njerëz të tjerë nga të gjitha mëhallat e qytetit dhe zjenin këngët dhe vallet. Ballkizi nusëronte në sofat me duvak të bardhë, e bukur nga më të bukurat. Kapedan Kadri Gurra dhe Banush Velçani me ta parë u mahnitën nga bukuria e saj dhe vështruan njëri-tjetrin:



— «Pu-pu! Ç'femër!»— kishin thënë ata të dy për-  
njëherësh dhe ia kishin marrë këngës sipas zakonit:

Ftujkëzë bardha me zile,  
Rrugës së malit kur vije  
Të dy cickat m'i dërsije!  
Ftujkëzë bardha në kreshta,  
Më gënjeve me gënjeshtër,  
Thoshe, dal të vijë vjeshta!..

Kjo duhej që të tundej gjithë qyteti! Asnjë nuk për-  
mbahej! Këngët u ngritën në kupë të qiellit. S'ishte asgjë  
Vjosa para valëve të rakisë! Pa le pastaj kur ia mori Qe-  
nam bej Ormani me atë zërin e tij të lartë, që dridhej ga-  
ti më të këputur, që ulej gati sa mezi dëgjohej dhe që  
ngrihej gati për t'u këputur përsëri me ca «hajde, hajde!»  
dhe me ca «oji, oji!» të padëgjjuara ndonjëherë, që edhe  
kapedan Kadri Gurra, këngëtari më me nam dhe trimi më  
i marrë i Gorës dhe Mokrës, mezi ia kthente:

Hapi sytë e zez  
Të na sjellç beharë,  
Sa të dua unë  
Si nëna evlanë!  
Hajde, hajde e e!  
Me doçkat e bardha  
Po më bën kulaçe,  
T'i kam për të ngrënë  
Me gushë e me faqe!  
Oji, oji i i!..

Nëse me këngën e kapedan Kadri Gurrës u tund qy-  
teti, me atë të Qenam bej Ormanit u trondit edhe Dhëm-  
beli, aq sa Veli bej Përmeti nuk i mbajti dot të mbyllura  
dritaret në odën e beharit. I hapi, zgjati gjithë trupin dhe  
papritur thirri:

— «Tundeni, more tundeni!»

Gratë u habitën, kur e panë dhe e dëgjuan dhe ai nga  
turpi iku nga dritarja, mbylli kanatën dhe kërkoi shishen  
e rakisë që të dehej dhe të mos merrte vesh se ç'bëhej.

Kështu, të tre: kapedan Kadri Gurra, Banush Velça-  
ni dhe Qenam bej Ormani, mes këngëve, zërave dhe të



thirrurave të jevgjitëve, e vunë nusen në kalin që kishin marrë me vete të zbukuruar me shalë, me fre me bufka të kuqe e të gjelbra dhe me yzengji me mamuze, dhe u nisën nëpër rrugë. Gjithë jevgjitët i përcollën përtej Gurrit të qytetit.

Pas dy ditë udhëtimi ata arritën në fshat në mbrëmje. Dritaret e shtëpive të mëdha të Qenam bej Ormanit ndritnin si në dasmë, por nuk dëgjoheshin as këngë dhe as kuvendime. I pritën nja dy-tre djem fshati, ua zunë për freri kuajt dhe i futën në oborr. Qenam bej Ormani e zbriti vetë nusen nga kali, e zuri për dore dhe e shpuri në odën e mirë. Pas vinin kapedan Kadri Gurra dhe Banush Velçani. Në odë në fillim erdhën nja pesë gra dhe e rrethuan nusen. Ato donin të këndonin, por me ta parë nusen nga afër shtangën nga bukuria e saj dhe mbyllën gojën. Të pesta filluan të teshtinin, se para një bukurie të papritur dhe të mahnitshme, kjo gjë ndodh dhe është e njohur nga të gjithë. Njëra nga gratë u shkëput nga shoqet dhe doli. Nuk zgjati shumë kur e gjithë oda e madhe u mbush me gra për ta parë nusen e ardhur nga Përmeti.

Këto kujtonte kapedan Kadri Gurra, duke ecur me kalë nëpër dëborë. Kujtimet e tij i ndërpreu një zhurmë guri që u rrëkëllye dhe ra para këmbëve të kalit nga një shkëmb i madh. Kali i futi këmbët e përparme në dëborë, hingëlliu dhe ndali.

— Ç'është kjo shenjë e ligë? — mendoi kapedan Kadri Gurra.

Dhe para tij nxiu mes dëborës trupi i një kafshe. Ish-te një ujk. Kapedan Kadri Gurra nxori koburen dhe qëlloi tri herë. Ujku uluriu, u hodh tri herë në dëborë dhe u shtri. Kadri Gurra e zbriti kalin dhe me kobure në dorë iu afrua ujkut të shtrirë mes gjakut në dëborën e skuqur. Dhe u habit. Ujku ishte me tri këmbë. Këmbe e katërt ishte e prerë gjer në gju. Kapedani e kuptoi. Kafsha e kishte ngrënë vetë këmbën. Kishte rënë në lak, ishte munduar të shpëtonte dhe si nuk kishte mundur, e kishte këputur këmbën me dhëmbë dhe kishte ikur, duke e lënë një pjesë të saj në guackën prej hekuri.

— Breh! — bëri kapedan Kadri Gurra dhe u vrenjt para ujkut të shtrirë.



Kapedan Kadri Gurra u ngjyt në malin që dukej si samar kali dhe e ndjeu veten të lodhur. E zbriti kalin dhe u ul pranë një lisi me gungë të gjelbër nga myshku. E mbështeti kurrizin në gungë, nxori kutinë dhe drodhi një cigare. Pas ndjente gungën e lisit.

— Të dy jemi të vjetër, ore i shkretë! Të dy kurriz për kurrizi! — i tha lisit dhe psherëtiu.

Poshtë këmbëve të tij malet vinin valë-valë. Në krah të një vale ngrihej Guri i Kamjes, i lartë dhe pak i shtrembër, me majë të murrme pa dëborë, se e lëpinin erërat. Kapedan Kadri Gurra psherëtiu përsëri.

— Guri i Kamjes, Guri i Kamjes!

Në fundin e një dimri, kur dëbora kishte filluar të shkrinte, të dy me Pasho Velçanin ata ecnin për të arrihur batalionin e tyre partizan. Rrugës gjejnë nja dyzet njerëz që ecnin herë grumbull dhe herë një nga një të shkëputur nga shoku-shoku. Ishin partizanë. Kapedan Kadri Gurrës nuk i pëlqyen. I hipi gjaku në kokë dhe iu thirri, duke nxjerrë nga brezi koburen:

— «Ç'jeni ju dhe ku vini?»

Dy-tre nga ta u përgjigjën ftohtë:

— «Partizanë jemi!»

— «Bashibozukë! — thirri egër kapedani. — Kush është komandanti juaj?»

Njëri u hodh nga shkëmbi mbi dëborë dhe thirri:

— «Nuk kemi komandant! Ne jemi shkëputur nga batalioni.

Kapedan Kadri Gurra e futi koburen në brez:

— «Mblidhuni këtu të gjithë. Jam kapedan Kadri Gurra! Do të më bindeni vetëm mua! Unë jam komandanti juaj! Hajde, njeri pas tjetrit. Kurse ju të pestë atje do të jeni pararoja. Si e ke emrin ti? Mirë, Kristo. Ti je komandanti i pararojës. Të tjerët pas meje!

— «Me pararojën do të shkoj edhe unë!» — thirri Pasho Velçani.

Kapedan Kadri Gurra e pa me një vështrim nën vetullat e trasha. U mendua pak dhe tha:

— «Mirë! Ti do të jesh nënkomandant i pararojës!»



Pararoja u nis. Kapedan Kadri Gurra iu drejtua partizanëve:

— «I keni mendtë në kokë, apo s'i keni? Hiç s'keni mend! Bashibozukë! Shkoni si në dasmë! Dy gjermanë t'ju dalin përpara, ju grijnë! Ju bëjnë pastërma! Si e ke emrin ti? Alush? Mirë, Alush, Ti je nënkomandanti. Hajde këtu!» — e thirri kapedani atë që e kishte emrin Alush.

Alushi ishte një partizan me një tallagane të murrme, i parruar, me buzë pak të shtrembëra nga njëra anë. Ai e vështronte këtë plak të rreptë i hutuar me buzë përgjysmë të hapura.

— «Ç'më shikon ashtu? Mbylli buzët!» — thirri kapedan Kadri Gurra dhe ai i turpëruar i mbylli buzët e shtrembëra.

Ende nuk kishin arritur te Guri i Kamjes, kur u dëgjuan në fillim pesë të shtëna pushkësh, pastaj edhe të tjera. Pas të shtënave buçiti si në pus plasja e një bombe dore. Kapedan Kadri Gurra e kuptoi që ishte bomba e Pasho Velçanit. Gjithmonë në luftime ai hidhte nga një bombë-dore ose granatën se i kishte qejf dhe luante mënc pas tyre. Nga që i donte bombat, ai i mblidhte mbushte torbën, mbante sa mbante për vete dhe të tjerat i fshihte për t'i patur në ditë të vështira. Mbase në shumë pika të krahinës nga lëvizte batalioni, do të gjeje bomba të fshehura nga Pasho Velçani.

Të shtënat e pushkëve dhe plasja e bombës mezi dëgjoheshin. Kishin një tingull të mbytur, por ato nuk vinin që nga larg.

Partizanët vështruan njëri-tjetrin të shastisur. I qetë, kapedan Kadri Gurra, qëndroi më këmbë gjer në gju në dëborë, vështroi rreth e rrotull shkëmbenjtë mes dushqeve, pastaj Gurin e Kamjes dhe tha:

— «Pararoja është përpjekur me gjermanët dhe baillistët e Qenam bej Ormanit! Unë do të ze vend atje nën atë shkëmb. Do të jem në mes tuaj. Ti Alush, matanë rrugës, mes përroit. Dhjetë këtej nga unë dhe dhjetë nga Alushi. Dhjetë të tjerët atje përpara, edhe ju nga të dy anët e rrugës! Ne do të presim! Pararoja do të na thotë se ç'ka ndodhur!»

Të gjithë zunë vendet pas shkëmbenjve mes dëborës lara-lara dhe prisnin. Herë pas here dëgjoheshin të shtë-



na të shkëputura, të shtëna të mbytura se nuk i linte dëbora të kumbonin. Kapedan Kadri Gurra rrinte prapa shkëmbit i murrëtyer. Ai ishte penduar që e kishte lënë Pasho Velçanin të shkonte me pararojën. Po t'i ndodhte ndonjë gjë, ç'do t'i thoshte Banushit? Në këto e sipër ai pa tre partizanë të pararojës që viniu me vrap. U ngrit dhe bëri me dorë. Partizanët e pararojës, duke u hedhur mbi shkëmbenjtë, iu afruan kapedan Kadri Gurrës.

— «Na goditën ballistët. Gjermanë nuk kishte!» — thanë ata.

— «Gjëja më e mirë është që s'ka gjermanë! Hë, pastaj?» — pyeti ai.

— «E pamë që u plagos i madhi i tyre!»

— «Kush?» — vuri dorën prapa veshit që të dëgjon-te më qartë kapedan Kadri Gurra.

— «I madhi i tyre. Pasho Velçani tha se i madhi i tyre është Qenam bej Ormani!» — tha partizani i pararojës.

— «Ai është ai! Kush e plagosi?» — tha kapedani.

Partizani u lëkund. Krojti kokën dhe tha:

— «Miku yt!»

— «E di, e di! Pasho Velçani! Kush tjetër përveç Pashos?» — tha kapedani Kadri Gurra me mburrje.

— «Atje janë larot e Qenam bej Ormanit,»

— «I pamë që iknë, duke e marrë në krahë të parin e tyre!» — tha partizani.

— «Ku vanë?» — tha Kadri Gurra.

— «U ngjitën në fshat!» — tha partizani.

Kapedan Kadri Gurra u nis me partizanët e tij në fshatin ku kishin qëndruar ballistët me Qenam bej Ormanin e plagosur.

Ecte në krye të partizanëve mes dëborës që shkrinte, ecte i lodhur, i rënduar nga mosha dhe linte pas gjurmë të lagura. Ai në batalionin e tij partizan zakonisht mbante një kalë të bardhë dhe me të i bënte rrugët e gjata. Por këtë radhë kishte mbetur pas batalionit bashkë me Pasho Velçanin; pasi të dy ishin ngarkuar të ngrinin në dy-tre fshatra Këshillat Nacionalçlirimtare, që ishin shpërndarë si rrjedhim i dezertimit të kryetarëve të tyre. Dhe tani pa kalin e tij e kishte të vështirë të ngjitej gjer atje lart, ku ishin fshehur ballistët.

Ata takuan pararojën që i priste përtej Gurit të Kamjes dhe mësuan më me hollësi për plagosjen e Qenam



bej Ormanit dhe për ballistët. Pasho Velçani i tha kapedan Kadri Gurrës se ballistët duhej ta kishin lënë të plagosurin në fshat dhe vetë duhej të kishin ikur. Kapedani shkoi dorën në mustaqet e lagura dhe i menduar qëndroi për një çast me sy nga fshati. Dukej sikur nuk kishte dëshirë ta ndiqte më tej Qenam bej Ormanin, mikun e dikurshëm të tij.

— «Të ngjitemi në fshatin e Qenam bej Ormanit!» — tha ai dhe u nis. Pas vinin partizanët.

Fshati dukej i zbrazur. Asnjëri nuk kishte në rruget dhe sheshet e tij me dëborë lara-lara. Vetëm diku prapa një muri të rrëzuar nga dëborat doli një burrë i vjetër me një kapelë me strehë, që e njihte kapedanin. Burri e zuri për qafe Kadri Gurrën dhe i tha se ballistët kishin ikur, duke e lënë Qenam bej Ormanin në shtëpinë e një miku të tij. Kadri Gurra e njihte mirë shtëpinë ku kishte mbetur beu i plagosur, pasi edhe vetë kishte qenë shumë herë. Ishte shtëpia e Fetah Vrëpskës, njeri mikpritës, i urtë dhe i lëkundur sa nga ana e partizanëve dhe sa nga ana e ballistëve. Fetah Vrëpska ishte edhe këngëtar i dorës së parë dhe kapedan Kadri Gurra e merrte me mend që atje pranë zjarrit Qenam bej Ormani bashkë me të me siguri do të ketë kënduar edhe se i plagosur.

Si i ndau gjithë partizanët nëpër fshat, me ndihmën e burrit me kapelë me strehë, e mori Pasho Velçanin dhe shkoi në shtëpinë e Fetah Vrëpskës, ku rrinte Qenam bej Ormani. I thirri të zotit të shtëpisë, duke hapur portën e oborrit mes të lehurave të qenit, dhe u nis drejt shtëpisë me brucën krahëve. Në prag të derës doli Fetah Vrëpska me qillota dhe xhakëtë shajaku dhe kapuliti sytë si para një drite të fortë, kur pa kapedan Kadri Gurrën dhe Pasho Velçanin.

— «Mirëseardhe, kapedan Kadri Gurra! Gëzohem, gëzohem — tha ai me gjysmë zëri.

— «E di që gëzohesh, Fetah Vrëpska!» — tha Kadri Gurra me një buzëqeshje tinzare.

Fetah Vrëpska ia dha dorën edhe Pasho Velçanit dhe i ftoi të vinin pas tij. Ai donte t'i shpinte në katën e dytë, në odën e miqve, por kapedan Kadri Gurra i tha se donte të ngrohej pranë oxhakut në dhomën e zjarrit.

— «Unë, o Fetah, ka kohë që nuk e kam takuar Qe-



nam bej Ormanin dhe më ka marrë malli!» — tha kapedani pa ia ndarë sytë Fetahut.

Fetah Vrëpska kruajti pakëz kokën me një buzëqeshje të ngrirë:

— «Unë doja të çlodheshe, o Kadri Gurra, dhe të mos matoseshe dhe të prishje gjakun me Qenam bej Ormanin. Pa po të duash, zotrote, shkojmë edhe në odën e zjarrit. Veçse do të na mërzitë Qenam beu. I dhëmb shumë krahu nga plaga që ka marrë!».

Kapedan Kadri Gurra e vështroi Pasho Velçanin, që qëndronte i gjatë me torbën me bomba, pushkën dhe koburen në brez.

Me të hyrë në odën e zjarrit, në bash të vendit pranë oxhakut, rrinte Qenam bej Ormani i mbështetur në një jastëk të madh, me krah të lidhur. Përpara kishte një tepsi sa një sofër me piperka me gjizë, me mëlçi pule dhe me një shishe raki.

— «Të bëftë mirë!» — tha kapedan Kadri Gurra.

— Qenam bej Ormani lëvizoi nga vendi, duke mbajtur me dorë krahun e djathtë të plagosur:

— «O, Kadri Gurra! Ç'po më shohin sytë! S'u besoj syve! Urdhëro Kadri Gurra! — pastaj iu kthye Pashos: — A, Pasho Velçani, djali i Banush Velçanit, kushuririt tim të paharruar!» — dhe u zgjati dorën e djathtë.

Pasho Velçani priste se çdo të bënte Kadri Gurra, priste me gjak të ngrirë. Por kapedan Kadri Gurra e zuri për dore dhe u ul në bashin tjetër pranë oxhakut. Ndërsa Pasho Velçani u ul pa ia dhënë dorën, duke e ngrysur fytyrën dhe duke e vështuar me zemërim kapedanin.

— «Qenke plagosur!» — tha Kadri Gurra dhe mori me mashë një thëngjill për të ndezur cigarin.

— «Në luftë jemi, o Kadri, edhe plagosemi!» — tha Qenam bej Ormani, duke e ndezur edhe ai cigarin.

Fetah Vrëpska erdhi në odë me të shoqen e tij, një grua të imët me kokë të vogël dhe të veshur me të zeza. Ajo i përqafoi të dy miqtë, e pyeti Kadri Gurrën për njerëzit e shtëpisë dhe doli. Pastaj u kthye përsëri me një tepsi të madhe me piperka me gjizë, me mëlçi pule dhe e vuri para këmbëve të dy mysafirëve. Fetah Vrëpska mbushi gotat e vogla të rakisë:

— «Ju paça shëndoshë! Gjak e dhjamël!» — tha ai dhe e ngriti gotën.



E ngriti edhe kapedan Kadri Gurra. Me vështirësi e piu edhe Pasho Velçani.

— «Ç'i bëre ata larot!» — tha Kadri Gurra me vështrim nga Qenam bej Ormani.

— «Iknë, o Kadri, iknë!» — tha beu dhe nga flaka e zjarrit i ndriti dhëmbi i florinjte.

— «Hëm! Po ne me Pashon erdhëm të të marrim dhe të të vrasim atje poshtë në përrua!» — tha Kadri Gurra qetë sikur e ftonte për ndonjë shëtitje.

Qenam bej Ormani e shtrëngoi prapë me dorë kra-hun e plagosur, pastaj mori gotën dhe i vështroi të dy, Kadrinë dhe Pashon:

— «Ku ta gjej plumbin e një miku të vjetër! Ne kemi qenë miq dhe njihemi mirë. E di që qëllon drejt e në shenjë dhe nuk do të më mundosh... Po të pimë edhe pak, se kemi kohë! Hajde, ju paçim!» — tha ai dhe e ktheu gotën.

Pinte edhe kapedan Kadri Gurra, pinte edhe Pasho Velçani, pinte edhe Fetah Vrëpska. Gotë pas gote dhe Qenam bej Ormanit iu zbutën sytë i pushtuar nga një për-mallim i trëndafiltë. Fytyra mori ngjyrën e një të kuqe-je të hapur si të një ëndërrimtari dhe ia thirri këngës me zë të ulët si për vete. Kapedan Kadri Gurra i mbante sytë në flakën e oxhakut, ndërsa veshin e kishte nga kënga. S'paska harruar të këndojë! mendoi ai dhe padashur filloi me zë të shtruar t'ia kthejë Qenam bej Ormanit. Edhe të tjerët nisën të mbanin iso: «e e e!»

— «Bukur ma ke kthyer këngën dikur! Po edhe tani mirë e kthen» — tha Qenam bej Ormani sikur mes tyre të mos kishte ndodhur asnjë prishje, asnjë armiqësi.

Kapedan Kadri Gurra lëvizi supin.

— «Dikur, dikur...» — tha ai.

Qenam bej Ormani ia mori asaj kënge që e pati dashur kapedan Kadri Gurra në rininë e tij:

Qan Rehova, qan Nivica

Për Kalemin nga Rakicka.

— O Kalem, o trim i marrë,

Pse s'e zbraze xhaferdarë?

— Unë s'e zbraza xhaferdarë

Se pashë Kamberë e vrarë!

U shkretofsh e shkretë hapsanë,



Që mban brenda nip Selmanë!  
 Nip Selmani tha një fjalë  
 Rakickës do t'i vë zjarrë  
 T'i dalë tej e matanë  
 Për Kamberë që ma vranë!  
 Bellovoda brinjë-brinjë,  
 Lufton nipi për dainë!..

Këndonte Qenam bej Ormani dhe ia kthente kapedan Kadri Gurra, si atëhere kur morën jevgjitkën në Përmet. Në atë kohë kapedan Kadri Gurra ishte krushk dhe shkante për të marrë nusen. Po tani? Kaq e plotpushtetshme ishte kënga? Mos vallë e trullosoi? Mos vallë e zbuti? Bukur këndon qeni! — tha ai me vete. Dhe shpejt u ngrit, duke harruar në dorë gotën. Bruca i kishte shpëtuar nga supat dhe i dukej në brez koburja. E vuri gotën në tepsi me rrëmbim. Nxori nga brezi koburen dhe e drejtoi tytën nga gjoksi i Qenam bej Ormanit.

— «Erdha të të vras!» — tha ai.

— «E di, e di — tha Qenam bej Ormani gjakftohtë.  
 — Po ti the në përrua, jo këtu!»

— «Këtu!» — tha kapedan Kadri Gurra.

— «Këtu e bëjmë me gjak shilten dhe truallin e Fetahut. Në s'do të më vrasësh në përrua, më vrit në oborr! Jo këtu!» — tha Qenam bej Ormani, sikur kishte dëshirë të vritej, dhe u ngrit.

Pasho Velçani dhe Fetah Vrëpska shikonin me ankth në krahërorët e tyre. Ata nuk e prisnin që ngjarja të rrokullisej siç u rrokullis.

— «Mirë! Në oborr!» — tha kapedan Kadri Gurra.

Qenam bej Ormani hodhi tri hapa dhe i tha Fetah Vrëpskës ta mbante për krahu. Në hajat mbathi këpucët dhe ashtu, i mbajtur për krahu nga Fetah Vrëpska, doli në oborr. Vështroi qiellin me re të murme prej dëbore dhe i bëri me kokë Fetah Vrëpskës ta shpinte përtej gardhit jashtë oborrit të tij, atje pranë një ftoi. Kadri Gurra dhe Pasho Velçani shkelnin në gjurmat e tyre të lagura.

— «Atje!» — tha kapedan Kadri Gurra.

Fetah Vrëpska e lëshoi dhe e la pas ftoit. Qenam bej Ormani kapi me dorën e majtë një degë ftoi dhe qëndroi në heshtje. Në këtë kohë kapedan Kadri Gurra doli për-



para dhe qëndroi përballë Qenam bej Ormanit. E gjithë kjo dukej si një lojë.

— «Dale, more, me gjithë mend e keni?» — thirri Fetah Vrëpska i verdhë dyllë.

— «Pusho, Fetah!» urdhëroi Kadri Gurra.

Dhe shtatë hapa larg Qenam bej Ormanit ai ngriti koburen, mori shenjë dhe shtriu tri herë. Qenam bej Ormani u lëkund mbi këmbët e tij të gjata, i shpëtoi dora e majtë nga dega dhe ra nën ftua. U drodh i tëri dhe dha frymën e fundit. Kapedan Kadri Gurra e futi koburen në brez, i bëri me kokë Pasho Velçanit dhe u largua anës e anës gardhit nëpër dëborën që kishte filluar të shkrinte.

— «Këndonte bukur qeni!» — përsëriti ai me vete dhe e dërgoi Pasho Velçanin të mblidhte partizanët.

Vetë qëndroi pas gardhit me brucën krahëve dhe me fytyrë nga Guri i Kamjes me majë të mbuluar me re.

Gunga e lisit si nëpërr ëndërr, filloi ta vrasë në kurriz kapedan Kadri Gurrën. Fërkoj sytë me dy gishtrinjtë e trashë dhe pa se ishte në majën e malit, atje ku rruga tani merrte tatëpjetën, atje ku dukej Guri i Kamjes. Vuri dorën prapa kurrizit dhe ndjeu një dhëmbje të vogël, se ishte mbështetur si shumë për gungë.

— Eh, kjo është e lehtë! Gunga e shpirtit është e rëndë. Më vret e shkreta! Ç't'u desh, o faqezi, kjo martesë! Ti që me dorën tënde ia bëre shoshë krahun Qenam bej Ormanit, të bëhesh dhëndërr i tij? Të ndjektë turpi gjer në mortje, o Pasho Velçani! tha ai, duke shikuar nga Guri i Kamjes, dhe u ngrit ngadalë se i dhëmbën gjunjët.

E hipi kalin dhe u nis për rrugë. Dëborë kishte filluar të ngjeshej, se ishte mesditë dhe kishte diell. Këmbët e kalit tani kërcisnin krap-krap dhe kapedan Kadri Gurrës i vinte keq për kafshën. Kjo dëborë e ngjeshur me cipë të trashë ia fërkonte këmbët kalit dhe mund t'i hapte ndonjë plagë. Por fshati tani ishte afër. Edhe pak dhe do të dukeshin shtëpitë e para atje në fund, pas përroit të thellë që zbriste që nga kurrizi i maleve dhe kalonte në krah të Gurit të Kamjes.

— Pritmë, o Pasho Velçani, pritmë! — tha kapedani kur dalloj shtëpitë e para me çati të pastruara nga dëborë.

Me të arritur në fshat, filloi ta ngasë kalin shpejt e shpejt, që të mos takonte asnjëri, se nuk vinte për ndonjë punë të mirë apo për ndonjë gëzim. U ndal para portës



së Pasho Velçanit, e shtyu pa thirrur dhe pa trokitur dhe hyri në oborr. Edhe në oborr nuk thirri. Zbriti nga kali. E la pas murit me rrypin e frerit në faqe dhe u fut në shtëpi si të ishte i zoti i saj. Në këtë kohë në hajat doli një nuse me fustan të gjelbër dhe thirri e trembur:

— Uh!

Kapedan Kadri Gurra i vrenjtur si re e murrme, pa kthyer kokën nga nusja, shtyn derën e odës së zjarrit dhe qëndroi në prag i madh me brucë krahëve dhe me mustaqe me bishtërinj të ngritur.

Nusja, megjithëse kapedan Kadri Gurra e vështroi vëngërr, hyri në odë dhe i doli përpara, e bukur me nishan të zi në ballë dhe me flokë të dendur të zes. Kapedani e pa me sytë nën vetullat e thinjura dhe për një çast ngriu. Atij iu kujtua Ballkiz jevgjitka e Përmetit, e veshur nuse në oborrin me lule. Iu kujtua Qenam bej Ormani, iu kujtuan gërnetat dhe sazet e jevgjitëve dhe u drodh për të ardhur në vete.

— Ulu, zotrote, Kadri bej! — tha Resmija, nusja e Pasho Velçanit dhe e bija e jevgjitkës Ballkiz, gruas së Qenam bej Ormanit.

— Beu i satëme! — thirri kapedan Kadri Gurra, kur dëgjoi që ajo e quajti bej.

— Uh! — thirri ajo pa u larguar.

— Shporrmu, jevgjitka e m...! — sokëlliu ai dhe ktheu kokën nga Pasho Velçani.

Pasho Velçani hapi sytë dhe u ngrit nga bashi i oxhakut i htuar. Xhaketa prej meshini e shtrënguar për trup e bënte që t'i dukeshin më shumë shpatullat e gjera dhe gjoksi si shkëmb. Koburja në brez, i kishte shkuar pas kurrizit dhe i varej në rrypin e liruar. Të dy, kapedan Kadri Gurra andej nga pragu i derës dhe Pasho Velçani këtej nga oxhaku me dru të trasha, qëndronin ballë për ballë. Asnjeri për një çast nuk fliste, vetëm shkëmbenin vështrimet në heshtje aq sa dëgjohej edhe kërcitja e druve në oxhak. Dhe kështu do të qëndronin ndofta një orë të tërë, sikur mos fliste i pari Pasho Velçani:

— Mirëseardhe, xhaxha Kadri! — tha ai dhe zgjati dorën. Por krahu si degë lisi i mbeti i shtrirë.

— Koburen! — thirri kapedan Kadri Gurra.

Pasho Velçani rrotulloi sytë në të tre muret e odës pa kuptuar asgjë.



— Qysh, koburen? — pyeti ai dhe i vetëtiu dhëmbi i florinjte.

Kapedan Kadri Gurra hodhi dy hapa para tij, zgjati dorën, ia kapi koburen e fshehur në këllëf dhe ia tundi.

— Koburen!

— Qysh, koburen! — përsëriti Pasho Velçani dhe u zbraps.

— Erdha të të marr koburen! Ti s'ke turi të mbash kobure. Ti na nxive faqen të gjithëve. Ti shkele mbi hirin e trupit të Banush Velçanit, i ndritë shpirti! Ti u martove me të bijën e Qenam bej Ormanit dhe bëre vjehërr atë që vetë ia thyeve krahun me bombë... Koburen!.. — sokëlliu kapedan Kadri Gurra dhe zëri kaloi nëpër oxhak dhe doli mbi çati bashkë me tymin.

Gratë e shtëpisë ishin mbledhur të gjitha dhe përgjonnin të frikësuara prapa derës.

— Ulu, xhaxha! Je lodhur nga rruga. Të pimë një kafe — tha Pasho Velçani.

— Farmak të pimë! Koburen!

— Koburen ma ka lejuar qeveria!

— Qeveria jam unë. Mua më ka dërguar qeveria të ta heq!

— Unë s'kam vrarë njeri! Qysh ma heq! — tha Pasho Velçani.

— Ke vrarë nderin! — ia preu kapedan Kadri Gurra.

— Nderi im s'ka pësuar gjë!

— Është vrarë. Ka vdekur! Të martohesh me të bijën e Qenam bej Ormanit që unë e vrava me dorën time para syve të tua dhe më thua që e ke nderin shëndoshë e mirë? — tha kapedan Kadri Gurra dhe ia afroi fytyrën dy gishtrinj para syve, aq sa Pasho Velçani vështronte vetëm qimet e trasha të mustaqeve të thinjura.

Ai nuk i duroi dot këto mustaqe, që iu zmadhuan si vandakë me grurë, dhe hodhi edhe një hap pas.

— Unë ia mora hakun Qenam bej Ormanit. Unë e bëra fërtele. I thyeva dorën me bombë dhe ia mora të dy çupat! — tha Pasho Velçani.

Kapedan Kadri Gurra u hodh përnjëherësh përpjetë sa për pak i zuri koka në tavan:

— Si të dy çupat!

— U martova me të dyja. E mora në fillim të madhen, pastaj e vogla erdhi vetë tek unë!



Pasho Velçani nxori nga xhëpi një zinxhir të hollë për të patur diçka në dorë, që ta ndihmonte për t'i ardhur fjalët.

— Edhe ti ke kënduar me Qenam bej Ormanë! — tha ai.

— Kam kënduar dhe e kam vrrarë! — u përgjigj kapedani rëndë.

— Mirë ke bërë. Ia more këngën dhe e vrave. Kënga nuk ishte për Qenam bej Ormanë! — tha Pasho Velçani.

— Hëm! — bëri kapedan Kadri Gurra.

— Ti ia more këngën, unë ia mora çupat. As çupat nuk ishin për të! — tha Pasho Velçani.

— Hëm! Çupat janë të tijat. Kënga nuk ishte e tija! Këngën ia kishte vjedhur popullit! — thirri kapedan Kadri Gurra.

— Edhe të shoqen, Ballkizin nënën e të dy çupave, ia kishte vjedhur popullit! Ajo ishte e bija e jevgjitit! — tha Pasho Velçani.

Kapedan Kadri Gurra shtrëngoi dhëmbët. Mustaqet i lëvizën dhe u nxeh:

— Koburën! Do të më mbushësh mendjen me gje-pura!

Mustaqet e kapedan Kadri Gurrës dridheshin. Herë ngrihej lart një bisht dhe herë ulej poshtë bishti tjetër. Ndërkohë Pasho Velçani tha:

Unë një natë vrava mendjen. S'mbylla sy. Shoshite këtej, shoshite andej. Merre nga një shoshë, hidhe në shoshën tjetër. Dil nga një derë, hyrë në një derë. Qëndro te bejlerët, hidhu në jevgjitët. Dhe fap! e gjeta. Mendja më tha: Pasho, çupat e jevgjitkës Ballkiz mos i ler rrugeve! Merri, Pasho, në shtëpi! Unë i thashë mendjes: Mendje, po ato nuk janë vetëm të bijat e jevgjitkës! Janë edhe të Qenam bej Ormanit! Po mendja m'u përgjigj: më shumë janë të jevgjitkës! Të dyja kanë nga një nishan në ballë. Qenam bej Ormani nuk kishte nishan në ballë! Të dyja janë shpirt njeriu. Qenam bej Ormani nuk ishte shpirt njeriu. Gjyshi i tyre, krushku i Qenam bej Ormanit, doli malit partizan dhe u vra. Qenam bej Ormani nuk doli malit partizan. Nëna e tyre Ballkizi është jevgjitkë. Nëna e Qenam bej Ormanit është bejlereshë. Merri, Pasho! më tha mendja. Dhe unë i thashë: I marr, po kam



telashe, se ato e kanë gjakun e përzier! Mendja prapë më tha: Ne marrim gjakun tonë, gjakun e jevgjtit. Gjakun e beut do ta fshijnë dallgët e kohës. Dhe unë fap! i mora...

Kapedan Kadri Gurra përsëri lëvizi mustaqet, këtë rradhë me mendje të prishur nga fjalët e Pasho Velçanit Por nuk e dha veten.

— Ç'janë këto gjepura! — thirri ai.

— S'janë gjepura fare! Unë ia mora të dyja çupat Qenam bej Ormanit. Unë kam luftuar dhe ai që lufton bën reforma. Reforma nuk bëhet vetëm për tokën, por edhe për gruan. Unë bashkë me tokën ia mora Qenam beut edhe çupat. Toka i përket atij që e punon, ka thënë Lenini. Dhe ka thënë pastaj se gruaja i përket atij që e don! — tha Pasho Velçani.

Kapedan Kadri Gurra, sa dëgjoji të zihej në gojë emri i Leninit u hodh përpjetë:

— S'ke surrat të zesh në gojë Leninin! Bashibozuk! Koburen! — thirri ai i xhindosur dhe vuri dorën në brez më shpejtë sikur të ishte një djalë tridhjetëvjeçar.

Para Pasho Velçanit u zgjat tyta e nagantit të kapedan Kadri Gurrës. Ai diçka pëshpëriti nëpër buzë, zërbërtheu këllëfin, e nxori koburen dhe ia dha kapedanit. Kadri Gurra e mori, hapi brucën dhe e futi në xhepin e xhakëtës. Pa folur ktheu krahët dhe doli me hapa të rëndë. Në oborr e priste kali. Hipi në shalë si në kohën e rinisë dhe iku i bërë tym e mjegull.

— I poshtri! I paska marrë të dyja çupat e Qenam bej Ormanit, të dyja zuskat e jevgjtkës! — murmuriti ai hipur mbi kalë dhe iu kujtua përsëri dasma e Qenam bej Ormanit, iu kujtua udhëtimi në Përmet, gërnetat, këngët dhe vallet, iu kujtua edhe nusja e atëhershme, Ballkizi. Po iu kujtua edhe kënga e fundit e Qenam bej Ormanit, dhe gremisja e tij në ftua...

— Si erdhi puna — tha ai me vete dhe psherëtiu. Në xhep i rëndonte koburja e Pasho Velçanit...

### 3

Çarmatosja e Pasho Velçanit nga kapedan Kadri Gurra dhe dorëzimi i kobures së tij në organet e qeverisë nuk bëri më pak bujë sesa martesja me vajzat e Qenam



bej Ormanit. Në gjithë Gorën dhe Mokrën, ku njerëzit prisnin që kapedan Kadri Gurra të bënte hatanë, në çdo mbrëmje, në çdo gosti dhe në çdo kafe të qytetit flitej për koburen e Pasho Velçanit. Disa thoshin se kapedan Kadri Gurra para se t'ia merrte koburen, qëlloi tri herë me nagant dhe Pasho Velçani, duke u dridhur ngriti duart përpjetë si i zënë rob. Atëhere vetë kapedan Kadri Gurra ia hoqi nga rrypi koburen dhe e çarmatosi.

— Uh u u u! — kishin bërë ata që e kishin dëgjuar këtë ngjarje.

Por pas çarmatosjes ndodhi edhe një ngjarje tjetër. Pasho Velçanin e hoqën edhe nga përgjegjësia që kishte si kryetar lokaliteti dhe e lanë të punonte tokën. Fshatarët nuk e takonin më si më parë, miqtë nuk e ftonin në gostira dhe të njohurit i largoheshin. Dhe Pasho Velçani u mbyll në vetmi me të dy çupat e Qenam bej Ormanit, më e bukur njëra se tjetra. Zyrtarisht Pasho Velçani vetëm me të madhen ishte martuar. Por njerëzit mendonin se të dyja i kishte si gra, ashtu siç i kishte thënë vetë Pasho Velçani kapedanit. Kishte ndodhur si në atë këngën që këndohej andej:

Atje lart te çezmë e madhe  
Hyjnë e dalin, o nja dy sorkadhe!  
E njëra më e vogël, e tjera më e madhe  
Atë më të madhen do ta marr për fare,  
Atë më të voglën do ta bëj manare...

Kohët ishin të turbullta. Qenam bej Ormani vërtet ishte vrarë, por në krahinë kishte lënë njerëzit e tij, kushurinjtë, farefisin, miqtë dhe shokët. Njerëzit prisnin se çdo të bënte Pasho Velçani, a do të lidhej me ta dhe a do t'i priste me këngë e me raki? E prisnin këtë, pasi ai nuk mund të rrinte i mbyllur brenda pa njerëz, i vetmuar si kukuvajka. Edhe kapedan Kadri Gurra priste si të tjerët.

— Ç'thotë kapedan Kadri Gurra? — pyesnin ata që e njihnin Pasho Velçanin.

— Hiç! Rri dhe pi duhan!

— Hëm! — bënin dhe prisnin.

Ndërsa njerëzit prisnin se çdo të ngjante, në shtëpinë e Pasho Velçanit ndodhi një gjë që askujt nuk i kishte shkuar në mend. Një mbrëmje nga larg erdhën në



shtëpinë e tij dy njerëz. Njeri ishte Asllan beu, i nipi i Qenam bej Ormanit dhe tjetri Fetah Vrëpska. Asllan beu binte kushuri i parë me çupat e Qenam bej Ormanit. Miqtë Pasho Velçani i priti mirë, megjithëse dikur nuk i kishte dashur dhe iu rrinte larg. Por vetmia ndonjëherë të ngjall mallin për njerëzit.

Pasho Velçani shtroi sofrën me mish e me raki dhe filloi muhabeti dhe kënga. Në sofër erdhën edhe të dy çupat e Qenam bej Ormanit, edhe ato të këngës e të rakisë si burrat. Më e madhja, Resmia, gruaja e dashur e Pasho Velçanit, me fytyrë të lëmuar vezake, me buzë si dy kokrra qershie të vëna njerë mbi tjetrën dhe me nishan të zi në ballë, fliste më shumë se e vogla që mbante një shamë me qëndisma në kokë dhe dy vathë floriri në vesh. Dhe megjithëse Resmia fliste dhe dukej e gëzuar, diçka të keqe ndjente në shpirt. Ajo nuk e donte Asllan beun, kushuririn e saj të parë, bile i vinte pështirë se ishte një pusht i lig dhe i pabesë. Ai, duke përfituar nga vrasja e të atit, Qenam bej Ormanit, i vinte rrotull pa dashur të dijë se e kishte kushurirë. E quante Resmijen jevgjitkë dhe mendonte se këto vajza me këtë lloj gjaku mund të shtiheshin lehtë në dorë dhe me to mund të bëje ç'të doje. Ajo nuk e harronte një ngjarje, kur ky Asllan beu, i veshur me një dolloma të gjatë që e quante pizhame, kishte hipur në kumbull dhe e ftonte Resmijen të vinte nën degë për t'i dhënë ndonjë kokërr. Kur shkoi ajo nën degë të kumbullës dhe ngriti fytyrën për të marrë kokrrat, pa nga poshtë se Asllan beu ishte pa brekë dhe i dukeshin të gjitha të përbrendshmet.

— «Uh, uh!» — bëri ajo dhe iku me vrap.

— «E ç'uh? Kokrra janë edhe këto që vështrove!» — tha ai dhe zgërdheshi dhëmbët e pistë.

Resmia nuk i kishte thënë gjë Pasho Velçanit jo se i vinte turp, por nuk donte të ndizej ndonjë sherr. Edhe tani nuk kishte dëshirë ta shikonte në sofër Asllan beun, po ç't'i bënte të shoqit. Dhe nuk i dukej punë e mirë që kishin filluar t'u vinin në shtëpi këta lloj njerëzish. Çuditej edhe me Pashon sesi i pranonte!

Ndërsa Fetah Vrëpskën, mikun e hershëm të të atit, ajo e njihte pak, por kishte dëgjuar se kapedan Kadri Gurra në shtëpinë e tij e kishte gjetur të plagosur dhe e kishte vrarë pranë ftoit.



Ajo rrinte në sofër pranë të motrës dhe u mbushte burrave gotat e rakisë, duke dëgjuar kuvendimet e tyre. Në këto kuvendime ndjehej diçka e papëlqyer, diçka që e shtynte Pashon e saj të dashur të zemërohej dhe të merrte dalëngadalë helm. E kuptonte se ky helm nuk i jepej Pashos përnjëherësh, por pikë pas pike. Edhe këtë donte t'ia thoshte, por Pashua kishte një zakon të keq që nuk i dëgjonte gratë për punët e mëdha të politikës.

Anës e anës asaj darkeje i nipi i Qenam bej Ormanit e solli fjalën rrotull fatit të Pasho Velçanit. Ai fliste dhe herë pas here kafshonte shallin e verdhë që mbante në qafë. Duke folur kapuliste sytë e vegjël të ndezur si të maçokut.

— Nga fisi ynë vetëm ti e kuptove luftën partizane. Bravo të qoftë! Xhaxha Qenamini e gënjeu Safet Butka. Mos kishte qenë ky këmbëthyer, xhaxhai do të kishte dalë partizan me kapedan Kadri Gurrën, siç dole ti. Eh, ç't'i bësh! — thoshte Asllani.

— Kur e prishi xhaxhaj, s'e ndreqja dot unë! Po edhe të dilja partizan, prapë do të kisha fatin tënd. Fisin tonë nuk e duan. Ja, ti luftove, more plevitin malit dhe ç'bërë? Të gjitha i mori lumi!

Pasho Velçanit i mbeti gota e ngritur. E vështroi të shoqen, që e kishte përballë dhe e uli në sofër. E shoqja, siç uli ai gotën, uli sytë. Ajo e dinte se për shkakun e saj Pasho Velçani i humbi të gjitha.

— Unë përsëri jam më i nderuar se ju! — tha Pasho Velçani dhe aty për aty iu kujtuan fjalët e kapedan Kadri Gurrës: «ti e vrave nderin!» — Ti lemë këto përralla! — shtoi ai.

— Ama jo! — tha Fetah Vrëpska.

— Mua më ka marrë malli për njerëz. Të pimë e të këndojmë! — tha Pasho Velçani.

— Ashtu të bëhet! — thanë edhe Asllan beu, edhe Fetahu dhe i premtuan se do të sillnin edhe miq të tjerë dhe do t'ia shtronin ndonjë natë.

— Të urdhërojnë! — tha Pasho Velçani. — Dera ime hapur ka qenë dhe hapur ka për të mbetur.

Këto hyrje dhe dalje të nipit të Qenam bej Ormanit dhe të tjerëve në shtëpinë e Pasho Velçanit tërhoqën për një çast vëmendjen e njerëzve në gjithë Gorën dhe Mokrën. Por kjo vëmendje ishte vetëm për një çast. Njerë-



zit dalëngadalë po e harronin Pasho Velçanin. Edhe kapedan Kadri Gurra, miku i tij më i afërt dhe më i madh, po e harronte. Harresa filloi që me çarmatosjen. Bile kur i thanë kapedanit të mplakur se Pasho Velçani e kishte trashur miqësinë me të nipin e Qenam bej Ormanit, ai nuk ishte çuditur dhe nuk ishte bërë kurioz të dinte hollësisht. Duke ndrequr brucën në shpinë, kishte thënë:

— Po të përzihesh me krunde, pulat të hanë! — dhe nuk e kishte zgjatur më.

Megjithatë për Pasho Velçanin tani flisnin të tjerët. Emri i tij nga dita në ditë përhapej gjithnjë e më shumë në kuvendime me zë të ulët në odë dhe prapa ferrave, në ndonjë kafe të humbur më të dalë të qytetit dhe në ndonjë takim me dy-tre vetë. Për Pasho Velçanin flisnin edhe të arratisurit në male, edhe të dërguarit nga anglezët. Por këtë as vetë Pasho Velçani nuk e dinte, as miqtë e tij të dikurshëm nuk e dinin. Pasho Velçani vetëm e ndjente dhe i zyrtë, plot pikëllim dhe mërzi mbyllej në odë dhe vështronte malet. Kjo ishte një mbyllje nga dëshira e vet, një mbyllje e përgatitur nga dora e tij. Ai shkante e vinte nëpër dyshemenë e odës me duart në xhepa dhe cigare në buzë i mërzhitur dhe i përvuajtur. Pastaj ulej pranë një arke të madhe të fshehur në sergjen në murin e odës. Arka ishte e mbushur me bomba-dore të kuqe nga ato të ushtrisë italiane. Merrte në dorë ndonjë nga to, si të ishte vezë, e vështronte duke e rrotulluar nëpër gishtrinjtë dhe psherëtinte.

Bënte ç'bënte dhe ngjitej lart në odë ku ishte arka, e hapte dhe nxirrte bombat duke i numëruar. I ishte bërë si mani. Madje një herë e gjeti edhe Resmija në mes të odës me një bombë në dorë, duke thirrur me një zë të tmerrshëm:

— Përpara, partizanë!

Ajo e tmerruar iu hodh në qafë:

— Pasho, ç'bën? Na vrave! Na dogje!

Atëhere Pasho Velçani erdhi në vete. E mbylli arkën. Pastaj e mbylli me kyç sirtarin e madh të futur në mur prapa kapakëve të sergjenit. U ul në mimin e shtruar me fletë qilimi dhe me poste, mbuloi fytyrën me të dy duart dhe filloi të qante. Ishte një e qarë me ofshamë, një e qarë e rëndë burri. E shoqja në fillim mbeti e hutuar në



mes të odës, pastaj i shkoi pranë dhe ia vuri dorën në flokët. Pasho Velçani zbuloi fytyrën dhe ajo vuri re sytë e tij të kuq dhe lotët që rridhnin. Nga këta sy u tmerrua dhe u zbraps.

Por Pasho Velçani tha:

— Kam mbetur vetëm, Resmije! Të gjithë më kanë lënë dhe më kanë mbyllur këtu si murg. Unë jam një murg i vetmuar dhe ti me motrën tënde jeni murgesha. Mua të gjithë njerëzit më kanë ikur. Dhe unë kam mall. Edhe zogjtë kanë marrë arratinë dhe unë nuk dëgjoj as zogjtë. Kam vetëm ca bomba, që më kujtojnë luftën dhe shokët e mi të luftës. I nxjerr nga sergjieni bombat dhe më dalin para syve shtigjet nga kalova, më del kapedan Kadri Gurra, miqtë, shokët. Unë do të luaj mënç. Unë do ta hedh në erë këtë shtëpi. Do ta zbraz të gjithë arkën dhe do t'i vë flakën këtij manastiri ku jam mbyllur me dëshirën time. Dhe unë do ta shemb këtë manastir. Këtu më vijnë njerëz që s'i dua. Ata që i dua s'më afrohen...

Resmija i shkoi pranë dhe ia ledhatoi kokën me dorën e butë si një fletë molle.

— Pasho, lermë mua të iki me motrën. Të shkojmë në Përmet dhe të ndahemi. Dhe ty do të vijnë njerëz — tha ajo.

Pasho Velçani rënkoi dhe e mori në gjoks Resmijen ashtu siç rrinte në mimin e gjerë. E ledhatoi dhe ia puthi sytë, sikur ta kishte fëmijë dhe jo grua. Dhe Resmija u tulli në gjoksin e tij, se kurrë ndonjë herë nuk kishte ndjerë një dhëmbshuri të tillë nga i shoqi, një dhëmbshuri të vërtetë.

— Ah, sa ke hequr, or i ziu Pasho! — ofshau Resmija, e bija e jevgjithkës Ballkiz.

— Ik tani, Resmije! — tha ai dhe ajo doli nga oda.

Pasho Velçani u ngrit nga mimi. E hapi përsëri sergjenin dhe mori torbën të thurur me lesh të trashë me ngjyrë të kuqe. Në torbë vuri shtatë bomba të kuqe, të zgjedhura nga më të rejat. Vuri edhe një granatë si breshkë.

— Le të jetë e mbushur! — tha me vete.

Dhe pastaj zbriti në odën e zjarrit me xhakëtë krahëve. Të dy çupat e Qenam bej Ormanit përgatitnin dar-kën. Njëra, më e vogla, tërhollte petët e byrekuq dhe Resmija përgatiste gjellët dhe mehzenë. Prisinin që të vinin



për darkë i nipi i Qenam bej Ormanit me Fetah Vrëp-skën dhe dy të tjerë.

Resmija, duke vënë në tasin e madh piperkat me gjizë, tha e mërzhitur:

— Thyefshin qafën!

Pasho Velçani e dëgjoi.

— Cilët? — pyeti ai.

— Ja këta që na vijnë për darkë! — tha ajo pa i ngritur sytë nga tasi.

— Mirë, mirë! S'është puna jote!

Ajo me llërë të përveshura dhe me përparëse të gjelbër iu afrua Pashos:

— Asnjëri nga këta që na vijnë nuk më pëlqen. Do të na bëjnë ndonjë punë të keqe!

Pasho Velçani e vështroi me pak habi. Resmija kurrë nuk i kishte folur me këtë gjuhë dhe kurrë nuk ishte përzierë në punët e tij. Tani edhe ajo diçka nuhat.

— E ç'të bëjnë ata? Mos të besdisin?

— Kanë marrë një shishe me helm dhe ta hedhin ty me pikatore: pik, pik, pik! — tha ajo, duke bërë me dy gishtrinjte e dorës sikur shtyp pikatoren.

— Pik, - pik-pik! Hëm! — tha Pasho Velçani dhe për çudi të Resmijes, në vend të zemërohej, filloi të qeshë.

Qeshi edhe Resmija, edhe e motra që shtronte petët e byrekut.

— Pik-pik-pik! domethënë! — përsëriti Pasho Velçani dhe mori kandilin.

E ndezi dhe zbriti në bodrum për të mbushur shishet e rakisë nga zamzanet e mëdha. Bodrumi binte erë raki, qepë, hudhra, mollë dhe ftonj. Mbushi katër shishe litroshë, ua mbylli grykat me koçanka misri dhe i shpuri në odën e zjarrit.

Kur filloi të errej, Pasho Velçani doli në oborr të presë miqtë. Oborri ishte i madh. Rreth e rreth ishte i mbjellë me mollë e ftonj dhe nja dy metra larg nga muri i shtëpisë ngrihej një kaçkë e lartë, e trashë sa dy trupa njeriu. Dëbora tani kishte ikur dhe oborri ishte zbuluar. Vetëm nën muret e tij, ku nuk zinte dielli, kishte ende togje dëbore që dukeshin si llogore lufte. Kjo ishte dëbora që ishte hedhur pas pastrimit të çatisë. Pasho Velçani u lodh duke vështruar oborrin dhe shkoi pranë kaçkës. U mbështet në trupin e saj të trashë dhe nxori kokën për të



parë nga porta e oborrit, sikur të luante mbyllasyze si fëmijët. Përtej portës dëgjoi zëra dhe u largua nga kaçka.

— O, mirëseardhët! — thirri ai kur pa nipin e Qenam bej Ormanit me Fetah Vrëpskën dhe dy të tjerët që nuk i njithe.

— Mirë se të gjejmë, kusuri! — thirri Asllan bej Ormani dhe u përqafuan.

Pasho Velçani ua dha dorën edhe dy të panjohurve.

— Këta zotërinj nuk i kam parë ndonjëherë! — tha ai.

— Janë miqtë tanë nga Kulmaku i Skraparit! — tha Fetah Vrëpska.

— Më bëhet qejfi! Bahçeja e bukur me lule shumë, i thonë një fjale! — qeshi Pasho Velçani duke ua shtrënguar duart miqve që e hiqnin veten nga Kulmaku.

Miqtë hoqën brucat dhe këpucët në hajat, hynë në odë dhe u shtruan rreth oxhakat me kërcunj të mëdhenj të ndezur. Ata nga Kulmaku ishin të lodhur dhe të heshitur. Afshi që vinte nga oxhaku atyre u sillte gjumë dhe mezi i mbanin kokat në qafat e tyre të ligura. Të dy ishin të dobët, me fytyra të hequra e të parruara. Që të mos i zinte gjumi, Pasho Velçani urdhëroi gratë të shtronin sofrën.

Me të vërtetë në sofër ata u gjallëruan. Gotat e para të rakisë ua nxorën gjumin. Filluan edhe të këndojnë.

— Si vini andej nga Skrapari? — pyeti Pasho Velçani.

— Kohët janë të vështira! — tha më i moshuari. — Shtëpi më shtëpi kontrollojnë për të gjetur bereqet të fshehur...

— Mirë bëjnë! Pasanikët fshehin, pasanikët kontrollohen — Pasho Velçani.

— Ku pyesin për pasanikë e për nevojtarë. Të gjithë i kontrollojnë! — tha Asllan beu.

— Mua s'më kanë kontrolluar! — tha Pasho Velçani.

— Do të të vijë radha! — tha Asllan beu.

— Qeveria bën ç'të dojë! — tha Fetah Vrëpska.

— Gani beu në Karkanjos, vetë shkruan, vetë vulos! themi ne nga Skrapari! — qeshi më i moshuari i miqve.

Qeshën të gjithë, bashkë me ta edhe Pasho Velçani. Në këtë kohë u dëgjuan të lehura qensh. Rrallë lihnin



kaq shumë qentë nëpër fshat. Miqtë filluan të vështrojnë në njëri-tjetrin.

— Ç'kanë që lehin? — pyeti Pasho Velçani.

— Mbase kanë rënë në ndonjë ujë! — tha njeri nga të Kulmakut.

— Mbase! — tha Asllan beu dhe u ngrit nga sofa.

Hapi derën dhe doli në oborr. Të tjerët nuk ia vunë veshin dhe vazhduan të pijnë. Pasho Velçani këtë radhë nuk kishte dëshirë të pinte, por si i zoti i shtëpisë detyrohej të mbante gjallë muhabetin. I ngrinte gotat me zor dhe e ngiste fjalën me zor. Prandaj priste me padurim sa të kthehej Asllan beu, që ishte njeri i fjalës dhe e kishte qejf bisedën.

Asllan beu u kthye pas një mungese të gjatë. Ai nuk u ul menjëherë në sofër. I bëri një shenjë me kokë Pasho Velçanit dhe e tërhoqi mënjanë.

Kanë ardhur nja katër a pesë nga ata që të tregova parmbremë! — tha ai.

Pasho Velçanit gati sa iu muar fryma.

— Ata të anglezëve? — pyeti ai.

— Ata!

— Po ç'duan? — pyeti.

— Të njihen, të marrin një sy gjumë! Këtu janë në vend të sigurtë. Shtëpia jote nuk dyshohet! — tha Asllan beu.

Pasho Velçani u mendua. E shtrëngoi mjekrën me dorën e majtë dhe qëndroi për një kohë i palëvizur dhe i ngrirë.

— Hëm! Qenka punë e madhe! Atëhere të dalim t'i presim. Më mirë t'i ftojme në sofër. Të pijmë nga një gotë, të bëjmë dy kokrra muhabet! — tha ai.

— Fjalë me vend! Priti ti, si i zoti i shtëpisë. Unë po rri në sofër! — tha Asllan beu.

Pasho Velçani doli në hajat. U mendua për një çast në këmbë dhe pastaj u ngjiti shpejt e shpejt në odën e beharit, mori torbën e kuqe dhe zbriti në oborr. Vështroi përreth dhe si nuk vuri re njeri, thirri:

— Urdhëroni, ore miq!

— Po vijmë, po vijmë! — u dëgjua një zë prapa mullëve atje ku dëborë kishte mbetur si dëborë.

Menjëherë Pasho Velçani u fsheh prapa kaçkës, nxori nga torba bombën e dorës dhe e hodhi. Pas saj hodhi



edhe të dytën dhe të tretën. Dy plasje të tmerrshme gjë-muan në oborrin e Pasho Velçanit mes natës së errët. Tre vetë, duke qëlluar me hamendje dolën nga llogoret prej dëbore dhe u hodhën me vrap në portën e madhe të oborrit. Pasho Velçani hodhi edhe një bombë tjetër drejt portës. Miqtë e lanë sofrën dhe të hutuar morën vrapin si veriu nëpër oborr. I tërbuar Pasho Velçani hodhi edhe një bombë tjetër drejt portës. Miqtë e lanë sofrën dhe të hutuar morën vrapin si veriu nëpër oborr. I tërbuar Pasho Velçani hodhi granatën në portë dhe u fsheh prapa kaçkës që të mos e godiste ndonjë cifël.

Tymi i thartë i bombave u përhap nëpër oborr dhe ra një qetësi e rëndë. Në fundin e torbës kishin mbetur edhe tri bomba-dore. Pasho Velçani rrinte pas kaçkës dhe numëronte me vete:

— Ishin pesë vetë. Tre dolën. Dy ku janë?

Ai thirri me zë të lartë dhe hodhi edhe një bombë tjetër. Resmija me të motrën kishin dalë në prag të portës së hajatit dhe lebetiteshin. Ato nuk e kishin dalluar Pasho Velçanin dhe kishin kujtuar se e kishin vrrarë.

— Këtu jam, këtu! Po ndizni kandilin! — tha ai që prapa kaçkës i mbështjellë nga errësira dhe nga tymi i bombave.

E shoqja e solli kandilin. Pasho Velçani e mori në dorë dhe tha se do të kërkonte në oborr dy njerëz të mbetur. Ai tha se ata duhet të ishin vrrarë.

— Kanë qenë pesë! Vetëm tre dolën. Të tjerët janë këtu.

Gruaja iu hodh në qafë:

— Aman, Pasho! Ma jep kandilin t'i gjejmë ne ku janë. Aman, Pasho!

Pasho Velçani e shtyn Resmijen:

— Nuk është puna jote! — dhe me kandil në dorë filloi t'i kërkojë.

Njerin e gjeti të shtrirë pas mollës, me gojë të hapur dhe sy të çakërritur, i mbytur në gjak. Koburen e kishte ende të shtrënguar në dorë. Pasho Velçani e shtyu me këmbë dhe e ktheu përmbys.

— Bërr, sa i llahtarshëm! — u drodh e shoqja që e ndiqte pas.

— Ta gjejmë edhe tjetrin! — tha ai dhe e ngriti mbi kokë kandilin për të vështruar më mirë.



Atje pas ftoit nxinte një trup i shtrirë, i kthyer në krah. Pasho Velçani hodhi një hap drejt tij. Sa e hodhi hapin përnjëherësh u dëgjua një krismë revolveri. Pasho Velçani filloi të bëjë harqe me kandilin në dorë. Iu murarën këmbët, u lëkund, por nuk ra. As kandilin nuk e lëshoi nga dora. Resmija thërriste e qante.

— Pasho, të vranë! Pasho, të vranë!

Por Pasho Velçani duke u lëkundur u hodh mbi trupin e shtrirë të njeriut që qëlloi me revolver. Kandili i ra nga dora. Duke u hedhur mbi të ia vuri duart në grykë. Të shtririt i shpëtoi revolveri. Pasho Velçani e zgjati krahun e rënduar, mori revolverin dhe e shkrehu në mes të ballit të njeriut të plagosur. Nën trupin e tij Pasho Velçani ndjeu dridhjet e fundit të mishit të njeriut tjetër. Bëri të ngrihej, por errësira iu rrotullua dhe iu duk sikur u fundos mes saj. Pastaj ndjeu një dritë, që sa vinte dhe bëhej më e madhe. Ishte kandili që mbante në dorë Resmija. Drita filloi dalëngadalë të shuhej dhe Pasho Velçani e kuptoi që po humbte mes pafundësisë.

— Po vrapoj! — mendoi ai. — Ku vete kështu? Primitmë, o kapedan Kadri Gurra se po vij!..

Dhe Pasho Velçani vdiq. Mbi trupin e tij me kandil në dorë qante Resmija, e bija e jevgjitkës Ballkiz.

---

1985



# Shënimi i autorit

Tregimet e librit «Njerëz të krisur» nuk janë botuar në asnjë përmbledhje tjetër të autorit, përveç rrëfimit të vogël tragjik «Egërsia», që është marrë nga vëllimi fatkeq «Zhurma e erëve të dikurshme», dalë në dritë në vitin 1964. Edhe ky rrëfim u përmbodh në librin «Njerëz të krisur» vetëm e vetëm se ka mbetur si një shkrim i harruar i pabotuar as edhe në dhjetëvëllimshin e veprave të zgjedhura të autorit. Ndërsa tregimi «Njeriu me veladon» në fillim pati hyrë në përmbledhjen «Zhurma e erëve të dikurshme» dhe pas botimit të variantit të parë të librit u hoq nga cenzura e atëhershme. Ai mbeti vetëm në pesë kopjet e para që iu dhanë autorit dhe më vonë, më 1973, u botua në Prishtinë në vëllimin «Njeriu i mirë» gati në mënyrë ilegale. Nja dy-tre tregime të botuara në revistën «Nëntori» dhe në gazetën «Drita», si «Martesa e papritur e Pasho Velçanit», «Nipi plëngprishës» dhe «Tro-nditja e madhe», u kritikuan nga autoritetet e larta zyrtare për «deheroizimin e personazheve». Kështu që autori nuk mund t'i botonte dot në ndonjë libër të tij, pasi në fakt ishin të ndaluara, megjithse edhe ai vetë kishte një post të rëndësishëm në shoqëri.

Në përgjithësi tregimet e librit «Njerëz të krisur» nuk janë shkruar me ndonjë qëllim botimi të çastit siç është dëshira e çdo shkrimtari për ta parë veprën e tij në duart e njerëzve. Ato janë shkruar më shpër për qëllim zbavitës për hir të ngjarjeve të pazakonta që rrëfohen dhe me synimin për t'ua dhënë miqve dhe shokëve t'i lexojnë në dorë dhe shkrim. Personazhet e këtyre tregimeve janë njerëz pak të krisur dhe pak tuhafë të çuditshëm që sillen ndryshe të tjerëve qoftë në luftë, qoftë në jetë. Nga kjo sjellje, jashtë moralit dhe zakoneve të shoqërisë dhe të ambjentit njerëzor, ata bien në fatkeqësi tragjike. Ngjarjet që përshkruhen në këto rrëfime janë pothuajse të vërteta dhe personazhet janë po aq realë, të njohur nga vetë autori ose të dëgjuar nga goja e miqve dhe shokëve të tij.

Mbase një pjesë e këtyre tregimeve do të vazhdonte të mbetej në dorëshkrim dhe një pjesë tjetër e shpërndarë nëpër gazeta do të harrohej, sikur mos ngulte këmbë për botim Lili Bare, përkthyesi i njohur dhe njeriu me një kulturë letrare të gjerë, me të cilin më lidh një miqësi e gjatë dhe e vjetër më shumë se dyzetvjeçare, që në kohën kur kemi qenë bashkë studentë në Leningrad, sot Sankt-Petërburg. Për këtë gjest fisnik unë e falënderoj mikun tim të vjetër, se vërtet interesimi për botim dhe vetë botimi është shenja e një fisnikërie të lartë.

Maj 1995

Autori



## PËRMBAJTJA

	Faqe
- Njeriu me veladon . . . . .	3
- Ndëshkimi . . . . .	22
- Tronditja e madhe . . . . .	38
- Nipi plëngprishës . . . . .	55
- Egërsia . . . . .	68
- Njeriu i kohës . . . . .	74
- Nderi i heshtur . . . . .	90
- Një grek i vogël në shtëpi . . . . .	101
- Pesha e turpër . . . . .	121
- Kamarja . . . . .	126
- Martesa e papritur e Pasho Velçanit . . . . .	133
- Shënimi i autorit . . . . .	162